

# Instrument për Përmirësimin e Praktikave të Formimit të Mësuesit për Edukimin Gjithëpërfshirës



An inclusive school is a school where:  
every child is welcome every parent is involved  
every teacher is valued

## Mbështetja Rajonale për Edukimin Gjithëpërfshirës

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented  
by the Council of Europe

# **Instrument për Përmirësimin e Praktikave të Formimit të Mësuesit për Edukimin Gjithëpërfshirës**

Autor / Zhvillimi i Instrumenti: Judith Hollenweger  
Ekipi i Ekspertëve: Judith Hollenweger, Nataša Pantić, Lani Florian

**Ekspertët e Këshillit të Evropës**

Judith Hollenweger  
Nataša Pantić  
Lani Florian

**Botuar në**

Tetor 2015

**Shtypur nga**

Sonic Studio

**Dizajni grafik**

Studio Lisica

**E drejta e Autorit © 2015**

Këshilli i Evropës

**Bashkimi Evropian**

Drejtoria e Përgjithshme për Politikën  
e Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerim

Rue de la Loi 15

B-1000 Brussels

**[www.europa.eu](http://www.europa.eu)**

**Këshilli i Evropës**

Avenue de l'Europe

F-67075 Strasbourg Cedex

**[www.coe.int](http://www.coe.int)**

## Përmbajtja

PARATHËNIE	5
PJESA 1: SFONDI, HYRJE DHE PAMJE E PËRGJITHSHME	7
1. Cili është sfondi i këtij instrumenti?	8
2. Pse u zhvillua ky instrument?	9
3. Kush e përdor këtë instrument?	10
4. Ku mund të përdoret ky instrument?	11
5. Si përdoret instrumenti?	13
6. Çfarë përmban ky instrument?	14
PJESA 2: PËRMIRËSIMI I AKTIVITETEVE PËR EDUKIMIN E MËSUESIT	16
1. Hyrje dhe Pamje e Përgjithshme	17
2. Identifikimi i problemit: Fokusimi tek profesionistët e edukimit gjithëpërfshirës	23
3. Vlerësimi i nevojave: Fokusimi tek praktikat e edukimit gjithëpërfshirës	30
4. Qëllimet dhe komponentët: Vizualizimi i praktikës së re për edukimin e mësuesit	37
5. Strategji dhe metoda: Ndërtimi i praktikës së re për edukimin e mësuesit	41
6. Zbatim, vlerësim dhe feedback: Realizimi i praktikës së re për edukimin e mësuesit	44
PJESA 3: KUADRI PËR PRAKTIKAT GJITHËPËRFSHIRËSE	47
1. Një fokus tek praktikat	48
2. Praktikrat gjithëpërfshirëse në lidhje me profesionalizmin	52
3. Praktika gjithëpërfshirëse në lidhje me nxënësin	54
4. Praktikrat gjithëpërfshirëse në lidhje me kurrikulën	57
5. Praktikrat gjithëpërfshirëse në lidhje me kontekstin	60
6. Glosari dhe bibliografi	64

## Parathënie

---

Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Mbështetja rajonale për arsimin përfshirës” në Evropën Juglindore është një projekt 3 vjeçar (1 janar 2013 - 30 nëntor 2015) që zbatohet në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Mal të Zi, Serbi, “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë” dhe Kosovë\*. Ai do të rrisë përfshirjen sociale dhe kohezionin social në rajon (në përputhje me angazhimet e përfituesve për futjen e tyre në BE dhe standardet e Këshillit të Evropës), duke nxitur arsimin dhe trajnimin përfshirës.

Projekti i përbashkët nxit konceptin e arsimit përfshirës, si një parim reforme i cili respekton dhe kujdeset për diversitetin midis të gjithë nxënësve, me fokus të posaçëm tek ata që janë në risk më të madh të marxhinalizimit dhe përjashtimit.

Për të rritur të kuptuarit e përfitimeve të arsimit përfshirës, në fillim të projekti të përbashkët u prezantua një proces i hapur, transparent dhe konkurrues për të përzgjedhur shkollat pilote. Gjithsej 392 shkollash bënë kërkesa nga të cilat u përzgjedhën 49 shkolla pilote (7 për përfitues: 3 shkolla të ciklit të ulët, 2 të mesme të përgjithshme dhe 2 të mesme profesionale) me nivele të ndryshme praktikash të arsimit përfshirës, të cilat do të merrnin pjesë në projekt. Pastaj, secilës prej këtyre shkollave iu dha një grant i vogël, me qëllim për të hartuar dhe zbatuar një projekt të lidhur me arsimin përfshirës brenda shkollës dhe komunitetit të saj. Nga fundi i projektit, u ftuan edhe 35 shkolla të tjera për t’u futur në rrjet dhe përfituar nga trajnimi për përgatitjen e planit të shkollës.

Për të nxitur të mësuarit e dyanshëm, zhvillimin profesional dhe ndarjen e përvojave midis shkollave pilote, projekti ngriti një Rrjet Rajonal Përfshirës të Shkollave me 245 anëtarë (mësues, drejtorë shkollash, prindër, studentë dhe përfaqësues të komuniteteve lokale), dhe një Rrjet Përfshirës të Mësuesve që përfshiu 245 mësues nga shkollat pilote. Për më tepër, u krijua Rrjeti i Politikave Përfshirëse si një platformë gjithëpërfshirëse që mbledhi përfaqësues nga Rrjeti përfshirës i Shkollave (SchoolNet) dhe Rrjeti përfshirës i Mësuesve (TeacherNet) si edhe palë të tjera përkatëse të interesuara për të vepruar së bashku në fushën e politikave publike të arsimit përfshirës.

Hapi i parë në përgatitjen e metodave dhe instrumenteve për zhvillimin profesional të mësuesve ishte një studim identifikues, për të analizuar aktivitetet e trajnimit të mësuesve për arsimin përfshirës në Evropën Juglindore. Procesi, i kryesuar nga një ekip ekspertësh, u fokusua në një kampion prej 36 programesh dhe përfshiu 42 palë të interesuara nga rajoni. Sipas gjetjeve të tij, kishte një shumëllojshmëri modulesh të trajnimit të mësuesve në arsimin përfshirës në rajon, por procesi i zhvillimit profesional të mësuesve (trajnim para-punë, në punë dhe për këshillimin e mësuesve) ishte i fragmentarizuar dhe shihej si tre aktivitete të

---

\* “Ky përcaktim është pa paragjykim për qëndrimet ndaj statusit dhe në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara UNSC 1244 dhe opinionin e GjND-së për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës”.

ndara. Studimi përcaktoi nevojën për bashkëpunim të kryqëzuar midis lojtarëve të ndryshëm në fushën e përfshirjes: universitetet, ministritë, shkollat dhe ofruesit e tjerë të edukimit të mësuesve. U bënë të njohura konstatimet paraprake, u diskutuan gjerë e gjatë dhe u aprovuan nga anëtarët e rrjeteve rajonale, të cilët theksuan nevojën për një kuadër të përgjithshëm të edukimit të mësuesve me përfshirjen. Përveç kësaj, anëtarët e rrjetit sugjeruan se në vend të moduleve dhe programeve, duhet të përgatiten instrumente që të ndihmojnë në përditësimin e programeve ekzistuese për trajnimin e mësuesve për përfshirjen.

Si një mënyrë për të ecur përpara, u ngrit një grup pune me 14 anëtarë, i kryesuar nga autorja Judith Hollenweger nga Universiteti i Zyrihut dhe me përfaqësues nga tre Rrjetet nga të shtatë përfituesit. Grupi i Punës miratoi konceptin dhe idenë e instrumentit për përditësimin e programeve të trajnimit të mësuesve. Puna për zhvillimin e instrumentit u krye në bashkëpunim me një ekip ekspertësh të jashtëm dhe me Universitetin e Edinburgut, i cili organizoi edhe një workshop për anëtarët e grupit të punës.

Do të dëshironim gjithashtu të vinim në dukje kontributin e Universitetit të Zyrihut për Edukimin e Mësuesve, për mbështetjen e autores Judith Hollenweger dhe për lehtësimin e sinergjisë me aktivitetet e vazhdueshme të UNICEF-it në fushën e edukimit të mësuesve, si edhe t'i shprehim mirënjohjen tonë Sabine Rohmann-it nga Instituti Pedagogjik nga Rhineland-Palatinate dhe Lana Jurko-s nga Rrjeti i Arsimit, Qendrave të Politikave në Zagreb për mendimet e tyre prej ekspertësh dhe rishikimin e draft-instrumentit.

Ne besojmë fort se ky instrument do të kontribuojë për forcimin e aftësive të mësuesve në arsimin përfshirës si një faktor kyç në promovimin e pjesëmarrjes dhe të nxënies të të gjithë nxënësve, veçanërisht të atyre që janë në rrezikun më të madh të marxhinalizimit dhe përjashtimit. Një qasje e tillë është në përputhje me qëllimet e përgjithshme të Këshillit të Evropës, duke përfshirë nxitjen e arsimit cilësor për të gjithë dhe ndërtimin e shoqërive përfshirëse.

Sarah Keating

Shefe e Njësisë së Bashkëpunimit rajonal dhe bilateral në Evropën Juglindore dhe Turqi  
Departamenti i Arsimit - DGII Democracy  
Këshilli i Evropës

## **Pjesa 1:**

Sfond, Hyrje dhe Pamje e Përgjithshme



## Sfond, Hyrje dhe Pamje e Përgjithshme

---

### 1. Cili është sfondi i këtij instrumenti?

#### KONTEKSTI I POLITIKAVE

Ky instrument për përmirësimin e aktiviteteve formuese për mësuesit u zhvillua si pjesë e përpjekjes ndërkombëtare në mbështetje të edukimit gjithëpërfshirës. Edukimi gjithëpërfshirës kuptohet këtu si një edukim cilësor i angazhuar për të drejtat e çdo fëmije dhe të riu për arsimim. Edukimi gjithëpërfshirës shikohet, si nga të gjithë aktorët ndërkombëtarë, si një strategji kyçe për sigurimin e një edukimi cilësor për të gjithë dhe për garantimin e të drejtës për arsimim, veçanërisht për grupet vulnerabel dhe të paavantazuara. Rekomandimi CM/Rec(2012)/13 i Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare përkufizon edukimin cilësor dhe nënvizon rëndësinë e përfshirjes, në të, të të gjithë nxënësve dhe studentëve. Një nga katër objektivat strategjike të Kuadrit të Edukimit dhe Kualifikimit të Bashkimit European 2020 është promovimi i paritetit, kohezionit social dhe qytetarisë aktive përmes edukimit gjithëpërfshirës të cilësisë së lartë.

Edukimi cilësor mbështetet tek mësuesit e kualifikuar, të përkushtuar për zhvillimin e tyre profesional të vazhdueshëm. Diversiteti dhe përfshirja paraqesin sfida për edukimin e mësuesve, një çështje kjo e trajtuar nga Këshilli i Europës, që para disa vitesh, për të rezultuar në zhvillimin e kompetencave kyçe për diversitet (Këshilli i Europës 2009). Fondacioni European i Trajnimit ka kryer së fundmi analiza të thelluara mbi formimin e mësuesve në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës në Ballkanin Perëndimor, duke bërë rekomandime për të gjithë grupet e interesuara, përfshirë edukatorët e mësuesve (European Training Foundation 2010). Një botim i Bashkimit European mbi një analizë të ngjashme (European Union 2013) ka nënvizuar nevojën për zhvillimin e edukimit të mësuesve në partneritet me shkollat dhe partnerët e tjerë. Agjencia Europiane për Nevoja të Posaçme dhe Edukim Gjithëpërfshirës ka realizuar një projekt tre-vjeçar (2009-2012) dhe ka zhvilluar një profil të mësuesit gjithëpërfshirës (European Agency 2012).

Instrumentet e të drejtave të njeriut të zhvilluara nga Kombet e Bashkuara (p.sh. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara) dhe Këshilli i Europës (p.sh. Karta Sociale Europiane e rishikuar) jo vetëm theksojnë të drejtën për arsimim, por edhe të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në procesin e arsimimit. Veç kësaj, është pikërisht përmes arsimimit që të rinjtë fillojnë të gëzojnë të drejtat e tyre civile dhe demokratike në shoqëri. Edukimi gjithëpërfshirës dhe edukimi për qytetari demokratike, si dhe ai për të drejtat e njeriut kërkojnë mësues që kanë vullnetin dhe aftësinë për t'i përfshirë aktivisht nxënësit e tyre në modelimin e edukimit të tyre. Mësuesit e sotshëm nuk janë të përgatitur sa duhet për të lejuar apo inkurajuar pjesëmarrjen aktive. Është e qartë që duhen bërë më shumë përpjekje për përgatitjen e të gjithë mësuesve në lidhje me praktikën gjithëpërfshirëse.

#### KONTEKSTI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit të përbashkët të Bashkimit European/Këshillit të Europës "Mbështetje Rajonale për Edukimin Gjithëpërfshirës" në Europën Jug-Lindore është forcimi i përfshirjes sociale dhe kohezionit social në rajon përmes promovimit të edukimit dhe kualifikimit gjithëpërfshirës. Një nga rrjetet e projektit (Rrjeti i Mësuesve) iu dedikua diskutimit të mënyrave për përmirësimin e kompetencave dhe praktikave të mësuesit për edukimin gjithëpërfshirës. Anëtarët e Rrjetit të Mësuesve u mbledhën disa herë për të shkëmbyer



eksperiencat dhe diskutuar mënyrat për rritjen e kapacitetit të mësuesve për praktikimin e edukimit gjithëpërfshirës. Janë analizuar dhe diskutuar aktivitetet ekzistuese të formimit të mësuesve për promovimin e edukimit gjithëpërfshirës. Rrjeti i mësuesve ka zhvilluar një vizion të Mësuesit Gjithëpërfshirës dhe ka reflektuar mbi rolet e formimit fillestar të mësuesit, të zhvillimit profesional të vazhdueshëm dhe edukimit të mentorëve për mësuesit. Ata kanë identifikuar dhe ndarë mes tyre shembuj të praktikave të mira në rajon. Kanë identifikuar qëndrime kritike, besime, shprehi dhe kompetenca që lipsen zhvilluar prej mësuesve gjithëpërfshirës. Ky instrument përfshin në vetvete përfundimet e këtyre trajtesave dhe, në këtë mënyrë, mbështet transferimin, mes shkollave, të dijeve dhe të praktikave të edukimit të mësuesve.

## PROCESI I ZHVILLIMIT

Zhvillimi i këtij instrumenti ngërthen në vetvete mësues dhe ekspertë të tjerë rajonale dhe ndërkombëtarë. Si një hap i parë, me pjesëmarrësit në projekt u diskutuan aktivitetet ekzistuese formuese për mësuesit në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës. Në rajon ka shumë aktivitete që kanë si objekt transformimin e mësuesve dhe aktorëve të tjerë në praktikienë gjithëpërfshirës, por përgjithësisht mbizotëronte pikëpamja se për ta do të ishte mjaft përfituese pasja e një instrumenti udhëheqës për rritjen e nivelit dhe përmirësimin e aktiviteteve ekzistuese formuese të mësuesit në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës.

Në workshop-in e organizuar në Edinburg në Maj 2015, u diskutua thellësisht një projekt-variant i instrumentit. Rrjedhimisht, instrumenti u rishikua dhe u përpunua duke përfshirë edhe komentet dhe shqetësimet e shprehura gjatë workshop-it. Një proces i mëpasëm rishikimi përfshiu përfaqësues nga Fondacioni Europian i Trajnimit, Këshilli i Europës, Agjencia Europiane për Nevoja të Posaçme dhe Edukimin Gjithëpërfshirës si dhe nga Zyra Rajonale e UNICEF-it për CEECIS.

Zhvillimi i instrumentit u bashkërendua me zhvillimin nga UNICEF i tri Moduleve "Train the Trainer" për Edukimin Gjithëpërfshirës. Këto module mbështeten mbi të njëjtin perceptim të Edukimit Gjithëpërfshirës dhe mbi një qasje që ka për bazë të drejtat e njeriut, si dhe përdorin të njëjtën terminologji dhe po ato koncepte. Palët përgjegjëse të Këshillit të Europës dhe UNICEF-it ranë dakord që produktet e tyre duhen bërë të tilla që të jenë në pajtueshmëri mes tyre, në mënyrë që të mund të përdoren bashkërisht në terren. Modulet e zhvilluara nga UNICEF ilustronë me shembuj përmbajtjen dhe metodat, ndërsa ky instrument siguron udhëheqje për përmirësimin e aktiviteteve ekzistuese formuese për mësuesit apo për modelimin e aktiviteteve të reja për këtë qëllim.

## 2. Përse u zhvillua ky instrument?

### FORCON PROFESIONALIZMIN E MËSUESIT

Qëllimi kryesor i zhvillimit të këtij instrumenti është forcimi i profesionalizmit të mësuesve. Profesionalizmi i mësuesve është faktori kyç për promovimin e pjesëmarrjes dhe nxënies tek të gjithë nxënësit. Ai ndikon tek arritjet e nxënësve më shumë se faktorët e tjerë shkollorë (Hattie 2009). Pa mësues të fortë, të mirë-kualifikuar e të motivuar edukimi i cilësisë së lartë dhe gjithëpërfshirës është i paarrtshëm. Forcimi i mësuesve dhe garantimi që të gjithë mësuesit janë të vlerësuar është një qëllim i rëndësishëm i projektit të përbashkët të Bashkimit Europian/Këshillit të Europës "Mbështetja Rajonale për Edukimin gjithëpërfshirës". Për të sjellë ndryshimet e domosdoshme për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës, mësuesit duhet të bëhen praktikienë reflektues dhe agjentë të ndryshimit. Ata duhet të jenë të aftë të dalin nga izolimi i tyre dhe të ndërmarrin një rol aktiv në shkollën e tyre. Ky instrument mund të mbështesë edukatorët e mësuesve, mësuesit dhe shkollat në këtë proces ndryshimi dhe të inkurajojë dialogun mbi profesionalizmin e mësuesve dhe zhvillimin e tyre gjatë gjithë jetës.

### TËRHEQ VËMENDJEN NDAJ PRAKTIKAVE NË SHKOLLA

Shumë standarde, kuadre apo orientime ndërkombëtare japin informacion në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës dhe parashtrajnë ndryshime të nevojshme për t'u bërë. Tashmë ka shumë njohuri për këtë gjë bazuar në punën teorike dhe praktike të bërë në vende të zhvilluara dhe në zhvillim. Organizata të ndryshme kanë bërë përkufizimin e kompetencave, bindjeve dhe qëndrimeve të mësuesit në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës. Sfidat sot nuk ka të bëjë me mungesën e njohurive apo standardeve, por vënien e tyre në praktikë në kontekste dhe kultura të ndryshme. Deri tani, i është kushtuar shumë vëmendje asaj që mësuesit duhet të dinë, asaj që ata kanë nevojë të besojnë dhe cilat janë qëndrimet që mbështesin edukimin

gjithëpërfshirës. Por në fund, ajo që bën ndryshimin tek nxënësit e tyre, nuk është çfarë ata dinë apo besojnë, por ajo që ata bëjnë apo nuk bëjnë çdo ditë në klasë.

Mësuesit gjithëpërfshirës janë prakticienë kompetentë dhe aktivitetet formuese për mësuesit janë të efektshme në rast se ndikojnë tek praktika e mësuesit. Hendeku mes teorisë dhe praktikës është një shqetësim madhor i edukimit të mësuesve. Ky instrument nënvizon praktikën e mësuesit, që duhen zhvilluar për kapërcimin e këtij hendeku. Mësuesit nuk kanë nevojë vetëm të dinë të dinë se çfarë duhet të bëjnë, por edhe kur, ku, si dhe pse. Në një situatë të caktuar mësuesit duhet të jenë në gjendje të aktivizojnë një numër kompetencash, bindjesh dhe shprehish specifike për të patur rezultate që përbëjnë kontribut për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës. Duhet zhvilluar praktika të reja në lidhje me nxënësit, programin mësimor, bashkëpunimin me të tjerë dhe zhvillimin profesionalizmit të vetë mësuesit. Aktivitetet edukuese për mësuesit duhet të kontribuojnë për zhvillimin e këtyre katër praktikave kryesore të mësuesit gjithëpërfshirës.

### **LEHTËSON DIALOGUN MES SHKOLLAVE DHE EDUKIMIT TË MËSUESVE**

Aktivitetet për edukimin e mësuesve duhet të mbështesin përpjekjet e shkollave për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës. Ndërkohë që lëvizin drejt edukimit gjithëpërfshirës, shkollat bëhen më të interesuara dhe më aktive në zhvillimin profesional të mësuesve dhe personelit tjetër. Këto aktivitete për edukimin e mësuesve janë të ngulitura në proceset zhvillimore afat-gjata të shkollës dhe shihen si një komponent i procesit të përgjithshëm për zhvillim kapacitetesh. Organizmat që ofrojnë edukim për mësuesit janë të mësuar të punojnë pavarësisht nevojave praktike imediate të shkollave. Fakultetet universitare dhe institutet pedagogjike të përfshira në edukimin fillestar të mësuesve kurrikulat e tyre i zhvillojnë përgjithësisht në bazë të të dhënave nga studime kërkimore dhe në bazë të kërkesave të politikave përkatëse. Organizatat jo-qeveritare, kur planifikojnë aktivitetet e tyre për edukimin gjithëpërfshirës, ndjekin axhendën dhe mandatin e tyre specifik. Ky instrument siguron një kuadër për zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse që kërkojnë të lehtësojnë dialogun mes organizmave që ofrojnë edukim për mësuesit dhe shkollave.

### **NËNVIZON NEVOJËN PËR NDËRTIM KAPACITETESH NË SISTEMET E EDUKIMIT**

Realizimi progresiv i edukimit gjithëpërfshirës kërkon ndërtim kapacitetesh për këdo që është i përfshirë në edukim apo me përgjegjësi në lidhje me edukimin. Disa aftësi mund të zhvillohen duke i nxjerrë mësuesit nga konteksti i tyre i punës e duke i trajnuar individualisht. Por në të shkuarën kjo nuk ka rezultuar të jetë metoda më efektive për përmirësimin e praktikës dhe sigurimin e shkollave më gjithëpërfshirëse. Puna me kolegët ose zhvillimi i praktikave në nivel shkolle janë qasje më të qëndrueshme dhe më premtuese për të patur shkolla më gjithëpërfshirëse. Ndaj dhe ndërtimi i kapaciteteve fokusohet më shumë tek grupet dhe praktikën e tyre se sa tek mësuesit individualisht dhe kompetencat e tyre.

Edukimi i mësuesve është vetëm një pjesë e procesit të ndërtimit të kapaciteteve, i domosdoshëm për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës. Të tjerë aktorë, organizatat e shoqërisë civile, ndërgjegjësimi dhe qëndrimet në shoqëri, luajnë të gjithë role të rëndësishme. Kjo reflektohet në mbështetjen që shkollat marrin nga autoritetet vendore dhe partneritetet mësues-prindër. Kësisoj, ndërtimi i kapaciteteve nuk ka të bëjë vetëm me zhvillimin profesional të individëve dhe grupeve; ai ka të bëjë edhe me kapacitetin e sistemit të edukimit, të ministrive dhe autoriteteve vendore dhe të entiteteve të ndryshme që ofrojnë edukim për mësuesit. Ato duhet të zhvillojnë praktikën e tyre për të gjeneruar kontekste të përshtatshme pune, ambient aftësues, dije të dobishme dhe instrumente që mund të përdoren nga shkollat.

## **3. Kush e përdor këtë instrument?**

### **INDIVIDËT E PËRFSHIRË NË EDUKIMIN E MËSUESVE PËR GJITHËPËRFSHIRJEN**

Këtë instrument mund ta përdorë çdo person i përfshirë në edukimin e mësuesve me synimin për të përditësuar apo harmonizuar aktivitetet formuese për mësuesit me praktikën gjithëpërfshirëse në shkolla. Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse mund të përdoret për identifikimin e boshllëqeve si dhe të asaj çfarë mbulohet në programet apo modulet ekzistuese. Instrumenti mund të përdoret për reflektim personal ose për të marrë feedback nga pjesëmarrësit apo aktorët e tjerë. Ai mund të jetë i dobishëm për ngritjen e partneriteteve me shkollat për zhvillimin sëbashku të aktiviteteve formuese për mësuesit.

## **ORGANIZATAT E PËRFSHIRA NË EDUKIMIN E MËSUESVE PËR GJITHËPËRFSHIRJEN**

Përgjithësisht, më shumë se individët, përgjegjësinë për sigurimin e aktiviteteve për edukimin e mësuesve e kanë organizatat. Në rast se një grup personash angazhohet në procesin e rishikimit të praktikave të tyre, mund të nevojitet një proces më i formalizuar. Në qoftë se nga autoritetet nuk kërkohet një proces i parapërcaktuar (p.sh. për akreditim), palët e interesuara do të duhet të bien dakord për mënyrën e procedimit. Ky instrument nis një proces për zgjidhjen e problemit dhe siguron një kuadër për praktikat gjithëpërfshirëse. Ai siguron një strukturë dhe ndihmon në organizimin e proceseve për ndryshime të domosdoshme. Atje ku ka disa organizata aktive në edukimin e mësuesve për edukimin gjithëpërfshirës, një instrument i tillë i përbashkët mund të ndihmojë për bashkërendimin e aktiviteteve të ndryshme me qëllim arritjen e pajtueshmërisë dhe komplementaritetit mes tyre.

## **INSTITUCIONET SHTETËRORE PËRGJEGJËSE PËR OSE PROMOVUESE TË EDUKIMIT TË MËSUESVE PËR GJITHËPËRFSHIRJEN**

Realizimi i një sistemi edukimi gjithëpërfshirës është i detyrueshëm për të gjithë shtetet që janë nënshkruese të konventave dhe kartave ndërkombëtare respektive. Edukimi i mësuesve është një levë e rëndësishme për ndryshime tërësore në sistemin shkollor. Interesi për kompetencat e mësuesve dhe cilësinë e mësimdhënies reflektohet në praktikat e akreditimit, skemat e promovimit të mësuesve apo të avancimit në karrierë. Shumë shtete kanë një sistem akreditimi jo vetëm për edukimin fillestar të mësuesit, por edhe për aktivitetet e edukimit të vazhduar për mësuesit. Këto aktivitete përdoren nga shtetet si një sistem për kualifikimin e mësuesve dhe mësuesve u kërkohet të marrin pjesë në këto aktivitete në mënyrë që të mund të promovohen apo të avancojnë në karrierë. Në disa raste, këto praktika nuk janë në harmoni me filozofinë e edukimit gjithëpërfshirës. Shtetet që lëvizin drejt edukimit gjithëpërfshirës mund të duan ta përdorin këtë instrument për të harmonizuar praktikat e tyre të akreditimit ose për të vlerësuar dhe për t'u dhënë feedback ofruesve të edukimit gjithëpërfshirës dhe shkollave të përfshira në zhvillimin profesional.

## **SHKOLLAT E PËRFSHIRA NË EDUKIMIN E MËSUESVE PËR GJITHËPËRFSHIRJEN**

Gjithmonë e më shumë shkollat marrin mbi vete përgjegjësinë për sigurimin e zhvillimit profesional të personelit të tyre - në vend të delegimit të saj organizmave të posaçëm që ofrojnë edukim për mësuesit. Edukimi i mësuesve shihet si një komponent i rëndësishëm i strategjisë së përgjithshme për ndërtim kapacitetesh në shkolla. Shkollat gjithëpërfshirëse janë të vetëdijshme për domosdoshmërinë e zhvillimit profesional të vazhduar. Ato angazhohen vetë në mënyrë aktive në aktivitete edukuese për mësuesit, shpesh si seanca mes kolegësh ose në partneritet me organizata që ofrojnë ekspertizën e nevojshme për këtë qëllim. Këto shkolla e gjejnë veten në rolin e organizuesit të aktiviteteve edukuese për mësuesit në mbështetje të proceseve zhvillimore të shkollës. Ato mund ta përdorin këtë instrument për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me fushat apo praktikat ku mund të angazhohen për ndërtim kapacitetesh. Kuadri për praktikat gjithëpërfshirëse mund të ndihmojë për lokalizimin e pikave të forta dhe dobësive në praktikat aktuale. Shkollat e angazhuara në diskutime të tilla do të jenë në gjendje të bashkërendojnë dhe sinkronizojnë aktivitetet e edukimit të mësuesve me zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse në bazë shkolle.

## **ÇDO PERSON I INTERESUAR PËR FORMIMIN E MËSUESVE NË LIDHJE ME EDUKIMIN GJITHËPËRFSHIRËS**

Instrumenti siguron një kuadër për praktikat gjithëpërfshirëse që mund të përdoren nga çdokush që ka interes për praktikat e mira në shkollat gjithëpërfshirëse, edhe nëse nuk planifikon të përfshihet në aktivitete edukuese për mësues. Në thelb, instrumenti mund të jetë me interes për këdo që ka të bëjë me profesionalizmin e mësuesve në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës.

### **4. Ku mund të përdoret ky instrument?**

#### **PËRDORIM I GJERË NË RRETHANA TË NDRYSHME**

Në thelb, ky instrument mund të përdoret për të gjithë aktivitetet edukuese për mësues, pavarësisht kush i ofron ato, si dhe ku e kur ofrohen. Edukimi gjithëpërfshirës nuk është as më shumë e as më pak se sa një edukim i cilësisë së lartë për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, që i kërkon mësuesve të zhvillojnë në mënyrë të vazhduar praktikat e tyre gjatë gjithë ciklit të jetës së tyre profesionale. Përdorimi i të njëjtit kuadër për praktikat gjithëpërfshirëse u jep organizmave që ofrojnë edukim fillestar apo në punë për mësuesit,

mundësinë për të bashkërenduar dhe komplementuar aktivitetet e njëri-tjetrit. Instrumenti mund të përdoret gjithashtu edhe për zhvillimin e një programi të përgjithshëm për zhvillimin profesional të mësuesve në rrethana të ndryshme e për organizma të ndryshme për të siguruar konsistencë dhe koherencë.

### **EDUKIMI FILLESTAR DHE PARA FILLIMIT TË PUNËS**

Edukimi fillestar apo para fillimit të punës i mësuesve fokusohet tek zhvillimi i një identiteti thelbësor si praktikien gjithëpërfshirës dhe i aftësive bazë për vlerësimin e diversitetit të nxënësve, duke mbështetur të gjithë nxënësit dhe duke punuar me të tjerët. Studentët mësues duhet të jenë të aftë të punojnë në ambiente gjithë-përfshirëse, por pa qenë ende ata që udhëheqin proceset e ndryshimit. Ata duhet të jenë në gjendje të vënë në zbatim një program gjithëpërfshirës në bazë shkolle, pa qenë ata personat që e zhvillojnë atë. Instrumenti mund të ndihmojë për të sqaruar se cilat janë aftësitë që duhen zhvilluar përpara se të lejohesh të ushtrosh profesionin e mësuesit. Shkollat mund ta përdorin instrumentin për zhvillimin e kriterëve të kualifikimit për mësuesit fillestarë sëbashku me institucionet që bëjnë edukimin fillestar të mësuesve. Në rast se shkollat janë të përfshira në edukimin praktik të studentëve mësues, ky instrument mund të përdoret për bashkërendimin e punës teorike me atë praktike.

### **EDUKIMI NË PUNË I MËSUESVE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I VAZHDUAR**

Gjatë fazës fillestare të emërimit të mësuesve të rinj, ky instrument mund të jetë i dobishëm për të reflektuar në lidhje me aftësitë e fituara gjatë edukimit fillestar të mësuesit dhe nevojat imediate për edukim të mësuesve në fillim të karrierës së tyre profesionale. Mësuesit mentorë apo trajnerë mund ta përdorin këtë instrument për reflektim, për të dhënë orientim dhe kontekstualizuar veprimtaritë e tyre në kontekstin më të gjerë të edukimit gjithë-përfshirës. Ndërkohë që mësuesit avancojnë në karrierë, kuadri për edukimin gjithëpërfshirës mund të sigurojë një pamje të përgjithshme të arritjeve dhe nevojave të tyre për të mësuar. Kjo do të mundësojë angazhimin në aktivitete edukuese për mësuesit, të tilla që promovojnë në mënyrë efektive praktikën gjithëpërfshirëse dhe zgjerojnë në mënyrë domethënëse dijet dhe eksperiencat përkatëse. Mësuesit me përvojë kanë nevojë jo vetëm të jenë në gjendje të vlerësojnë diversitetin e nxënësve, por edhe të zhvillojnë praktika shkollore që forcojnë respektin dhe vlerësimin për diversitetin. Ata duhet të fitojnë një rol aktiv në zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Shkollat mund ta përdorin këtë instrument për identifikimin e nevojave të tyre për zhvillim dhe ndërtim kapacitetesh, duke e bërë edukimin e mësuesve një shqetësim të ekipit e jo thjesht të mësuesit si individ. Përveç zhvillimit të kompetencave, ekipet janë bërë agjentë të edukimit gjithëpërfshirës dhe zhvillojnë praktika novatore. Ky instrument mund të ndihmojë shkollat në identifikimin e nevojave të tyre për zhvillim dhe për ndërtim kapacitetesh.

### **EDUKIMI I MËSUESVE EKSPERTË, MËSUESVE MENTORË DHE EDUKATORËVE TË MËSUESIT**

Shkollat gjithëpërfshirëse me praktika të mirë-zhvilluara dhe profesionistë shumë kompetentë si faktorë ndryshimi në lidhje me praktikën gjithë-përfshirëse, mund të duan të angazhohen në sigurimin e aktiviteteve edukuese për shkolla apo individë të tjerë për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve në një kontekst më të gjerë arsimor. Ekipet e shkollave apo profesionistë të caktuar të aftë për zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse kanë potencialin të ripërtërijnë praktikën e tyre nëpërmjet zhvillimit të strategjive të reja pedagogjike, instrumenteve të vlerësimi apo të transformojnë komunitete, duke krijuar mjedise të reja gjithë-përfshirëse. Në fjalë të tjera, praktika e tyre ka tashmë si objektivi të saj kapacitetin e profesionistëve të tjerë, të shkollave të tjera dhe të vetë sistemit arsimor, e jo thjesht kapacitetin e tyre dhe të nxënësve të tyre. Tradicionalisht zhvillimi i strategjive të reja është detyra e Instituteve për Zhvillimin e Arsimit në varësi të Ministrive. Në disa vende, organizatat ndërkombëtare dhe jo-qeveritare janë aktive në promovimin e praktikave novatore për bërjen e shkollave më gjithëpërfshirëse. Transformimi i edukimit të mësuesve ka qenë përgjegjësi vetëm e institucioneve të tilla si universiteti, fakultetet pedagogjike apo i organizatave të tjera. Në këtë kontekst, instrumenti mund të ndihmojë për identifikimin e aktiviteteve edukuese për mësuesit, të cilat kërkojnë transformimin apo rinovimin e praktikave mësimore dhe ndihmojnë për të bashkërenduar apo plotësuar aktivitetet.

### **RRJETET DHE PARTNERITETET PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE**

Një transformim që kap të gjithë sistemin e praktikave për realizimin e edukimit gjithë-përfshirës kërkon krijimin e partneriteteve dhe rrjeteve me palët e interesuara që shkojnë përtej nivelit të shkollës. Edukimi gjithë-përfshirës ka nevojë ta shtrijë praktikën e tij tek komuniteti dhe mjedisi nga vijnë e ku punojnë individët

që mësojnë brenda tij. Ai kërkon bashkëpunimin e ngushtë dhe angazhimin aktiv të profesionistëve dhe partnerëve të ndryshëm jashtë shkollave, Ndërtimi i kapaciteteve për këtë qëllim nuk mund të jetë përgjegjësi vetëm e një institucioni apo e një agjenti të vetëm. Organizatat e prindërve, autoritetet vendore, organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe grupe të tjera interesi luajnë role të rëndësishme për ndërtimin e kapaciteteve të komuniteteve për t'u bërë më gjithëpërfshirëse. Praktikave gjithëpërfshirëse të qëndrueshme në shkolla nuk mund të jenë të izoluara nga praktikave të tjera sociale. Instrumenti dhe kuadri për zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse mund të përdoren për të diskutuar praktika dhe për të qenë pjesë e proceseve të ndryshimit sëbashku me këta partnerë. Ai mund të ndihmojë për zhvillimin e një gjuhe të përbashkët mes organizmave të ndryshëm dhe për të krijuar rrjete dhe partneritete për ndërtimin e kapaciteteve.

## 5. Si përdoret instrumenti?

### **INSTRUMENT PËR VETË-REFLEKTIM NGA MËSUESIT DHE EDUKATORËT E MËSUESVE**

Ky instrument është i dobishëm për çdo organizëm që bën edukimin e mësuesve e që dëshiron të reflektojë në lidhje me praktikave të tij me synimin për t'i përmirësuar apo harmonizuar ato me parimet e edukimit gjithëpërfshirës. Ky instrument ndihmon për strukturimin e kësaj përpjekje, duke përcaktuar hapat e ndryshëm për mundësimin e një analize të përgjithshme të asaj se çfarë duhet të jenë të aftë të bëjnë mësuesit, si pjesë e praktikave të tyre gjithëpërfshirëse, dhe mënyrën se si aktivitetet për edukimin e mësuesve mund të ndihmojnë në zhvillimin e këtyre aftësive. Edukatorët e mësuesve mund ta përdorin këtë instrument për të rishikuar praktikave të tyre dhe për të përditësuar programet, workshop-et apo modulet ekzistuese për të qenë më në harmoni me edukimin gjithëpërfshirës. Nëse organizma të ndryshëm ofruan këtë edukimi ndjekin të njëjtën procedurë, ata do jenë në gjendje të paraqesin reflektimet e tyre në një format të ngjashëm, që lehtëson komunikimin mes tyre për shkëmbimin e informacionit mbi çfarë bëjnë apo edhe për të koordinuar apo komplementuar aktivitetet e tyre. Mësuesit mund ta përdorin këtë instrument për të kuptuar më mirë ku janë në zhvillimin e tyre profesional dhe çfarë aftësish mund t'u duhet të fitojnë për të avancuar drejt të qenurit një mësues gjithëpërfshirës.

### **INSTRUMENT PËR IDENTIFIKIMIN E NEVOJAVE TË MËSUESVE PËR TË MËSUAR**

Shkollat janë gjithmonë e më të interesuara në lidhje me zhvillimin profesional të personelit të tyre si pjesë e procesit për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës. Ky instrument mund t'u vijë në ndihmë drejtuesve të shkollave për të kuptuar më mirë nevojat e mësuesve për formim dhe mënyrën si ato lidhen me nevojën për të zhvilluar praktikave gjithëpërfshirëse. Palët e tjera të interesuara mund të kenë po ashtu interes për të qenë më të informuara në lidhje me efektet që ka edukimi gjithëpërfshirës tek qëndrimet, vlerat, shprehitë dhe kompetencat e mësuesve. Ky instrument mund të jetë i dobishëm për stimulimin e diskutimit mbi aktivitetet aktuale për edukimin e mësuesve për t'i kontribuar praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla.

### **INSTRUMENT PËR VLERËSIMIN E AKTIVITETEVE PËR EDUKIMIN E MËSUESVE**

Në shumë vende, vazhdohet të diskutohet për nevojën e ndryshimit të praktikave që përgatisin mësuesit për në klasë. Ky instrument mund t'u vijë në ndihmë këtyre diskutimeve duke siguruar një kuadër dhe metodologji për vlerësimin e aktiviteteve për edukimin e mësuesve. Ekziston ndjesia se më shumë se të fokusohet tek dhënia e bazës teorike mbi mësimdhënien, edukimi i mësuesve duhet t'i kontribuojë me efektivitet praktikës së mësuesit. Duke u fokusuar tek praktika e mësuesit dhe tek praktikave në shkollën gjithëpërfshirëse, ky instrument mund t'u vijë në ndihmë këtyre diskutimeve dhe të ndihmojë në zhvillimin e një konsensusi mes palëve të interesuara përkatëse. Organizmat ofruese të edukimit të mësuesve mund ta përdorin këtë instrument për vetë-vlerësimin e aktiviteteve të tyre në fushën e edukimit gjithëpërfshirës. Ky mund të jetë një hap i parë për rishikimin e aktiviteteve të tyre ose mund të jetë pjesë e punës kërkimore në lidhje me kompetencat e mësuesit dhe zhvillimin e tyre.

### **INSTRUMENT PËR PROGRAMIMIN E EDUKIMIT TË MËSUESIT**

Disa vende kanë treguar interes për rishikimin e qasjes së tyre të përgjithshme për përgatitjen e mësuesve në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës. Shumë vende kanë ende programe të veçanta për mësuesit që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara. Kjo gjë shikohet si një barrierë e konsiderueshme në edukimin gjithëpërfshirës, pasi mësuesit e zakonshëm dhe ata të posaçëm edukohen pavarësisht njëri-tjetrit. Përdorimi i të njëjtit instrument dhe komunikimi në lidhje me praktikën e mësuesit për gjithëpërfshirjen mund të ndihmojë për një koordinim më të mirë apo edhe për t'i bërë bashkë të dyja këto aktivitete.



## 6. Çfarë përmban ky instrument?

### **NJË PROCEDURË DHE NJË KUADËR**

Instrumenti për përmirësimin e aktiviteteve për edukimin e mësuesve ka dy pjesë. Pjesa e parë përshkruan procedurën e përmirësimit si një renditje aktiviteteve ku mund të marrin pjesë përdoruesit e këtij instrumenti. Ajo i udhëheq përdoruesit përgjatë një cikli me gjashtë faza: Identifikim Problemi, Vlerësim Nevojash, Qëllime dhe Objektiva, Strategji Edukuese, Implementim, Vlerësim dhe Feedback. Pjesa e dytë përshkruan kuadrin për praktikën gjithëpërfshirëse. Bazuar në punën e Agjencisë Europiane në lidhje me profilin e mësuesit gjithëpërfshirës (2012), është zhvilluar një kuadër përshkruar i praktikave të mësuesve gjithëpërfshirës. Ky kuadër identifikon katër praktikë thelbësore relevante për edukimin gjithëpërfshirës.

### **KONCEPTET**

Instrumenti bazohet në konceptet e edukimit gjithëpërfshirës të shfaqura në nivel ndërkombëtar gjatë viteve të fundit. Konceptet kyçe, për lehtësi referencë, shpjegohen në një glosar. Termi “abilities” (aftësi) është përdorur si një term ombrellë që përfshin qëndrimet, besimet, shprehitë dhe dijet, kompetencat dhe agjencinë (të qenurit agjent i ndryshimit) . Ky term nënvizon atë çka janë në gjendje të bëjnë mësuesit apo profesionistët e tjerë, përfshirë, për shembull, aftësinë për të motivuar vetveten apo për të udhëhequr aktivitetet e tyre drejt arritjes së vizionit të edukimit gjithëpërfshirës. Veç kësaj, instrumenti përmban në vetvete koncepte të zhvilluara për të shpjeguar ndërtimin e kapaciteteve nga sistemi në sistem e në çdo rrethanë. Ai përdor njohuri në lidhje me zhvillimin e komuniteteve të praktikës (Lavé & Wenger 1991), nxënien ekspansive në organizata (Engeström 2001) dhe organizatat e nxënies (Senge 1990, Senge et al. 2012). Ky instrument mban, po ashtu, parasysh vështirësitë që lindin nga transferimi i dijes nga një mjedis (p.sh. seminar në universitet apo fakultet të studimeve pedagogjike) në një tjetër (klasë në një shkollë lokale). Shprehitë (p.sh. ruajtja e disiplinës në një klasë) apo kompetencat nuk janë domosdoshmërisht e njëjta gjë, si kur mëson një nxënës dymbëdhjetë-vjeçar, edhe kur punon me mësues që kanë përvojë. Procesi i nxënies lidhet me situatat në të cilat ndodh nxënia dhe profesionistët e fushës duhet të jenë të aftë të reflektojnë në lidhje me situatat e reja për të vënë në zbatim ato çfarë ata kanë mësuar. Koncepti i praktikienit reflektues (Argyris & Schön 1996) dhe rëndësia e mësuesve si agjentë të ndryshimit social (Fullan 1993, Priestley et al. 2012).

### **PRAKTIKA**

Në diskutimet rreth zhvillimit profesional të mësuesve, në mënyrë të përsëritur, është identifikuar hendeku mes teorisë dhe praktikës, si dhe mes formimit të mësuesit dhe realitetit në shkolla. Nuk mjafton të mbash leksione mbi filozofinë e edukimit gjithëpërfshirës apo të flasësh rreth rëndësisë së edukimit gjithëpërfshirës. Po ashtu nuk mjafton të përvetësosh teorinë e praktikave gjithëpërfshirëse, të tilla si planifikimi edukativ individual apo strategjitë për mësimdhënie të diferencuar, apo të njohësh strategjitë e vlerësimit. Transferimi i dijeve është i suksesshëm vetëm në rast se kompetencat, shprehitë & dijet e reja, perceptimet e reja janë bërë pjesë e praktikës së përditshme të mësuesit. Çdo gjë që mësuesit përvetësojnë duhet shfaqur në mënyrë të tillë që në fund mbështet procesin e gjithëpërfshirjes. Ajo çfarë e bën diferencën në situatat e vërteta shkollore nuk është ajo çfarë mësuesit dinë apo besojnë, por ajo çfarë ata bëjnë apo janë të aftë të bëjnë në kontekstin e punës së tyre konkrete. Ndaj ky instrument fokusohet tek praktikën e mësuesit dhe thekson rëndësinë e mësuesit si agjent ndryshimi. Kuadri për edukimin gjithëpërfshirës merr kompetencat e identifikuar në profilin e mësuesit gjithëpërfshirës (Agjencia Europiane 2012) dhe i shtrin ato në praktikë. Besimet, qëndrimet, shprehitë dhe dijet, si dhe kompetencat, duhen orientuar drejt qëllimesh domethënëse dhe rezultatesh të dëshiruara. Ato duhet të marrin parasysh kontekstin social dhe fizik ku përdoren. Situatat specifike kërkojnë aktivizimin e një kombinimi specifik besimesh, shprehish & dijes dhe kompetencash dhe përdorimin e metodave dhe proceseve të përshtatshme. Prandaj instrumenti më shumë se sa tek aftësi të izoluara/të veçanta, fokusohet tek zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse.

### **AKTIVITETE**

“Praktikë” është termi ombrellë për të gjitha aktivitetet dhe veprimet relevante të ndërmarra në përmbushje të mandatit dhe detyrimeve profesionale. Është pikërisht përmes këtyre veprimesh, që aftësitë e një mësuesi bëhen të dukshme dhe ushtrojnë ndikim tek nxënësit, kolegët, prindërit si edhe tek profesionistët e tjerë apo pjesëtarët e komunitetit. Veprimtaria e një mësuesi mund të ketë për synim të mbështesë një djalë që vjen

nga një familje e disavantazuar nga pikëpamja shoqërore për të përfituar nga programi mësimor, të krijojë një mjedis mësimi pozitiv për të gjithë nxënësit ose të qartësojë me një koleg strategjitë e mësimin në ekip. Të gjitha këto veprimtari kombinohen në mënyrë të tillë që mbështesin realizimin e edukimit gjithëpërfshirës. Krijohet një model (shiko kuadrin) për analizimin e praktikave dhe aktiviteteve duke përcaktuar komponentët që i përgjigjen pyetjeve si këto: Kush po e kryen aktivitetin? Ndaj çfarë gjëje drejtohet aktiviteti? Përse e për çfarë qëllimi kryhet ky aktivitet? Si kryhet aktiviteti? Ku kryhet aktiviteti?

E njëjta gjë ndodh edhe në rastin e aktiviteteve për edukimin e mësuesve. Çdo gjë që bëjnë ofruesit e edukimit për mësues duhet t'i kontribuojë realizimit të edukimit gjithëpërfshirës. Përmirësimi i asaj që ekziston ose krijimi i moduleve, programeve apo workshopeve të reja për zhvillimin e aftësive të mësuesve, të rëndësishme për edukimin gjithëpërfshirës, përfshin një sërë aktiviteteve. Duhet identifikuar mangësitë apo vështirësitë me programet ekzistuese; nevojitet bërja e vlerësimit të nevojave për të siguruar një perceptim të plotë të asaj se ç'duhet të jenë të aftë të bëjnë mësuesit që janë pjesë e edukimit gjithëpërfshirës e kështu me radhë. Ky instrument e përshkruan procesin përditësues si një seri aktiviteteve që mund të realizohen nga organizma ofruese të edukimit për mësues dhe palë të tjera të interesuara. I njëjti model për përshkrimin e aktiviteteve përdoret për aktivitetet e mësuesve në shkolla dhe për aktivitetet për edukimin e mësuesve. Premisa themelore është se, duke u fokusuar tek praktika, mund të kapërcehet më mirë hendeku që ekziston mes asaj që mësohet në kontekstin e formimit të mësuesve dhe praktikës së mësuesve në shkolla.



## **Pjesa 2:**

Përmirësimi i Aktiviteteve për Edukimin e Mësuesve

## Përmirësimi i Aktiviteteve për Edukimin e Mësuesve

### 1. Hyrje dhe Vështrim i Përgjithshëm

#### **ORGANIZIMI I INSTRUMENTIT**

Instrumenti për përmirësimin e aktiviteteve për edukimin e mësuesve organizohet në një seri aktivitete. Premisa thelbësore është ajo se modulet, programet, seminarët apo projektet ekzistuese përmirësohen më së miri duke treguar se çfarë mund të bëhet gjatë këtij procesi. Në këtë pjesë të instrumentit, përdoruesi do të gjejë një seri aktivitete që ndjekin hapat e ndryshëm për ngritjen në nivel më të lartë të aktiviteteve ekzistuese për edukimin e mësuesve ose krijojnë aktivitete të reja. Edhe për zhvilluesit me përvojë të kurrikulave, përshkrimi i aktiviteteve orienton procesin e përmirësimit dhe mundëson reflektimin. Kjo është veçanërisht e dobishme nëse procesi i përmirësimit përfshin njerëz të ndryshëm, me formime të ndryshme, që kanë nevojë të sinkronizojnë aktivitetet e tyre. Përshkrimi eksplícit i aktiviteteve dhe rendi në të cilin kryhen ato, inkurajojnë diskutimet mes palëve të interesuara. Ai bën më transparent procesin përmirësues dhe, në këtë mënyrë, krijon mundësi që njerëzit të angazhohen dhe të kontribuojnë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e edukimit gjithëpërfshirës.

Instrumenti përmban, po ashtu, një kuadër për praktika gjithëpërfshirëse edhe në pjesën tjetër. Ky kuadër i organizon aktivitetet gjithëpërfshirëse për mësuesit në katër fusha të praktikës. Ai përmban elementet e praktikës së mirë, që mësuesit gjithëpërfshirës duhet të përvetësojnë gjatë karrierës së tyre. Kuadri siguron informacion për atë se çfarë duhet të mësojnë mësuesit për t'u bërë profesionistë gjithëpërfshirës gjatë kohës që kryejnë trajnimin fillestar për mësues, në kohën kur kanë fituar përvojë dhe kur, më në fund, fillojnë të mësojnë mësuesit e tjerë në lidhje me praktikën gjithëpërfshirëse. Ky është informacioni ku duhet të mbështetet përdoruesi kur i duhet të mendojë për mungesat në përmbajtje, aftësitë e mësuesit, që duhen zhvilluar, apo praktikën që duhen zbatuar.

#### **FOKUSI TEK PRAKTIKA**

Përgatitja e mësuesit për edukimin gjithëpërfshirës kërkon transformimin e praktikës në shkolla për promovimin e gjithëpërfshirjes në vend të përjashtimit. Është e rëndësishme të mbahet gjithmonë parasysh ky qëllim. Shkollat gjithëpërfshirëse kanë nevojë për profesionistë të aftë për promovimin e gjithëpërfshirjes, jo vetëm që flasin apo shkruajnë për të. Aktivitetet për edukimin e mësuesve duhet të kontribuojnë për praktikën gjithëpërfshirëse, duke punuar drejtpërsëdrejti me profesionistë nëpër shkolla, ose në mënyrë indirekte përmes ndërtimit të kapacitetit të studentëve të mësuesisë, që studiojnë universitet apo në fakultetet e studimeve pedagogjike. Aftësitë e mësuesve bëhen të dukshme dhe efektive vetëm përmes veprimeve dhe aktiviteteve të tyre në jetën e vërtetë. Efekti i të gjithë këtyre aktiviteteve, marrë së bashku, e bën shkollën gjithëpërfshirëse ose jo. Prandaj, ky instrument fokusohet më shumë tek praktika se sa tek teoria, tek ajo që mësuesit duhet të jenë të aftë të bëjnë, jo thjesht tek ajo që ata duhet të dinë. Qëndrimet dhe besimet pozitive, shprehitë e nevojshme, dijet dhe kompetencat janë të rëndësishme dhe kanë nevojë të zhvillohen. Megjithatë, edhe më e rëndësishme është mënyra si ato funksionojnë në praktikë. Ndaj instrumenti fokusohet tek praktikën: tek praktika e përmirësimit të aktiviteteve për edukimin e mësuesve dhe praktika e shkollave gjithëpërfshirëse, përmirësimin e të cilave synojnë këto aktivitete.

Për t'u fokusuar tek praktika, instrumenti prezanton një model për analizimin dhe përshkrimin e aktiviteteve. Më shumë se sa tek specifikimi i karakteristikave apo i cilësive relevante të mësuesve, ky instrument fokusohet tek mënyra se si këto aftësi duhet të evidentohen në praktikën e përditshme të mësuesit. Instrumenti përqendrohet tek veprimet e mësuesit apo e profesionistëve të tjerë. Nga ky këndvështrim, kuadri përshkruan praktikën e mirë. Për shembull, kur u japin mësim një grupi nxënësish me përbërje të ndryshme: Çfarë vënë re, çfarë u tërheq vëmendjen, cilat besime, qëndrime apo qëllime aktivizohen? Çfarë strategjish përdorin e cila është atmosfera e krijuar në klasë? Praktika përcaktohet nga ajo çfarë mësuesi bën, si e bën atë, cili është qëllimi kur e bën këtë gjë dhe nëse e gjitha kjo i përshtatet kontekstit në të cilin punon. Për shembull, vëzhgimi dhe vlerësimi i diferencave mes nxënësve është një kompetencë e rëndësishme e mësuesve gjithëpërfshirës. Por, nëse pranimi i diferencës shoqërohet me pritshmëri të ulëta, aftësia vlerësuese çon, në të vërtetë, në praktika mësimore diskriminuese.

### MODELI I AKTIVITETIT

Modeli i aktivitetit ndihmon të mendosh jo vetëm për atë se çfarë bëjnë mësuesit gjithëpërfshirës dhe çfarë duhet të bëjnë, por edhe se çfarë synojnë apo presin të realizojnë përmes veprimeve dhe aktiviteteve të tyre. Mësuesi si agjent i ndryshmit bën bashkë një numër bindjesh, qëndrimesh, shprehish, dijesh dhe kompetencash, në klasë apo në situata të tjera në shkollë. Të jesh një mësues gjithëpërfshirës nuk ka të bëjë (vetëm) me performancën e lartë në provimet finale apo dhënien e përgjigjes së saktë kur të pyesin për edukimin gjithëpërfshirës. Nëse mësuesit janë efektivë në mbështetjen që u japin atyre që mësojnë, apo si agjentë të ndryshimit social drejt edukimit gjithëpërfshirës, kjo duhet gjykuar nga veprimet e tyre. Aq sa ka të bëjë me aftësitë e mësuesit, po aq ka të bëjë edhe me aktivizimin e tyre në çastin e duhur.

Modeli i aktivitetit përdoret për dy qëllime në këtë instrument. Së pari, për të përshkruar aktivitetet që janë pjesë e procesit të përditësimit dhe, së dyti, për të përshkruar tërësinë e aktiviteteve të praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla. Modeli ndihmon për të nënvizuar komponentët kryesorë të çdo aktiviteti. Komponentët e përdorur në modelin e aktivitetit i përgjigjen pyetjeve më poshtë:

- Kush e bën (subjekti i aktivitetit)?
- Çfarë bëhet (objekti i aktivitetit)?
- Pse ose për çfarë qëllimi bëhet (përfundimi i aktivitetit)?
- Si bëhet (Mjetet dhe instrumentet)?
- Ku bëhet (konteksti social dhe fizik)?

Këta komponentë janë paraqitur në modelin më poshtë:




Figura 1: Model Aktiviteti për përshkrimin e Praktikave

Përkufizime dhe komponentë:

**“Subjekti”** i referohet personit apo njerëzve që kryen/kryejnë aktivitetin. Aktiviteti kuptohet dhe analizohet nga perspektiva e tij/saj (p.sh. edukatori i mësuesve ose mësues i arsimit fillor).

**“Objekti”** i referohet fokusit të aktivitetit; ai përcakton kujt i drejtohet aktiviteti. Ky mund të jetë një person tjetër, një problem, një temë apo çdo objekt fizik. Cilësia e objektit varet nga perceptimi i subjektit, qëndrimi dhe përvoja, si dhe nga natyra e aktivitetit (p.sh. cilësi të ndryshme të ujit janë relevante kur pimë ujë, kur masim një litër, notojmë në liqen, ose lexojmë Arkën e Noes).

**“Përfundimi”** i referohet gjithë rezultateve ose ndikimeve të dëshirueshme ose jo, që krijohen si rezultat i kryerjes së një aktiviteti (p.sh. arritje, dështim). Përfundimet parashikohen me anë të shpalljes së qëllimit ose synimeve, ato mund të jenë të synuara ose jo.

**“Mjetet dhe Artefaktet”** janë mjete ose metoda fizike dhe njohëse që përdoren për realizimin e aktivitetit (p.sh. tekst shkollor, strategji mësimi, gjuha si mjet komunikimi).

**“Konteksti”** i referohet karakteristikave të rrethanave apo mjedisit social ku zhvillohet aktiviteti. Kjo mund t'i referohet vlerave sociale, bindjeve, normave apo rregullave, por edhe klimës në klasë, mbështetjes së dhënë nga kolegë. Nganjëherë edhe mjedisi fizik është shprehje e praktikave dhe bindjeve sociale, reflektuar tek infrastruktura, ndërtimet dhe ndryshimet e shkaktuara nga njeriu tek mjedisi natyror.

Modeli i aktivitetit përdoret për të dhënë një pamje të përgjithshme të secilit aktivitet. Subjekti ose agjenti që përdor mjetin, dhe konteksti në të cilin përdoret, ndryshojnë, ndaj dhe nuk përfshihen. Por përmbledhja për secilin aktivitet përcakton qëllimin ose rezultatin e synuar (përfundimi), fokusin e aktivitetit (objekti) dhe materialet apo metodat (mjetet dhe artefaktet).

## **CIKLI I ZGJIDHJES SË PROBLEMIT**

Përmirësimi i aktiviteteve për edukimin e mësuesve, me qëllim harmonizimin e tyre me kërkesat e edukimit gjithëpërfshirës, kuptohet më mirë si një proces për zgjidhje problemi. Probleme si ai i përmirësimit të aktiviteteve edukuese për mësues zgjidhen përmes aktiviteteve të ndërlidhura mes tyre, të realizuara sipas një rendi kuptimplotë. Aktivitetet e udhëheqin përdoruesin përmes pyetjeve që duhen adresuar dhe çështjeve që duhen sqaruar përpara ndryshimit të praktikës aktuale për edukimin e mësuesit. Ato përfshijnë informacione nga kuadri, të dhëna në formate të dobishme, në faza të caktuara të këtij cikli për zgjidhje problemi. Kuadri ndihmon që të mbajmë gjithmonë parasysh qëllimin e përgjithshëm për përmirësimin e edukimit të mësuesve, që ka të bëjë me rritjen e efektivitetit në mbështetjen apo promovimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Cikli problem-zgjidhës i përdorur për organizimin e aktiviteteve paraqitet në Figurën 2:




Figura 2: Cikli problem-zgjidhës

Në praktikë, përmirësimi nuk do të jetë një proces rreptësisht linear ku një hap ndërmerret fill pas përfundimit të atij më përpara. Ai është një proces interaktiv e dinamik ku shpesh progresi shënohet në dy hapa njëkohësisht, pasi progresi në një hap do të hapë rrugën për ide të reja në lidhje me hapin tjetër apo atë më përpara. Megjithëse procesi në tërësi do të ndjekë ciklin problem-zgjidhës, nganjëherë do të jetë i domosdoshëm kthimi pas për të rikonsideruar ide të reja. Në jetën reale, zhvillimi i kurrikulës nuk mbaron kurrë, pasi implementimi nënvizon nevojën për përshtatje të tjera dhe evidenton kërkesa të reja trajnimi. Hapat e ndryshëm në kuadrin e ciklit problem-zgjidhës janë si më poshtë:

**Identifikimi i problemit:**

Identifikim i problemit do të thotë të bëhesh i vetëdijshëm për nevojën për ndryshim. Për të kuptuar nevojën për ndryshim duhet analizuar qasja, praktika apo gjendja aktuale në lidhje me idealin apo vizionin e praktikës gjithëpërfshirëse. Për t’i ardhur në ndihmë zhvillimit të këtij vizioni të gjerë, në këtë instrument jepet modeli i praktikës gjithëpërfshirëse së mësuesit, me të cilën mund të krahasohet qasja e përgjithshme e përdorur nga një ofrues i programeve edukuese për mësues. Përfundimi i kësaj analiza është të kuptuarit se cili është objekti apo objektivi që ka nevojë të transformohet. Për shembull, në rast se praktikatat aktuale për realizimin e kurrikulës nga shkollat perceptohen si problemi kryesor, informacioni që jepet mbi praktikatat “në mbështetje të aksesit të nxënësit te kurrikula” mund të ndihmojë për zhvillimin e një vizioni të praktikave gjithëpërfshirëse. Pikërisht sipas këtij vizioni zhvillohet perceptimi i nevojës për ndryshim apo të kuptuarit e problemit aktual.

**Vlerësimi i nevojave:**

Vlerësimi i nevojave përdor identifikimin tërësor të problemit dhe kërkon të kuptojë çfarë nënkupton kjo për grupin e targetuar. Grupi i targetuar do të ndryshojë sipas aktivitetit kryesor të organizimit që bën edukimin e mësuesve. Në edukimin fillestar apo para fillimit të punë, ky grup përbëhet nga studentë që do të bëhen mësues, aktivitetet edukuese në punë mund të fokusohen tek mësuesit e rinj, mësuesit me eksperiencë apo të dy palët. Programet për mentorë apo edukatorë të mësuesve përgjithësisht kanë për target mësues me përvojë, të cilët dëshirojnë të përvetësojnë një ekspertizë specifike për të punuar me mësues apo profesionistë të tjerë. Disa ofrues të edukimit gjithëpërfshirës përfshijnë edhe grupe të tjera, si profesionistë të tjerë që punojnë në shkolla gjithëpërfshirëse, drejtues shkollash, përfaqësues të autoriteteve vendore, inspektorë, edukatorë të mësuesve apo pjestarë të tjerë të komunitetit. Vlerësimi i nevojave bazohet tek praktika specifike që grupi target pritet të zhvillojë në kontekstin e edukimit gjithëpërfshirës. Për mësuesit

dhe profesionistët e tjerë që punojnë në shkolla gjithëpërfshirëse, të katër fushat e praktikës do të shërbejnë si model për përcaktimin e boshllëqeve apo të nevojave për zhvillim. Pastaj, përdoruesit do i duhet të vendosë se cilat janë boshllëqet që duhen adresuar në aktivitetin e radhës për edukimin e mësuesve.

#### **Synime dhe objektiva:**

Me t'u identifikuar nevojat e grupit të targetuar si nxënës dhe pasi të jetë vendosur se cila nga këto nevoja do të adresohen, mund të zhvillohen synimet dhe objektivat e aktiviteteve edukuese për mësues. Synimet e përgjithshme do të përcaktohen sipas katër fushave të praktikës, ose duke përzgjedhur njëren prej tyre, dy, tre, apo duke i konsideruar të katërta sëbashku. Për shembull, vlerësimi i diversitetit të nxënësve mund të jetë qëllimi kryesor i një workshopi të organizuar nga një organizatë jo-qeveritare për një shkollë që ka një diversitet të madh nxënësish, ndërsa një program masteri për edukimin gjithëpërfshirës do të fokusohet në të katër praktikat. Pas përcaktimit të synimeve, përshkrimi me hollësi i praktikave, i siguruar nga kuadri, mund të përdoret për të zhvilluar objektivat më specifike. Objektivat varen nga grupi target dhe mund të përfshijnë ndryshimin e qëndrimeve dhe vlerave, përvetësimin e njohurive dhe shprehive, zhvillimin e aftësive apo të qenurit faktor ndryshimi. Objektivat nuk janë vetëm shpallje e një situatë ideale në të ardhmen; ato kanë të bëjnë edhe me të kuptuarit e aktiviteteve apo të mjeteve që do të ndihmojnë mësuesit për zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Në fjalë të tjera, objektivat përmbajnë tërësinë e specifikimeve të aktivitetit të ardhshëm për edukimin e mësuesit.

#### **Strategji dhe metoda:**

Pasi janë sqaruar synimet dhe objektivat, fokusi zhvendoset tek çfarë do të bëhet në të ardhmen dhe si. Bazuar tek të gjitha specifikimet e bëra dhe tek një perceptim i mirë i asaj që mësuesit duhet të jenë në gjendje të bëjnë si rezultat i përmirësimit të aktivitetit për formimin e mësuesve, duhet menduar se çfarë duhet bërë saktësisht, dhe si, për arritjen e këtyre synimeve dhe objektivave. Duhet zhvilluar një perceptim i mirë i përmbajtjes së kurrikulës (mbulimi) dhe i mënyrave se si grupi target do të angazhohet në procesin e nxënies. Duhet menduar me kujdes se ku është më e mira të zhvillohet ky aktivitet, duke përcaktuar rrjedhimisht kontekstin social dhe fizik të aktivitetit për formimin e mësuesve. Në thelb, kjo ka të bëjë me kombinimin mes tyre të përmbajtjes, synimeve, metodave dhe kontekstit për të përcaktuar aktivitetet formuese të ardhshme për grupin target në fjalë. Kjo ka të bëjë po ashtu edhe me zhvillimin e një rendi të kuptimshëm të aktiviteteve të ndryshme dhe organizimi i tyre në formën e një plani, programi apo kurrikule.

#### **Zbatimi ose realizimi:**

Ky aktivitet është kritik për suksesin e praktikës për edukimin e mësuesve të rinj. Ai kthen në realitet diçka që është në kokën e njerëzve. Zbatimi apo realizimi i edukimit të mësuesve të rinj do të thotë të vësh në veprim atë çfarë ke planifikuar. Meqenëse kjo do të varet shumë nga situata specifike e përdoruesit, ky instrument nuk mund të japë shumë informacion për mënyrën si mund të procedohet. Përdoruesit mund t'i duhet të sigurojë mbështetje politike për të siguruar qëndrueshmërinë e aktivitetit, mundësisht duke përfshirë një proces akreditimi nga një institucion shtetëror. Mund të ketë nevojë të identifikohen dhe përfitohen burimet, infrastruktura dhe mbështetja e nevojshme. Duhet identifikuar dhe adresuar barrierat potenciale dhe duhet menduar futja në veprim e sistemit/aktivitetit të përmirësuar për formimin e mësuesit. Mund të jetë e domosdoshme që kjo të pranohet dhe të krijohet aleanca me mësues, drejtues shkollash, autoritetet vendore apo grupe të tjera relevante. Vëmendje i duhet kushtuar dokumentimit, administrimit dhe përsosjes së praktikës së re, ndërsa zbatohet si e tillë në botën reale.

#### **Vlerësimi dhe feedback-u:**

Vlerësimi i praktikës së re për formimin e mësuesve përmban vlerësimin e çdo komponenti të praktikës:

- *A ishin synimet e përzgjedhura të duhurat për t'ju udhëhequr në praktikën e re?*
- *A u arritën objektivat e synuara?*
- *A i ndryshuan pjesëmarrësit bindjet dhe qëndrimet e tyre, a fituan shprehi e dije, a i zhvilluan kompetencat sipas synimit të përcaktuar?*
- *A janë të përshatshme strategjitë dhe metodat e përzgjedhura?*
- *A u krijuan mundësitë e nevojshme për të mësuar?*

Për ta përmbledhur: A u zhvillua aktiviteti për formimin e mësuesve sipas parashikimit? Për të bërë vlerësimin e aktivitetit dhe për të marrë feedback nga pjesëmarrësit dhe palët e tjera të interesuara, mund të përdoret përsëri modeli i aktivitetit. Tek ky instrument, zbatimi, vlerësimi dhe feedback-u përshkruhen si një planifikim

i vetëm, pasi realizimi dhe hapat në vijim do të duhet të udhëhiqen nga rrethanat specifike, në të cilat realizohet aktiviteti për formimin e mësuesve.

### **AKTIVITETET PROBLEM-ZGJIDHËSE**

Çdo hap i ciklit problem-zgjidhës përfshin tre aktivitete. Për secilin aktivitet jepet një përmbledhje, duke përdorur komponentët e modelit të aktivitetit. Më pas përdoruesit i jepet informacion që ndihmon për realizimin e aktivitetit dhe nënvizon pika të rëndësishme që duhen konsideruar. Aktiviteti më pas përshkruhet në mënyrë më të hollësishme, duke dhënë formularë apo shabllone që mund të përdoren për të bërë lidhjen e aktivitetit me kuadrin e praktikave gjithëpërfshirëse (shiko pjesën tjetër).

Këtu paraqitet për orientim një përmbledhje e aktiviteteve të propozuara për çdo hap të ciklit problem-zgjidhës:

*Identifikimi i problemit: fokusi tek praktikat për edukimin gjithëpërfshirës*

Aktiviteti 2.1: Identifikimi i tërësisë së vështirësive dhe problemeve të profesionistëve

Aktiviteti 2.2: Zhvillimi i një vizioni të gjerë të praktikave gjithëpërfshirëse

Aktiviteti 2.3: Përcaktimi i nevojës për ndryshim

*Vlerësimi i nevojave: fokusi tek profesionistët e edukimit gjithëpërfshirës*

Aktiviteti 3.1: Vlerësimi i nevojave nga perspektiva e grupit target

Aktiviteti 3.2: Vlerësimi i nevojave nga perspektiva juaj

Aktiviteti 3.3: Përcaktimi i nevojave që duhen adresuar në një aktivitet të caktuar për edukimin e mësuesve

*Synimet dhe objektivat: vizualizimi i praktikës së re për edukimin e mësuesit*

Aktiviteti 4.1: Vizualizimi i synimeve dhe rezultateve

Aktiviteti 4.2: Vizualizimi i mjeteve dhe konteksteve

Aktiviteti 4.3: Zhvillimi i specifikimeve të reja

*Strategji dhe metoda: ndërtimi i praktikës së re të edukimit të mësuesve*

Aktiviteti 5.1: Përcaktimi i aktiviteteve dhe objektivave për komponentin e ri

Aktiviteti 5.2: Përcaktimi i metodave dhe rrethanave

Aktiviteti 5.3: Kombinimi bashkë i të gjithë elementëve

*Zbatimi, vlerësimi dhe feedback-u: realizimi i praktikës së re të edukimit*

Aktiviteti 6.1: Zhvillimi i një plani zbatimi

Aktiviteti 6.2: Sigurimi i kushteve të nevojshme

Aktiviteti 6.3: Administrimi, vlerësimi dhe marrja e feedback-ut



## 2. Identifikimi i Problemit: fokusi tek profesionistët e edukimit gjithëpërfshirës

### AKTIVITETI 2.1: IDENTIFIKIMI I TËRËSISË SË VËSHTIRËSIVE DHE PROBLEMEVE TË PROFESIONISTËVE

*Pamje e përgjithshme:*

#### **Qëllimi:**

- Të kuptohet dhe të rritet ndërgjegjësimi në lidhje me sfidat e realizimit të edukimit gjithëpërfshirës për sa kjo gjë lidhet me praktikën e mësuesit
- Të ndërtohet një pasqyrë e problemeve me praktikën e mësuesit në kontekstin e realizimit të edukimit gjithëpërfshirës

#### **Fokusi i Aktivitetit:**

- Profesionalizmi i mësuesve sot në rajonin apo vendin tuaj
- Sfidat dhe problemet e profesionalizmit të mësuesve të sotëm në katër fushat relevante të edukimit gjithëpërfshirës: (1) Zhvillimi Profesional Personal, (2) Vlerësimi i Diversitetit të Nxënësit, (3) Mbështetja e të Gjithë Nxënësve, dhe (4) Puna me të Tjerët

#### **Materiale dhe Metoda:**

- Letra ngjitëse për shënime, flipchart ose tabakë letre, stilolapsa
- Paraqitje grafike e modelit të aktivitetit
- Brainstorming, organizim dhe dokumentim i problemeve dhe sfidave/vështirësive

#### **Informacion sfondi:**

- Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse për mësuesit: Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse në shkolla (tek ky instrument)
- Profile të Mësuesve Gjithëpërfshirës (Agjencia Europiane 2012)
- Moduli Train the trainer i UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës (UNICEF 2015)

#### *Informacion për përdoruesin*

Përpara se të ndryshoni veprimtarinë tuaj për edukimin e mësuesve për të adresuar çështje të edukimit gjithëpërfshirës, është e rëndësishme të krijohet një perceptim i plotë i situatës së mësuesve në shkolla. “Një problem i shprehur mirë është një problem i zgjidhur mirë” (Dewey 1938), në fjalë të tjera, nëse një problem të caktuar arrijmë ta kuptojmë mirë, trajtimi i tij në fakt do të jetë më i lehtë. Fokusi këtu nuk është “mësuesi si problem”, por problemet dhe vështirësitë që mësuesit ndeshin në punën e tyre të përditshme.

Ky aktivitet mund të realizohet në mënyrë ad-hoc, pa përgatitje të mëtejshme, por përdoruesi duhet të ketë një perceptim të mirë të edukimit gjithëpërfshirës dhe mënyrën si mësuesit mund të kontribuojnë në realizimin e praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla. Në të njëjtën kohë, ky aktivitet ndihmon në aktivizimin dhe qartësimin e të kuptuarit të edukimit gjithëpërfshirës, i pranishëm tek pjesëmarrësit. Nëse gjatë këtij aktiviteti dalin në pah mospërputhje të mëdha, ato mund të trajtohen më në thellësi dhe përmes një procesi më të gjatë se ky i përshkruar këtu. Përdoruesi mund të vendosë të grumbullojë informacion relevant nga palë të ndryshme të interesuara përmes intervistave, sondazheve apo analizimit të të dhënave apo informacionit të disponueshëm.

Pjesë e kuadrit për praktikën gjithëpërfshirëse është edhe një model bazë për aktivitete me mësuesit, i cili mund të përdoret si referencë. Modeli mund të përdoret si ndihmë në organizimin e rezultateve nga ushtrimi i *brainstorming*. Ai nënvizon orientimin në përgjithësi të praktikave gjithëpërfshirëse drejt nxënësit – jo aq drejt kurrikulës si instrument. Modeli përfshin, po ashtu, edhe kontekstin social dhe fizik në të cilin zbatohet kurrikula. Rezultatet e ushtrimit *brainstorming* janë organizuar për qartësim tek ky model: a po flasim për bindjet e mësuesit në përgjithësi për diversitetin, për zbatimin e një kurrikule fleksibël, për diversitetin e nxënësve apo për krijimin e një ambienti mësimi pranues? Modeli mund të përdoret gjithashtu edhe për identifikimin e boshllëqeve. Për shembull, mund të përmendet si problem vetëdija e ulët tek mësuesit në

lidhje me aftësitë e kufizuara. Vetëdija e ulët nuk është diçka e vëzhgueshme, ndaj pyetja duhet bërë në lidhje me mënyrën si ky problem reflektohet në praktikë.

Veç modelit bazë të aktiviteteve për mësuesit, i paraqitur këtu, mund t'ju duhet të konsultoni edhe "Profilin e mësuesit gjithëpërfshirës" i përpunuar nga Agjencia Europiane për Nevojat e Posaçme dhe Edukimin Gjithëpërfshirës (2012). Profili ju jep një informacion më të detajuar mbi aftësitë/kompetencat e mësuesve sa i takon profesionalizmit të vetë mësuesit(mësuesi), vlerësimin të diversitetit të nxënësit (nxënësi), mbështetjes së të gjithë nxënësve (kurrikula) dhe punës me të tjerët (konteksti). Modulet "Train the Trainer" për Edukimin Gjithëpërfshirës" (UNICEF 2015), veçanërisht Moduli 1, përfshin aktivitete që sigurojnë një vështrim të përgjithshëm të asaj se çfarë nënkuptojnë katër fushat e aftësive/ kompetencave të mësuesve gjithëpërfshirës.

Aktiviteti fokusohet tek problemet dhe vështirësitë me të cilat ndeshen profesionistët që punojnë në shkolla, veçanërisht mësuesit. Kjo nuk do të thotë se nuk ka probleme apo vështirësi që kanë të bëjnë me palët e tjera të interesuara apo me faktorë kontekstualë si politikat apo legjislacioni, qëndrimet shoqërore apo me burimet. Por përderisa ky instrument rreket të ndihmojë në përmirësimin e aktiviteteve për formimin e mësuesve, është i nevojshëm një fokus tek profesionistët e fushës dhe praktikatat e tyre.

*Përshkrim i aktivitetit*

### Hapi 1: Seancë brainstorming në lidhje me problemet dhe vështirësitë e profesionistëve për gjithëpërfshirjen

Brainstorming është një metodë e thjeshtë për aktivizimin e mendimeve të tua, eksperiencave dhe kujtimin e gjerave që ua ka thënë të tjerët. Një mënyrë procedimi në këtë rast është shkruajtja e mendimeve tuaja në copëza të vogla letrash shënimesh.

Për stimulimin e këtij procesi mund të përdoren pyetjet më poshtë:

- Cilat janë problemet kryesore me të cilat përballen mësuesit, në vendin tuaj, në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës?
- Cilat janë problemet kryesore që kanë mësuesit në realizimin e edukimit gjithëpërfshirës?
- Çfarë duhet të jenë të aftë të bëjnë profesionistët gjithëpërfshirës përtej praktikës aktuale?

### Hapi 2: Organizimi i problemeve dhe vështirësive në katër sferat e praktikës gjithëpërfshirëse

Pasi keni hedhur në letër të gjitha mendimet tuaja, pyetjet më poshtë mund t'ju ndihmojnë për një seancë brainstorming më të fokusuar:

- Cilat janë problemet që lidhen me identitetin e mësuesve si praktikienë gjithëpërfshirës?
- Cilat janë problemet që lidhen me diversitetin e nxënësve?
- Cilat janë problemet që lidhen me kurrikulën dhe strategjitë e mësimdhënies?
- Cilat janë problemet që lidhen me kontekstin (p.sh. klasa, shkolla, komuniteti)?

Këto pyetje mund t'i përdorni për të nënvizuar problemet dhe vështirësitë e ndryshme në praktikën e mësuesit në tërësi. Pasi keni përfunduar seancën e brainstorming, duhet të organizoni vendosjen e copëzave të letrës me shënime sipas temës dhe të kontrolloni nëse janë të plota. Nëse konstatooni se për një problem specifik keni informacion vetëm për një apo dy komponente, mund t'ju duhet të vazhdoni edhe ca me brainstorming për komponentët e tjerë.




Figura 3: Modeli bazë i aktiviteteve të mësuesit për organizimin dhe plotësimin e rezultateve të ushtrimit brainstorming

### Hapi 3: Dokumentimi i vështirësive dhe problemeve duke përdorur Figurën 3 ose çdo format tjetër të zgjedhur prej jush

Pasi keni organizuar koleksionin tuaj të problemeve dhe vështirësive, është e rëndësishme që këto të dokumentohen siç duhet. Rezultatet e këtij aktiviteti do t'ju duhen për të udhëhequr hapat e tjerë në proces.

## AKTIVITETI 2.2: ZHVILLIMI I NJË VIZIONI TË GJERË TË PRAKTIKAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Pamje e përgjithshme:

### Qëllimi:

- Sigurimi i qartësisë në lidhje me vizionin e përgjithshëm të praktikës gjithëpërfshirëse, që do të udhëheqë të gjithë procesin e përmirësimit
- Organizimi i komponentëve të këtij vizioni në një praktikë, duke përdorur modelin e aktivitetit

### Fokusi i aktivitetit:

- Vizioni juaj i praktikës gjithëpërfshirëse duke iu përgjigjur pyetjeve: Kush? Çfarë? Për Çfarë/Pse? Si? Ku?
- Modeli i aktivitetit duke kombinuar bashkë të gjithë komponentët e vizionit

### Materiale dhe metoda:

- Shabllon i modelit të aktivitetit
- Letër, stilolapsa, letra shënimesh me ngjitje (opsionale)
- Vizualizimi dhe organizimi i vizionit në praktikë

### Informacion shtesë:

- Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse të mësuesit: Kuadri për praktikat gjithëpërfshirëse në shkolla (tek ky instrument)
- Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës (European Agency 2012)
- Modulet Train the Trainer të UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës (UNICEF 2015)

### Informacion për përdoruesin

Kuptimi në mënyrë të plotë i problemeve dhe vështirësive të mësuesve nuk mjafton për të kuptuar plotësisht çfarë duhet ndryshuar në praktikën tuaj dhe cilat çështje duhen adresuar nga aktivitetet tuaja për edukimin e mësuesve në të ardhmen, Ajo çfarë duhet tani është një vizion i gjerë se si gjërat mund të jenë ndryshe. Vizualizimi i një situatë ideale është e rëndësishme, pasi i jep drejtim procesit të zgjidhjes së problemeve. Pa kuptuar se ku doni të shkoni, mund të harroni thelbësoren, duke u përqendruar në detaje që nuk përfundojnë në ndonjë gjë vërtetë kuptimplote.

Është e lehtë të nxjerrësh libra, të kërkosh në internet apo të flasësh me ekspertë që përshkruajnë kompetenca të ndryshme të mësuesit, të rëndësishme për adresimin e diversitetit të nxënësve, llojin e qëndrimeve të domosdoshme për këtë gjë apo shprehitë e përdorura gjatë adresimit të çështjeve specifike që lidhen me edukimin gjithëpërfshirës. Është më vështirë të vizualizosh se si këto qëndrime, bindje, shprehi e dije, bashkë me kompetencat respektive bëhen të gjitha bashkë për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës. Nisur nga situata e tyre specifike, në një shkollë dhe komunitet specifik me nxënës me nevoja mësimi specifike, mësuesit duhet të jenë në gjendje të praktikojnë edukimin gjithëpërfshirës. - jo vetëm të flasin për të. "Të mendosh në termat e praktikës" do të thotë të nisësh nga perspektiva e mësuesit dhe të parashikosh ku fokusohet mësuesi (kush?) kur vepron (çfarë?) dhe me çfarë synimi apo qëllimi (për çfarë/pse?). Kjo kërkon po ashtu të mendosh për metodën dhe mjetet (si?) që do të përdorë mësuesi dhe në çfarë mjedisi (ku?) do të ndërmerren këto veprime nga mësuesi. Modeli i aktivitetit i bën bashkë të gjitha këto pyetje dhe ndihmon për zhvillimin e një vizioni të praktikave gjithëpërfshirëse - pa u fokusuar thjesht në cilësi të veçura të mësuesve. Idetë tuaja kësajsoj kanë nevojë të organizohen në mënyrë të tillë që të lidhen mes tyre në mënyrë të kuptimtë. Kjo arrihet duke i organizuar sipas modelit të aktivitetit. Në fillim mund të jetë e vështirë të mendosh nisur nga praktika, pa u fokusuar në ide të izoluara të "praktikës së mirë". Por avantazhet e përdorimit të një qasje tërësore për kuptimin e praktikave gjithëpërfshirëse, i zhvleftësojnë vështirësitë që hasen në procesin e familjarizimit dhe përvetësimit të kësaj qasjeje të re.

Prandaj, vizualizimi i mënyrës se si gjërat mund të jenë ndryshe dhe si mund të jetë një praktikë më gjithëpërfshirëse, është një tjetër hap shumë i rëndësishëm. Këtë aktivitet mund ta bëni vetëm ose me persona të tjerë nga organizata juaj apo me palët e interesit. Sa më i pasur kontributi, aq më i plotë do të jetë vizioni juaj. Produktin e këtij aktiviteti mund ta përdorni edhe për t'ia komunikuar të tjerëve vizionin tuaj, fjala bie, kur kërkon mbështetje financiare apo kur motivoni të tjerët për t'iu bashkuar këtij procesi përmirësues.

### Përshkrim i aktivitetit

#### Hapi 1: Vizualizim i mënyrës se si gjërat mund të jenë ndryshe

Në Aktivitetin 2.1 keni identifikuar problemet dhe vështirësitë që ndeshin mësuesit gjatë realizimit të edukimit gjithëpërfshirës. Tani ju i lini këto mënjane dhe mendoni për mënyrat se si gjërat mund të jenë ndryshe.

Për të nxitur vizualizimin mund të përdorni pyetjet më poshtë:

- Cili është lloji i personave që punojnë në shkollat gjithëpërfshirëse?
- Çfarë bëjnë prakticienët gjithëpërfshirës?
- Si duket fizikisht një shkollë gjithëpërfshirëse?
- Si dhe çfarë mësojnë fëmijët dhe të rinjtë në një shkollë gjithëpërfshirëse?
- Ku takohen fëmijët dhe të rinjtë për t'u njohur me njëri-tjetrin?
- Çfarë realizojnë shkollat gjithëpërfshirëse që shkollat e tjera nuk e bëjnë dot?
- Si ndërveprojnë njerëzit mes tyre në një shkollë gjithëpërfshirëse?
- Si ngjan një komunitet që ka një shkollë gjithëpërfshirëse?
- Si përfshihet komuniteti në punët e shkollës?

Në bazë të rezultateve të Aktivitetit 2.1 mund të gjenerohen pyetje të tjera, duke identifikuar zgjidhjet për problemet e shpallura. Shkruaji idetë tuaja në një letër apo në letra shënimesh me ngjitje dhe veçoni ato që për mendimin tuaj janë më të rëndësishmet.

Idealisht, në këtë aktivitet duhet të angazhoheni bashkë me të tjerë. Kontributi i tyre e bën vizionin tuaj më kuptimplotë për palët e interesuara. Për shembull, mund të përfshini prakticienë që janë pjesë e edukimit gjithëpërfshirës ose kanë eksperiencë në zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla. Komunikimi me të tjerë ndihmon zhvillimin e vizionit dhe mund ta lehtësojë komunikimin e tij më vonë

## Hapi 2: Vizualizimi i një praktike gjithëpërfshirëse ideale

Ka shumë të ngjarë që Hapi 1 i këtij aktivitetit të rezultojë me lindjen e shumë ideve – jo domosdoshmërisht drejtpërsëdrejti të lidhura mes tyre. Veçanërisht, nëse në diskutim marrin pjesë grupe të tjera të interesit, idetë dhe deklaratat për gjërat e diskutuara mund të mbështeten në pikëpamje të ndryshme mbi edukimin dhe mund të adresojnë shumë çështje që nuk lidhen direkt me praktikën gjithëpërfshirëse. Tani do ju duhet të vendosni prioritetet, t'i kondensoni apo organizoni këto ide për të fituar një vizion të praktikave gjithëpërfshirëse ideale. Rekomandohet që për këtë qëllim të përdorni modelin e aktivitetit, duke përcaktuar çështjet që duhen adresuar dhe duke organizuar idetë dhe vizionet tuaja. Këtë ushtrim mund ta bëni vetëm ose me të tjerë. Më poshtë keni shabllonin respektiv (Figura 4).

Zgjidhni idetë ose vizionet më të rëndësishme dhe përpunoni të krijoni pamjen më të plotë të mundshme duke adresuar secilin syresh me anë të pyetjeve në vijim:

- **Kush/Cili:** Cilat janë qëndrimet, shprehjet, ditjet, kompetencat dhe ndikimi i mësuesve apo profesionistëve të tjerë për përmbushjen e këtij vizioni apo ideje? (Fokusi tek subjekti, personi që vepron)
- **Çfarë:** Ku duhet të fokusohen, për çfarë duhet të punojnë apo çfarë duhet të ndryshojnë për përmbushjen e këtij vizioni apo ideje? (Fokusi i aktivitetit)
- **Për çfarë/pse:** Cili është rezultati që duhet të kenë në mendje praktikienët ose cilat janë synimet apo qëllimet që duhet të udhëheqin praktikën e tyre për përmbushjen e këtij vizioni apo ideje? (Qëllimi)
- **Si:** Si jep mësim një praktikien gjithëpërfshirës, si ndërvepron apo komunikon; çfarë metodash, mjedesh apo kurrikulash përdor për përmbushjen e këtij vizioni apo ideje? (Mjete dhe artefakte)
- **Ku:** Ku duhet të punojë një praktikien gjithëpërfshirës dhe cilat janë karakteristikat e një mjedisi gjithëpërfshirës për përmbushjen e këtij vizioni apo ideje? (Konteksti)

Mund të përdorni këtë shabllon të modelit të aktivitetit për të zhvilluar vizionin tuaj të praktikës gjithëpërfshirëse ideale të mësuesit. Nëse ushtrimin e bëni me të tjerë, transferojeni shabllonin në flipchart ose përdorni tregues me dritë / projektor për ta projektuar modelin mbi një mur. Pastaj mund të përdorni copa letre me ngjitje për të paraqitur idetë e ardhura nga pjesëmarrësit. Mund të përdorni një shabllon për secilën nga idetë apo vizionet, që konsiderohet si e rëndësishme dhe mjaft e plotë për t'u eksploruar. Mund edhe të bëni një foto të të gjitha shablloneve të plotësuara për qëllime dokumentimi.




Figura 4: Përdorimi i modelit të aktivitetit për të krijuar vizionin e praktikës gjithëpërfshirëse

### Hapi 3: Dokumentimi i praktikave gjithëpërfshirëse ideale

Pasi keni përfunduar paraqitjen grafike të vizionit tuaj, sipas modelit të aktivitetit – duke i zhvilluar kështu në praktika ideale të ardhshme, do t'ju duhet të vendosni cilët nga këto vizione janë mjaftueshëm të gjerë për të udhëhequr procesin më pas. Mund të zhvilloni vetëm një vizion duke përdorur modelin bazë të aktiviteteve të mësuesit (Tabela 1) ose mund të zgjidhni të përdorni të katër fushat e praktikave të mësuesit (fokusi tek mësuesi, nxënësi, kurrikula, konteksti).

Në këtë mënyrë dokumentoni vizionin tuaj të praktikave gjithëpërfshirëse ideale të mësuesit apo të profesionistëve të tjerë, në varësi të kontekstit në të cilin është bërë kjo gjë. Nëse aktivitetin e bën një ekip mësuesish, rezultatet mund të bëhen pjesë e programit zhvillues të shkollës, Në rast se këtë vizion e zhvillon një organizatë jo-qeveritare, ai do të udhëheqë zhvillimin e programit të tyre dhe do të ndihmojë në komunikimin me donatorë apo partnerë të tjerë. Formulime prezantuese të këtij vizioni mund të përdoren për të komunikuar me të tjerët në lidhje me aktivitetin tuaj për edukimin e mësuesve, për shembull gjatë fazës së implementimit.

## AKTIVITETI 2.3: PËRCAKTIMI I NEVOJËS SË PËRGJITHSHME PËR NDRYSHIM

*Pamje e përgjithshme:*

### Qëllimi:

- Eksplorimi i diferencës mes problemeve të identifikuar dhe vizionit të praktikës gjithëpërfshirëse
- Përcaktimi i nevojës më të rëndësishme për ndryshim në lidhje me profesionalizmin e mësuesve, vlerësimin e diversitetit të nxënësve, një kurrikul që mbështet të gjithë llojet e nxënësve, punën me të tjerët për të krijuar mjedise aftësuese, si për praktikën e mësuesit, edhe për edukimin e mësuesit

### Fokusi i Aktivitetit:

- Probleme dhe vështirësi të identifikuar në Aktivitetin 2.1
- Vizioni i gjerë i praktikave gjithëpërfshirëse të zhvilluara në Aktivitetin 2.2

### Materiale dhe Metoda:

- Nuk ka nevojë për materiale
- Krahasim, diskutim, përpilim informacioni

### Informacion Shtesë

- Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse në shkolla (tek ky instrument)
- Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës (European Agency 2012)
- Profesionit i Mësuesit në Shekullin 21. Avancimi i Profesionalizmit të mësuesit për Gjithëpërfshirjen, Cilësinë dhe Edukimin – ATEPIE (Qendra për Politikën Arsimore, Beograd 2013)
- Kompetencat Kyç të Diversitetit (Këshilli i Europës, 2009)

### Informacion për përdoruesin

Në fund të procesit për identifikimin e problemit, është e rëndësishme të kuptohet diferenca mes gjendjes aktuale, përfshirë të gjitha problemet dhe vështirësitë që ndeshen nga mësuesit në praktikën e tyre, dhe vizionit të një praktike gjithëpërfshirëse, e zhvilluar në Aktivitetin 2.2. Krahasimi mes asaj që është sot dhe asaj që duhet të jetë, nënvizon nevojën për formim të mësuesit. Ky aktivitet në thelb është një analizë e hendekut të krijuar, që krahason praktikën aktuale me praktikën e dëshiruar për të ardhmen.

Në këtë pikë, fokusi nuk është tek ajo që duhet të mësojnë mësuesit në një fazë të caktuar të jetës së tyre profesionale (p.sh. si student mësuesie, mësues i ri, mësues me përvojë apo ekspert i mësuesisë). Fokusi është tek nevojat, në përgjithësi e profesionit të mësuesit apo e profesioneve të tjera që operojnë në një terren të edukimit gjithëpërfshirës.

## Përshkrimi i aktivitetit

**Identifikimi i nevojës për ndryshim**

Deri tani, keni krijuar një perceptim të përgjithshëm të problemeve dhe paraqitjen e tyre në lidhje me profesionalizmin e mësuesve, vlerësimin e diversitetit të nxënësve, mbështetjen e të gjithë nxënësve dhe punën me të tjerët për krijimin e një mjedisi aftësues (Aktiviteti 2.1). Keni krijuar ide mbi praktikën e ardhshme që do të kontribuojnë më mirë për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës (Aktiviteti 2.2).

Tani ju lutem mendoni për pyetjet më poshtë dhe shkruani mendimet tuaja në lidhje me to:

- Cili është hendeku kryesor mes praktikës aktuale dhe praktikës gjithëpërfshirëse të ardhshme
- Çfarë karakteristikash të vizionit tuaj mund të adresohen nga mësuesit trajnues dhe profesionistët e tjerë?
- A mund ta identifikoni me saktësi nevojën për ndryshim dhe ta shkruani?

Organizoni mendimet tuaja sipas të katër fushave të kompetencave të mësuesit siç janë përcaktuar tek Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës (shiko Materiale dhe Metoda). Pasi ta keni bërë këtë gjë, përdorni Tabelën 1 për të dokumentuar nevojën për ndryshim. Fillimisht mbushni seksionin "hendeku i identifikuar / nevoja për ndryshim tek praktika e mësuesit" pastaj reflektoni në lidhje me hendekun respektiv dhe nevojat për ndryshim në edukimin e mësuesve. Në vend të Tabelës 1, mund të preferoni të përdorni një format të ndryshëm sipas nevojës tuaj për detajim dhe organizim.

	Hendeku i identifikuar / nevoja për ndryshim tek praktika e mësuesit	Hendeku i identifikuar/ nevoja për ndryshim në edukimin e mësuesve
Zhvillimi profesional për prakticienët gjithëpërfshirës		
Vlerësimi i diversitetit të studentëve për të promovuar aksesin, pjesëmarrjen & mësimin, arritjen		
Mbështetja e të gjithë nxënësve për të mundësuar aksesin në kurrikul		
Puna me të tjerët për të krijuar një mjedis aftësues		
Çështje të tjera:		

Tabela 1: Dokumentimi i nevojës për ndryshim në katër fushat e praktikës gjithëpërfshirëse



### 3. Vlerësimi i nevojave: fokusimi tek praktikat për edukim gjithëpërfshirës

#### AKTIVITETI 3.1: VLERËSIMI I NEVOJAVE NGA PERSPEKTIVA E GRUPIT TUAJ TARGET

Pamje e përgjithshme:

##### Qëllimi:

- Kuptimi më në detaje i mënyrës se si nevoja për ndryshim ndikon tek grupi juaj target.

##### Fokusi i Aktivitetit:

- Çfarë mund të bëjë aktualisht dhe çfarë nuk mund të bëjë grupi juaj target në lidhje me praktikat gjithëpërfshirëse

##### Materiale dhe Metoda:

- Listë e hendeqeve të identifikuar dhe nevojat e përpiluara në Aktivitetin 2.3
- Letër, stilolapsa, letra shënimesh me ngjitje (opsional)
- Brainstorming, dokumentim

##### Informacion shtesë:

- Kuadri për praktikat gjithëpërfshirëse në shkolla (tek ky instrument)
- Profili i Mësuesit Gjithëpërfshirës (European Agency 2012)
- Profesionit i Mësuesit në Shekullin 21. Avancimi i Profesionalizmit të mësuesit për Gjithëpërfshirjen, Cilësinë dhe Edukimin Relevant – ATEPIE (Qendra për Politikat Arsimore, Beograd 2013)
- Kompetencat Kyç të Diversitetit (Këshilli i Europës, 2009)

#### Informacion për përdoruesin

Seksioni më përpara fokusohet tek nevoja e përgjithshme për ndryshim, që prek të gjithë profesionistët dhe të gjithë aktivitetin për edukimin e mësuesve. Kjo ishte e rëndësishme për të pasur një pamje të përgjithshme, që mund të përdoret nëpër fazat e ndryshme të zhvillimit profesional dhe për profesionistët e ndryshëm që punojnë në shkolla gjithëpërfshirëse. Tani na duhet një analizë më e detajuar dhe më e fokusuar për të kuptuar nevojën e një grupi target specifik (p.sh, studentët mësues në seancat e trajnimit të tyre fillestar, mësues me përvojë që punojnë në shkolla). Çfarë nënkupton për grupin tuaj target kjo nevojë e përgjithshme për ndryshim? A është grupi juaj target mjaftueshëm kompetent e rrjedhimisht i aftë për të realizuar praktikën gjithëpërfshirëse?

Grupi juaj target mund të jetë me mësues apo profesionistë të tjerë, madje edhe prindër apo pjestarë të komunitetit, që kontribuojnë për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës. Grupi juaj target mund të jenë studentë mësuesie, mësues të rinj, mësues me përvojë apo mësues ekspertë. Ata janë në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre profesional, ndaj dhe do të kenë nevoja të ndryshme. Për shkollat që angazhohen në zhvillimin profesional, për t'u bërë më gjithëpërfshirëse, ky aktivitet do të fokusohet tek ata vetë dhe tek kolegët e tyre të punës.

Për këtë aktivitet duhet që grupin tuaj target ta shikoni sa më të gjerë me qëllim që të mos përjashtoni pjesëmarrës potencialë të ardhshëm në aktivitetin tuaj edukues. Kjo mund të bëhet duke tërhequr një kategori të ndryshme nga ajo që trajtoni sot, ose duke zgjeruar fushën tuaj të veprimit për të përfshirë mësues në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre profesional apo profesionistë të tjerë.

## Përshkrimi i aktivitetit

**Hapi 1: Vlerësimi i nevojave të grupit tuaj target - Brainstorming**

Kaloni të gjithë Tabelën 1 të plotësuar (produkt i Aktivitetit 2.3; kolona majtas mbi hendekun e identifikuar /nevoja për ndryshim në praktikën e mësuesit) dhe shqyrtoni ato që keni shkruajtur për të përshkruar nevojën për ndryshim nga perspektiva e grupit.

- Sa shumë do të ndikohet grupi target nga nevoja e identifikuar për ndryshim (Aktiviteti 2.3)?
- Cila është diferenca mes praktikave aktuale dhe praktikave të ardhshme të parashikuara për gjithëpërfshirjen për grupin tuaj target?
- Sa i përgatitur është aktualisht grupi juaj target për të filluar këtë praktikë të re?
- Për çfarë ka nevojë të përgatitet grupi juaj target në këtë fazë specifike të zhvillimit profesional?
- Ku ka gjasa të hasë në vështirësi grupi juaj target dhe pse (p.sh, në lidhje me qëndrimet, bindjet, shprehjet & njohuritë, kompetencat dhe aftësia për ndikim)?

Shkruajini mendimet tuaja në një letër ose në një letër shënimesh me ngjitje siç ju vinë mendje. Me të mbaruar, merrni ca kohë për organizimin e mendimeve tuaja sipas të katër fushave të praktikës gjithëpërfshirëse (shiko Aktivitetin 2.3) ose sipas një formati të zgjedhur prej jush.

Mund të doni t'i diskutoni këto pyetje me grupe të tjera interesi apo me përfaqësues të grupit tuaj target për ta pasuruar diskutimin dhe për të marrë informacione shtesë mbi nevojat e grupit tuaj target. Kjo mund të ndihmojë për bashkëpunimin në të ardhmen me organizma të tjera ofruese të edukimit për mësues për të pasur një perceptim të përbashkët të nevojave në tërësi të grupit tuaj target për zhvillim profesional.

**Hapi 2: Krahasimi i nevojave të identifikuar me informacionin e dhënë në kuadër**

Tani shkoni tek kuadri për zhvillimin e praktikës gjithëpërfshirëse. Lexoni përshkrimet e dhëna për secilën fushë të praktikës gjithëpërfshirëse dhe krahasojini ato me rezultatet nga ushtrimi me brainstorming. Bëjini vetes pyetjet e mëposhtme:

- A identifikon formacioni i dhënë nevoja që ju nuk i keni konsideruar ende?
- A identifikon informacioni tek "Fokusi tek Aftësitë" nevoja ende të pakonsideruara nga ju?
- A identifikon informacioni tek "Objekti dhe Objektiva" nevoja ende të pakonsideruara nga ju?
- A identifikon informacioni tek "Mjete dhe Strategji" nevoja ende të pakonsideruara nga ju?
- A identifikon informacioni tek "Konteksti " nevoja ende të pakonsideruara nga ju?

Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve duhet të arrini të bëni një listë të plotë të nevojave relevante për grupin tuaj target. Në këtë fazë, thjesht sigurohuni të keni menduar çdo gjë të rëndësishme. Mund të keni nevojë të ktheheni tek Aktiviteti 2.2 ku keni përpunuar një vizion të gjerë të praktikës gjithëpërfshirëse. Mund të jetë ndonjë pikë që nuk e keni adresuar ende.

**Hapi 3: Vendos çfarë është e rëndësishme dhe cilat janë nevojat e grupit tuaj target në lidhje me të**

Rezultatet tuaja tani duhen organizuar në mënyrë të tillë që të mund t'i përdorni në hapat e tjerë të ciklit për zgjidhjen e problemeve. Do t'ju duhet të vendosni cilat janë praktikave më të rëndësishme për grupin tuaj target dhe cilat janë nevojat e tyre në lidhje me to: Cilat praktika gjithëpërfshirëse janë absolutisht të nevojshme në mënyrë që grupi juaj të mund të kontribuojë për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës? Çfarë ndryshimesh apo përmirësimesh janë të nevojshme në mënyrë që grupi juaj të mund të angazhohet në praktika gjithëpërfshirëse?

Përdorni Tabelën 2 për të identifikuar praktikave për grupin tuaj dhe nënvizuar nevojën për përgatitje më të mirë. Përzgjidh informacionin më të rëndësishëm të siguruar nga Hapi 2 dhe përdorni kuadrin për referencë. Mund të doni të përfshini në këtë aktivitet grupe të tjera interesi apo përfaqësues të grupit tuaj.

	Praktikat në vijim janë shumë të rëndësishme për grupin tonë target:	Grupi ynë target ka nevojë të përgatitet më mirë për:
Zhvillimi Profesional për prakticienët gjithëpërfshirës		
Vlerësimi i diversitetit të nxënësve për të promovuar aksesin, pjesëmarrjen & nxënien, arritjen		
Mbështetja e të gjithë nxënësve për të mundësuar aksesin në kurrikul		
Puna me të tjerë për të krijuar një mjedis aftësues		
Çështje të tjera:		

Tabela 2: Nevojat e grupit tuaj target në lidhje me praktika të rëndësishme

### AKTIVITETI 3.2: VLERËSIMI I NEVOJAVE NGA PERSPEKTIVA JUAJ

Pamje e përgjithshme:

#### Qëllimi:

- Kuptimi më në detaje i mënyrës si ndikon tek ju nevoja për ndryshim
- Përkufizimi i kontributit tuaj në edukimin e mësuesve, në bazë të mandatit që ju keni

#### Fokusi i Aktivitetit:

- Nevojat që po adresoni apo që do të adresoni në të ardhmen
- Përgatitja juaj për t’iu përgjigjur nevojave në përgjithësi

#### Materiale dhe Metoda:

- Lista e hendeqeve të identifikuara dhe e nevojave të përpiluara në Aktivitetin 2.3
- Tabela e plotësuar tek Aktiviteti 3.1
- Shabllon i modelit të Aktivitetit (opsionale)
- Letër, stilolapsa, letra me ngjitje (opsionale)
- Brainstorming, organizim, krahasim, dokumentim

#### Informacion Shtesë:

- Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse në shkollë (tek ky instrument)
- Fondacioni European i Trajnimit (2011). Report Teachers for the Future: Teacher Development for Inclusive Education in the Western Balkans.

*Informacion për përdoruesin*

Tani ndryshoni perspektivë dhe e vendosni veten në pozicionin e dikujt që dëshiron të kontribuojë në realizimin e edukimit gjithëpërfshirës përmes edukimit të mësuesve. Ky aktivitet ka të bëjë me shikimin e gjërave nga perspektiva juaj specifike (si edukator i mësuesve, mësues, drejtues shkolle) dhe me identifikimin e asaj që ju do të donit të ndryshoni. Aktivitetet për edukimin e mësuesve mund të ofrohen në vende të ndryshme, duke përdorur strategji të ndryshme, që nga leksioni në universitet, mbajtja e një workshopi në një komunitet, deri tek ndarja e praktikës suaj përmes një ore mësimi të hapur në një shkollë. Mësuesi mund të mësojë edhe në kontekstin e bashkëpunimit të një kolegu me përvojë me një me më pak përvojë, me qëllim rritjen e vetëdijes, transferimin e njohurive dhe ndërtimin e kompetencave dhe angazhimit.

Aktivitetet për edukimin e mësuesve për edukimin gjithëpërfshirës duhet të synojnë adoptimin e praktikave gjithëpërfshirëse - jo vetëm të shkollave. Edukimi gjithëpërfshirës bazohet në parimet e nxënies aktive,, të vetë-rregulluar, respektit për diversitetin dhe zhvillim personal - për të përmendur vetëm një pjesë të tyre. Në të shkuarën, aktiviteti për edukimin e mësuesit mbështetej kryesisht tek leksionet, ndërsa tani duhet të mendoni për një rol më aktiv të grupit tuaj target. Mund t'ju duhet të vendosni një marrëdhënie më të ngushtë me shkollat për kapërcimin e hendekut mes teorisë dhe praktikës. Nëse jeni një drejtues shkolle i përfshirë në zhvillimin profesional të personelit tuaj, gjykimi nga pozicioni i një "edukatori mësuesish" ju ndihmon për të reflektuar mbi strategjitë efektive për promovimin e zhvillimit profesional gjatë punës.

Mbani parasysh që të tjerët mund të kenë pikëpamje të ndryshme në lidhje me praktikën tuaj. Për shembull, mund t'ju duhet të njihni këndvështrimet e shkollave që pranojnë studentët tuaj të mësuesisë për trajnimin praktik gjatë edukimit të tyre fillestar ose, si drejtues shkolle, mund të doni të përfshini personelin tuaj, përfaqësues nga autoritetet vendore, inspektorë apo palë të tjera që kanë njohuri për praktikën tuaj.

*Përshkrimi i aktivitetit***Hapi 1: Identifikimi i nevojave nga perspektiva juaj - Brainstorming**

Shqyrtoni Tabelën 1 të plotësuar (Aktiviteti 2.3; përfshirë kolonën në të djathtë për hendekun e identifikuar/ nevoja për ndryshim në lidhje me edukimin e mësuesit). Ju lutem konsideroni pyetjet në vijim:

- Çfarë hendeku/nevojë për ndryshim në lidhje me praktikën e mësuesit doni të adresoni?
- Çfarë hendeku/nevojë për ndryshim në lidhje me edukimin e mësuesit doni të adresoni?

Tani keni identifikuar çfarë doni të adresoni në aktivitetin tuaj për edukimin e mësuesve, të cilin po e përmirësoni. Për të kuptuar sa më mirë atë që doni të adresoni, zgjeroheni perceptimin tuaj me anë të teknikës së brainstorming:

- **Kush:** Cilat qëndrime, shprehje & njohuri, kompetenca të mësuesve apo profesionistëve të tjerë doni të adresoni dhe zhvilloni? (Fokusi tek subjekti, personi veprues)
- **Çfarë:** Çfarë aktivitetesh doni të përdorni për të zhvilluar praktikën e mësuesit? (Fokusi i aktivitetit)
- **Për çfarë/Pse:** Çfarë synimesh apo qëllimesh duhet të udhëheqin praktikën që duam të zhvillojmë? (Qëllimi)
- **Si:** Cilat metoda, mjete apo strategji duam të zhvillojmë? (Mjete dhe Artefakte)
- **Ku:** Në çfarë konteksti duam që mësuesit të jenë të aftë të zhvillohen e të punojnë? (Konteksti)

Mund të përdorni shabllonin e modelit të aktivitetit dhënë tek Aktiviteti 2.2 për organizimin e rezultateve të seancës brainstorming. Mund të angazhoheni vetë në një seancë të shkurtër brainstorming thjesht për të kuptuar më mirë hendeqet dhe nevojat që duhet të adresoni ose mund të angazhoheni në një ushtrim të zgjeruar për të kuptuar në detaje praktikën që doni të zhvilloni përmes aktivitetit tuaj edukues. Vendimi do të varet nga nevoja juaj për dokumentim apo komunikim me organizma të tjera ofruese apo grupe të tjera të interesuara.

## Hapi 2: Vlerësimi i nevojave të grupit tuaj target nga perspektiva juaj

Hapi 1 ju siguron një kuptim bazë të nevojave apo hendeqeve që doni të adresoni në përgjithësi në kuadrin e edukimit të mësuesit. Hapi tjetër ju ndihmon të fokusoheni tek nevojat e grupit tuaj target, të cilat jeni në gjendje t'i adresoni. Për shembull, në rast se jeni një profesor që punonin në edukimin fillestar të mësuesve, do të jeni në gjendje të angazhoheni në disa aktivitete edukuese, por jo në të tjera. Nëse punoni për një organizatë joqeveritare, mandati juaj mund të jetë i kufizuar në fusha të caktuara të praktikës së mësuesit.

Merrni Tabelën 2 të plotësuar (Aktiviteti 3.1) dhe shikoni si i jeni përgjigjur pyetjes “çfarë është e rëndësishme për grupin tuaj target” dhe “ku ka nevojë të përgatitet më mirë grupi juaj”. Tani do të përqendroheni tek kontributi juaj (i tanishëm dhe i ardhshëm) identifikuar në hapin 1. Mund të ketë organizma të tjerë ofrues të aktiviteteve edukuese për mësues, që punojnë me të njëjtin grup target ose ju, thjesht, mund të mos jeni në gjendje të adresoni të gjitha nevojat për arsye burimesh apo kufizimesh në kohë.

- Cilat nga nevojat e grupit tuaj target po adresoni aktualisht?
- Cilat nga nevojat e grupit tuaj target do të adresoni në të ardhmen?
- Cilat nga nevojat e grupit tuaj target nuk do të jeni në gjendje të adresoni?
- Çfarë komponentësh të aktiviteteve tuaja edukuese për mësues adresojnë çfarë nevojash?
- Cilat nga nevojat e identifikuar mund të adresohen vetëm nëse ndryshoni praktikën tuaj?
- Sa të përgatitur jeni për të adresuar nevojat e identifikuar të grupit tuaj target?

Shkruani mendimet tuaja në një copë letër ashtu siç ju vinë në mendje. Pasi ta keni bërë këtë, shpenzoni ca kohë për organizimin e mendimeve tuaja sipas katër fushave të praktikës gjithëpërfshirëse (shiko Aktivitetin 2.3) ose sipas një formati të zgjedhur nga ju. Mund të doni t'i ktheheni vizionit të praktikës gjithëpërfshirëse që keni zhvilluar (Aktiviteti 2.2) për t'u siguruar se i keni adresuar të gjitha pikat më të rëndësishme.

Njëlloj si tek Aktiviteti 3.1., mund të përdorni kuadrin për zhvillimin e praktikës gjithëpërfshirëse ose thjesht mund t'i referoheni informacionit që përpiluat tek Tabela 2 (Aktiviteti 3.1). Kaloni të gjithë tabelën dhe vendosni për secilin zë nëse doni ta adresoni apo jeni mund ta adresoni në kuadrin e aktiviteteve edukuese për mësues.

Mund të doni që këtë aktivitet ta bëni sëbashku me organizma të tjerë ofrues të këtyre aktiviteteve, me grupe të tjera të interesuara, apo me përfaqësues të grupit tuaj target, për ta pasuruar diskutimin dhe për të dëgjuar mendime të tjera në lidhje me nevojat që duhen adresuar nga ju në të ardhmen. Kjo mund të jetë veçanërisht e dobishme për bashkëpunimin në të ardhmen me ofrues të tjerë aktiviteteve të tilla për koordinim dhe komplementim aktiviteteve.

## Hapi 3: Dokumentimi i nevojave të grupit tuaj target, që doni të adresoni

Rezultati i këtij aktiviteti duhet të jetë një dokument ku përcaktohen nevojat që doni të adresoni në aktiviteteve tuaja të ardhshme për edukimin e mësuesve, si dhe nevojën për ndryshim në praktikën tuaj për adresimin e tyre. Mund të jetë gjithashtu e dobishme të dokumentoni çfarë nuk do të adresoni për arsye koordinimi me ofrues të tjerë.

Mund të përdorni Tabelën 3 (shiko më poshtë) për këtë qëllim. Kjo ju ndihmon për të nënvizuar informacionin që ju mungon, për të lidhur rezultatet me aktivitetet e mëparshme dhe për të mundësuar krahasimin e informacionit përgjatë ciklit për zgjidhjen e problemit.

Nisur nga perspektiva juaj...	Nevoja që doni të adresoni në aktivitetet tuaja për edukimin e mësuesve:	Nevoja juaj për ndryshim për adresimin e kësaj nevoje të grupit tuaj target:
Zhvillimi profesional për prakticienët gjithëpërfshirës		
Vlerësimi i diversitetit të nxënësve për të promovuar aksesin, pjesëmarrjen & nxënien, arritjen		
Mbështetja e të gjithë nxënësve për të lehtësuar aksesin në kurrikul		
Puna me të tjerë për krijimin e një mjedisi aftësues		
Çështje të tjera:		

Tabela 3: Vlerësimi në tërësi i nevojave nga perspektiva juaj

### AKTIVITETI 3.3: PËRCAKTIMI I NEVOJAVE PËR T’U ADRESUAR NË NJË AKTIVITET TË CAKTUAR TË EDUKIMIT TË MËSUESVE

Pamje e përgjithshme:

#### Qëllimi:

- Identifikimi i nevojave për t’u adresuar në një aktivitet të caktuar të edukimit të mësuesve
- Përcaktimi i nevojave për nxënie i profesionistëve që marrin pjesë në aktivitetin tuaj formues për mësues

#### Fokusi i Aktivitetit :

- Nevojat që ju adresoni në një aktivitet të caktuar të edukimit të mësuesve
- Përgatitja juaj për t’iu përgjigjur këtyre nevojave

#### Materiale dhe Metoda:

- Rezultatet e Aktiviteteve 3.1 dhe 3.2

#### Informacion Shtesë:

- Kuadri dhe Informacioni në Pjesën 3
- Fondacioni European i Trajnimit (2011). Report Teachers for the Future: Teacher Development for Inclusive Education in the Western Balkans.

#### Informacion për përdoruesin

Aktiviteti 3.3 është aktiviteti kyç për të vendosur se cilat nga nevojat që lidhen me praktikën gjithëpërfshirëse në shkolla, do të trajtohen në aktivitetin formues që jeni duke përmirësuar aktualisht. Shumica e institucioneve që merren me formimin e mësuesve ofrojnë programe, kurse, module e workshope të ndryshme dhe të gjithë duhet të kontribuojnë për realizimin e praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla. Idealisht, tërësia e këtyre aktiviteteve duhet t’i përgjigjet nevojave të identifikuara deri tani të grupit tuaj target. Në këtë rast, informacioni i zhvilluar tek Aktiviteti 3.2 ka nevojë të ndahet në zëra dhe të përshtatet me aktivitetin formues që është në proces përmirësimi. Në rast se ofroni vetëm një aktivitet formues për mësues, rezultatet e Aktivitetit 3.2 mund të përdoren direkt për përpunimin e qëllimeve dhe objektivave dhe nuk ka nevojë të bëni Hapin 1 të Aktivitetit 3.3.

Për qëllime koordinimi është e rëndësishme të shpallni jo vetëm nevojat që ju po adresoni, por edhe ato që nuk po i adresoni. Institucione të tjera ofruese të këtyre aktiviteteve mund të jenë në pozicion më të favorshëm për të trajtuar nevoja të caktuara, ose nevoja të caktuara mund të adresohen më mirë në një fazë më të hershme apo më të vonë të zhvillimit profesional të mësuesit. Hapi 2 i Aktivitetit 3.3 sugjeron që edhe të dokumentoni cilat nga nevojat e grupit tuaj target nuk do të adresohen nga ju. Ky informacion është shumë i rëndësishëm në komunikimin me institucione të tjera që ofrojnë formim për të njëjtën fazë, apo një fazë më të hershme a më të vonshme të zhvillimit profesional të mësuesit. Kjo gjë do të lehtësojë komunikimin dhe koordinimin e aktiviteteve formuese për mësues gjatë gjithë ciklit të jetës profesionale të mësuesit.

Veç kësaj, mund të identifikoni nevojat që shkojnë përtej asaj që mund të arrihet me anë të edukimit të mësuesit, pasi për to kërkohen ndryshime në legjislacion apo reformim i kurrikulës. Megjithëse këto nevoja shkojnë përtej aktivitetit tuaj imediat për edukimin e mësuesve, është e rëndësishme të dokumentohen. Për këtë qëllim mund të përdoret informacioni i dhënë në kapitullin për “zhvillimin e aftësive/kompetencave gjatë gjithë ciklit të jetës profesionale” për të katër fushat e praktikës gjithëpërfshirëse (shiko kuadrin në pjesën tjetër).

#### *Përshkrim i aktivitetit*

### **Hapi 1: Ndarja në zëra i rezultateve nga Aktiviteti 3.2, nëse duhet**

Nëse ofroni aktivitete të ndryshme për edukimin e mësuesve dhe keni bërë një vlerësim të zgjeruar të nevojave, rezultatet do t’ju duhet t’i ndani në zëra, duke u fokusuar tek një aktivitet i caktuar, të cilin doni ta përmirësoni. Kthehuni tek Aktiviteti 3.2 dhe përzgjidhni nevojat që do të adresoni në kuadrin e një aktiviteti të caktuar. Mund t’ju duhet ta bëni këtë ushtrim për të gjitha aktivitetet tuaja për të përmirësuar pajtueshmërinë dhe komplementaritetin.

Nëse ofroni vetëm një aktivitet edukues për mësues, atëherë informacioni nga aktiviteti 3.2 mund të përdoret për aktivitetet në vijim pa ndryshime.

### **Hapi 2: Identifikimi i nevojave për t’u adresuar nga aktivitete të tjera apo institucione të tjera ofruese**

Për të mundësuar komunikimin me ofrues të tjerë të edukimit të mësuesve, është e rëndësishme të bihet dakord në lidhje me aftësitë që duhen zhvilluar në secilën fazë të zhvillimit profesional. Ndaj, reflektoni në lidhje me atë se çfarë duhet përpara ose pas fazës së zhvillimit profesional të mësuesit, ku jeni duke punuar.

Analizoni rezultatet nga Hapi 1 (Aktiviteti 3.2) duke gjykuar se çfarë ka nevojë të ndërtohet në të njëjtën kohë, përpara apo pas aktivitetit tuaj për edukimin e mësuesve. Ndajini rezultatet me ofrues të tjerë të këtij edukimi dhe me partnerë të tjerë me qëllim harmonizimin e aktiviteteve tuaja me ta.

### **Hapi 3: Identifikimi i nevojës tuaj për zhvillim dhe i nevojave të tjera për ndryshim**

Bazuar në Aktivitetin 3.2 dhe hapi 1 dhe 2 i këtij aktiviteti, tani mund të jepni informacion në lidhje me mënyrat se si ju, si ofrues, duhet të ndryshoni apo zhvilloni praktikën tuaj. Kjo është e rëndësishme për t’u siguruar se keni kohën e mjaftueshme për ndërtim kapacitetesh, ndërkohë që jeni në proces përmirësimi të aktivitetit tuaj formues.

Duke përdorur informacionin e grumbulluar tashmë, tani mund të reflektoni edhe në lidhje me nevojën për ndryshim apo problemet e ndeshura në praktikën aktuale, që nuk mund të adresohen nëpërmjet aktiviteteve për edukimin e mësuesit. Shikoni mundësitë tuaja për adresimin e tyre me mjete të tjera, për shembull me anë të punës kërkimore, projekteve shkollore apo zhvillimit të mjeteve e metodave të reja.

Së fundi, duhet të konsideroni gjithashtu edhe ndryshimet që do t’u duhet të adresojnë të tjerët, pasi bëhet fjalë për gjëra që shkojnë përtej mandatit tuaj. Duke bashkëpunuar me partnerë publikë e privatë, disa nga këto nevoja mund të adresohen në të ardhmen. Shkëmbejini rezultatet tuaja me grupe të tjera interesi në fushën e edukimit gjithëpërfshirës, të cilët mund të ndihmojnë për ndërtimin e kapaciteteve në fushat e identifikuar.



## 4. Qëllime dhe komponente: vizualizimi i praktikës së re për edukimin e mësuesit

### AKTIVITETI 4.1: VIZUALIZIMI I QËLLIMEVE DHE REZULTATEVE

*Pamje e Përgjithshme:*

#### **Qëllimi:**

- Eksplorimi i kontributeve të mundshme për zhvillimin e aftësive dhe praktikave të mësuesit
- Përcaktimi i tërësisë së komponentëve bazuar në kontributin që doni të ofroni

#### **Fokusi i Aktivitetit:**

- Qëllimet dhe rezultatet që doni të arrini (“Pse/Për çfarë?”)
- Aktivitete që ndihmojnë për arritjen e qëllimeve (“Çfarë?”)

#### **Materiale dhe Metoda:**

- Rezultate nga Aktiviteti 2.2 dhe Aktiviteti 3.3

#### **Informacion Shtesë:**

- Modulet Train the Trainer të UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës
- Fondacioni European i Trajnimit (2011). Report Teachers for the Future: Teacher Development for Inclusive Education in the Western Balkans.

#### *Informacion për përdoruesin*

Tashmë keni realizuar një perceptim solid të nevojave që doni të adresoni në kuadrin e aktivitetit tuaj për edukimin e mësuesve dhe keni kuptuar deri diku se si do t’ju duhet ta ndryshoni aktivitetin tuaj për t’iu përgjigjur këtyre nevojave (shiko rezultatet e Aktivitetit 3.3). Tani duhet të ndërroni këndvështrimin tuaj nga ai i bazuar tek nevojat tek një këndvështrim që bazohet tek qëllimet. Për këtë qëllim, duhet të kaloni nga analizimi dhe kuptimi i problemeve tek parashikimi i zgjidhjeve dhe zhvillimi i qëllimeve. Tani nuk do të shikoni më pas, por do të nisni të shihni përpara.

Gabimi i zakonshëm që bëhet në këtë pikë është trajtimi veçmas i secilit problem dhe gjetja e zgjidhjes për të. Për shembull, mësuesit kanë nevojë të ndryshojnë qëndrimet e tyre negative ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara, kështu ju planifikoni aktivitete për ndërgjegjësimin e tyre. Megjithatë, nëse këto aktivitete nuk janë të lidhura me aktivitetet e mësuesve në klasë, ato do të kenë shumë pak efekt tek praktika e mësuesit. Nëse mësuesit nuk janë në gjendje të bëjnë vlerësimin e nevojave për të mësuar dhe të jenë efektivë në lehtësimin e procesit të nxënies, një “vetëdije e rritur” mbi aftësitë e kufizuara mund të ketë madje ndikim negativ tek nxënësit. Zgjidhja e problemeve dhe adresimi i nevojave kërkon rinovim të praktikave aktuale. Vizioni i zhvilluar në Aktivitetin 2.2 do t’ju ndihmojë të mbani parasysh vizionin e përgjithshëm për praktikën gjithëpërfshirëse.

Tani duhet të eksploroni çfarë kontributesh doni të bëni në të ardhmen; një vizualizim i qëllimeve apo rezultateve të synuara prej jush dhe aktivitetet që do të përdorni për arritjen e këtyre qëllimeve. Në fjalë të tjera: Duhet të zbuloni çfarë doni të arrini në të ardhmen dhe çfarë do të bëni për të arritur qëllimet e parashikuara.

Si të gjitha aktivitetet njerëzore, aktivitetet për edukimin e mësuesve kanë të kufizimet e tyre për arsye kohe dhe hapësire. Me një kombinim të zgjuar të qëllimeve do të mund të shfrytëzoni më së miri kohën që keni në dispozicion. Për shembull, studentët mësues, ndërsa punojnë me një koleg të verbër në kuadrin e një projekti shkollor në komunitet, si pjesë e trajnimit të tyre praktik, mundet që njëherazi të mësojnë të bashkëpunojnë, të rrisin ndërgjegjësimin në lidhje me aftësitë e kufizuara dhe të kuptojnë më mirë nevojat për mbështetje.

Si rezultat i këtij aktiviteti, duhet të keni fituar një kuptim më të gjerë të komponentëve të praktikave tuaja të reja të edukimit të mësuesve, përfshirë qëllimet që kërkonin të arrini përmes këtyre komponentëve. Të menduarit në lidhje me modelin e aktivitetit do t’ju nxisë jo vetëm të mendoni përmbajtjen që doni të absorbojë grupi juaj target, por edhe aktivitetet që do të realizojnë ata për arritjen e qëllimeve që ju do të përcaktoni tek hapi 1. Grafikët e përdorur tek kuadri për zhvillimin e praktikës gjithëpërfshirëse mund t’ju ndihmojnë të ruani fokusin tek qëllimet dhe aktivitetet më shumë se sa tek përmbajtja.

Përshkrimi i aktivitetit

### Hapi 1: Vizualizimi i qëllimeve dhe rezultateve që synoni

Merrni rezultatet nga Seksioni 3 (Aktiviteti 3.1., Aktiviteti 3.2, Aktiviteti 3.3) dhe kaloni pyetjet në vijim:

- Cilat janë rezultatet e pritura nga aktiviteti juaj i ardhshëm për edukimin e mësuesve?
- Cilat aktivitete do t'ndihmojnë më mirë mësuesit për të zhvilluar aftësitë e nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të identifikuar?
- Në çfarë temash do të donit të angazhohej grupi juaj target në kuadrin e këtyre aktiviteteve?
- Cili do të ishte qëllimi i këtyre aktiviteteve?
- Cilat do të ishin synimet tuaja në angazhimin e grupit tuaj target në këto aktivitete?

Fillimisht mund të doni të organizoni disa aktivitete me teknikën brainstorming për përcaktimin e aktiviteteve. Rezultatet e brainstorming lidhni me të katër fushat e praktikës dhe sigurojuni që të adresojnë të gjitha nevojat e identifikuar.

### Hapi 2: Përcaktimi i komponentëve të praktikës suaj të ardhshme

Pas fazës së eksplorimit në hapin 1 duhet të mendoni komponentët që doni të përfshini në praktikën tuaj të ardhshme të edukimit të mësuesve. Këta komponentë do të jenë blloqet ndërtues të praktikës suaj të ardhshme. Si shembull, mund të doni të përdorni Modulet Train the Trainer të UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës. Janë tre module dhe secili përmban disa njësi që fokusohen në aspekte specifike të praktikës gjithëpërfshirëse.

Mënyra si i zhvillon këto komponente dhe i përshkruani ato do të varet nga kërkesat e rrethanave tuaja. Nuk ekziston një mënyrë më e mirë për ta bërë këtë. Mund të doni të përdorni për referencë të katër fushat e praktikës së prakticienëve gjithëpërfshirës (Pjesa 3) ose të përdorni parime të tjera organizuese (p.sh, bazuar në standardet e përdorura në situatën tuaj apo në misionin e organizatës tuaj). Për secilin komponent duhet të përcaktoni parametrat e mëposhtëm:

- Emri ose titulli i komponentit
- Rezultatet ose qëllimet e pritura që doni të arrini me këtë komponent.
- Aktivitetet ku doni të angazhoni grupin tuaj target
- Qëllimi i aktiviteteve specifike dhe si lidhen ato me rezultatin e pritur

Në fund të aktivitetit, duhet të keni një përmbledhje të komponentëve që doni të përfshini në aktivitetin tuaj të ri, apo të përmirësuar, të edukimit të mësuesve.

## AKTIVITETI 4.2: VIZUALIZIMI I MJETEVE DHE I KONTEKSTIT

Pamje e përgjithshme:

#### Qëllimi:

- Eksplorimi i metodave dhe qasjeve që doni të përdorni për komponentët e identifikuar
- Përcaktimi i tërësisë së metodave dhe qasjeve që mund të përdoren në një situatë të caktuar

#### Fokusi i Aktivitetit:

- Mjetet me anë cilave doni të arrini rezultatet (Si?)
- Konteksti në të cilin doni t'arrini këto rezultate ("Ku")

#### Materiale dhe Metoda:

- Rezultatet nga Aktiviteti 4.1 (Komponentët)
- Informacioni i dhënë në Pjesën 3 (Kuari për Zhvillimin e Praktikës Gjithëpërfshirëse) për referencë

#### Informacion Shtesë:

- Fondacioni Europian i Trajnimit (2011). Report Teachers for the Future: Teacher Development for Inclusive Education in the Western Balkans.

*Informacion për përdoruesin*

Tek Aktiviteti 4.1 keni zhvilluar komponentët që doni të përfshini në praktikën tuaj të edukimit të mësuesit. Nëse nuk e keni bërë ende këtë gjë, tani duhen të mendoni për metodat ose mjetet që doni të përdorni dhe kontekstin, kushtet apo rrethanat në të cilat do të punoni në të ardhmen. Në fjalë të tjera, tani do të duhet të konsideroni “Si-në” dhe “Ku-në” e aktivitetit tuaj formues me mësuesit në të ardhmen. Kjo është një pjesë e rëndësishme e procesit tuaj të vizualizimit: Vizualizimi i mënyrës në të cilën ju do të arrini qëllimet tuaja është po aq i rëndësishëm sa vizualizimi i vetë qëllimeve dhe rezultateve përfundimtare.

Duke shtuar informacionin mbi metodat dhe rrethanat që ju doni të përdorni apo krijoni për aktivitetet tuaja të reja edukuese, krijoni një vizualizim të plotë të praktikave tuaja të reja.

*Përshkrimi i aktivitetit***Hapi 1: Eksplorimi i metodave, qasjeve dhe konteksteve për komponentët**

Tek Aktiviteti 4.1 keni identifikuar komponentët që doni të përfshini në aktivitetin tuaj të ardhshëm për edukimin e mësuesve. Tani do të bëni pyetjet “Si?” (metodat, strategjitë) dhe “Ku?” (konteksti, infrastruktura, rrethanat). Për secilin nga komponentët e praktikës tuaj të ardhshme, siç i keni zhvilluar tek Aktiviteti 4.1, tani do të përcaktoni parametrat e më poshtëm:

- Cila është strategjia më e mirë për angazhimin e grupit tuaj target (p.sh. leximi i letërsisë, shkrimi i tezave, puna me një rast studimor, mësimi mes kolegësh, zhvillimi i mësimëve, ndërveprimi me familjet apo fëmijët, etj.)?
- Çfarë metodash dhe mjetesh duhen për realizimin e aktiviteteve të planifikuara në komponentët tuaj?
- Ku ose në çfarë mjedisi doni të realizoni aktivitetin (konteksti)?
- Çfarë infrastrukture ju duhet për të realizuar aktivitetet e parashikuara tek komponentët?
- Çfarë partnerësh apo mjedisi social ju duhen për realizimin e aktiviteteve të komponentëve?

**Hapi 2: Përcaktimi i metodave, qasjeve dhe konteksteve për komponentët**

Pasi të keni përpiluar një përgjigje të kënaqshme për të gjitha pyetjet e bëra në Hapin 1, këtë informacion mund t’ia shtoni informacionit mbi komponentët të zhvilluar tek Aktiviteti 4.1. Tashmë keni një listë të pasuruar të komponentëve duke përfshirë jo vetëm një përshkrim të komponentëve, por edhe të asaj që kërkon të arrini me to dhe mënyrën si doni të punoni brenda këtyre komponentëve.

**AKTIVITETI 4.3: ZHVILLIMI I SPECIFIKIMEVE TË REJA***Pamje e Përgjithshme:***Qëllimi:**

- Zhvillimi i specifikimeve të mundshme për aktivitetin tuaj të ri për edukimin e mësuesve
- Përcaktimi i specifikimeve tuaja të reja duke bërë bashkë pyetjet “Çfarë”, “Pse”, “Si”, “Ku” dhe “Kush”.

**Fokusi i Aktivitetit:**

- Komponentët, përfshirë qëllimet, aktivitetet, metodat dhe qasjet, kontekstet dhe krijimin e rrethanave
- Specifikimet e reja për t’u përdorur

**Materiale dhe Metoda:**

- Rezultatet nga Aktiviteti 4.1 dhe 4.2
- Shablloni i Modelit të Aktivitetit për përcaktimin e specifikimeve
- Letra shënimesh me ngjitje

**Informacion Shtesë:**

- Modulet Train the Trainer të UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës
- Fondacioni European i Trajnimit (2011). Report Teachers for the Future: Teacher Development for Inclusive Education in the Western Balkans.

### Informacion për përdoruesin

Qëllimi i këtij aktiviteti është zhvillimi dhe përcaktimi i specifikimeve të reja për secilin nga komponentët e zhvilluara tek Aktiviteti 4.1 dhe 4.2. Për këtë qëllim duhet të përdorni modelin e aktivitetit, pasi operimi në këtë mënyrë ka shumë avantazhe. Paraqitja grafike ndihmon diskutimin dhe seancat e brainstorming në ekip, informacioni është më i aksesueshëm se sa në një dokument me tekst dhe ndryshimet mund të bëhen më me lehtësi, veçanërisht nëse përdorni letrat për shënime me ngjitje sëbashku me një variant të zmadhuar të modelit të aktivitetit (i vizatuar në flipchart apo i projektuar në mur).

Ky aktivitet tërheq gjithashtu vëmendjen ndaj jush dhe kolegëve tuaj, si ofrues të edukimit për mësues në të ardhmen (kush). Në fjalë të tjera, duhet të përfshini specifikime edhe për veten tuaj (shikoni edhe paraqitjen grafike të zhvilluar tek Aktiviteti 3.2).

Pasi të keni përfunduar një shabllon të modelit të aktivitetit për secilin nga komponentët e aktivitetit tuaj edukues të ardhshëm, mund të kontrolloni nëse specifikimet janë realiste dhe në pajtueshmëri me njëra-tjetrën. Për shembull, nëse doni që mësuesit të zhvillojnë aftësinë e tyre për të mbështetur të gjithë nxënësit dhe planifikoni t'i mësoni ata si të shkruajnë një plan edukativ individual, këtu ka një mospërputhje që ju duhet të adresoni. Shkruajtja e një plani edukativ individual nuk është e njëjta gjë si të sigurosh mbështetje për procesin e nxënies. Për referencë dhe për të nënvizuar boshllëqet që ekzistojnë në specifikimet e secilit komponent të aktivitetit të ardhshëm për edukimin e mësuesve, mund të përdoret Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse.

### Përshkrimi i aktivitetit

#### Përcaktimi i specifikimeve të aktivitetit tuaj edukues të përmirësuar

Tani, ju lutem, kaloni gjithë procesin tuaj të vizualizimit të komponentëve dhe mjeteve. Një mënyrë e mirë për ta bërë këtë është duke plotësuar me informacion shabllonin e modelit të aktivitetit. Këtë gjë mund ta bëni për secilin nga komponentët veç e veç, por është po ashtu e rëndësishme ta bëni këtë gjë për të gjithë praktikën tuaj të përmirësuar. Kjo përfshin përgjigjen ndaj pyetjeve më poshtë:

- Objektivat që doni të arrini në tërësi (Pse?). Rezultatet e procesit të nxënies, arritjet, ndryshimi i qëndrimeve, shprehitë & njohuritë, kompetencat.
- Ku doni të angazhohet grupi juaj target? Përmbajtja, fokusi i vëmendjes, aktivitetet.
- Cilat janë metodat, qasjet që do të përdorni për të angazhuar grupin tuaj target (Si)?
- Çfarë konteksti ju duhet të përdorni apo të krijoni për të mundësuar procesin e nxënies (Ku)?
- A jeni të përgatitur për t'u angazhuar me grupin tuaj në këtë mënyrë (Kush)? Nevoja për ndryshim, përgatitja, sigurimi i shprehive dhe njohurive, etj. për veten tuaj.

Kontrolloni modelin e plotësuar të aktivitetit dhe sigurohuni që të mos ketë asnjë kundërshti dhe se ajo që kërkon të arrini është e realizueshme !

Kontrolloni modelin e aktivitetit dhe sigurohuni që praktika e zhvilluar i përmbahet parimeve të edukimit gjithëpërfshirës!

Nëse duhet, bëni rregullime të mëtejshme dhe mbani shënim rezultatet e aktivitetit në një format që ju ndihmon për të ndërtuar praktikën tuaj të re të mësuesit për seksionin tjetër.




Figura 5: Shabllon i modelit të aktivitetit për ndërtimin e specifikimeve të reja

## 5. Strategji dhe Metoda: Ndërtimi i Praktikës së Re të Edukimit të Mësuesit

### AKTIVITETI 5.1: PËRCAKTIMI I AKTIVITETEVE DHE OBJEKTIVAVE PËR KOMPONENTËT

Pamje e përgjithshme:

#### Qëllimi:

- Detajimi i informacionit për komponentët sipas aktiviteteve të ndryshme dhe objektivave
- Organizimi i përmbajtjes për t'iu përgjigjur kërkesave institucionale

#### Fokusi i Aktivitetit:

- Rezultatet nga Aktiviteti 4.3 dhe çdo informacion tjetër i gjeneruar në lidhje me përmbajtjen
- Aktivitetet dhe objektivat brenda secilit komponent

#### Materialet dhe Metoda:

- Materialet dhe metodat do të varen nga kërkesat institucionale apo organizative

#### Informacion Shtesë:

- Modulet Train the Trainer të UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës

#### Informacion për përdoruesin

Duke nisur me vizualizimin e qëllimeve dhe të rezultateve, keni ndërtuar tashmë komponentët e praktikës tuaj të ardhshme për edukimin e mësuesve. Këta komponentë ka shumë mundësi të jenë shumë të zgjeruar dhe ka nevojë të detajohen në nivel aktivitetesh. Aktivitetet që përbëjnë një komponent, duhet të lidhen me objektivat që janë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve dhe rezultateve përfundimtare në tërësi. Të jesh i aftë të shkruash një plan individual edukimi është vetëm një nga objektivat e shumta për t'u arritur dhe është në vetvete e pamjaftueshme për sigurimin e praktikave gjithëpërfshirëse.

Ky aktivitet ka për qëllim ndarjen e komponentëve (të paraqitura në modelin e aktivitetit) në aktivitete ku do të angazhohen mësuesit studentë, pjesëmarrësit e një workshopi apo të një programi trajnimi. Për të parë

si mund të bëhet kjo gjë, shikoni Modulet Train the Trainer të UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës. Secili nga të tri modulet ndahet në njësi të ndryshme dhe secila njësi përbëhet nga disa aktivitete që eksplorojnë aspekte apo elementë të ndryshëm të praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla.

Në rast se vizualizimi juaj i komponentëve është bërë në detaje, mund t'ju ketë mbetur shumë pak punë për të bërë në këtë pikë. Në rast se jeni në procesin e përmirësimit të një programi studimi, komponentët e zhvilluar në seksionin e fundit do të jenë shumë të gjerë për të përshkruar mjaftueshëm aktivitetin tuaj të ri apo të përmirësuar të edukimit të mësuesve. Tek Aktiviteti 4.3 keni zhvilluar specifikimet e plota për secilin komponent sipas orientimit të këtij instrumenti apo në bazë të informacioneve të tjera për edukimin gjithëpërfshirës. Për një përshkrim më të detajuar të asaj që do të bëni në të ardhmen, do t'ju duhet të merrni parasysh praktikën dhe rregulloret e institucioneve dhe organizatave pjesëmarrëse. Shumë Universitete apo fakultete të studimeve pedagogjike kanë specifikuar se si duhet të jetë një plan studimi, përshkrimi i një moduli apo një kurrikul.

Formati për dokumentimin e rezultateve përfundimtare të këtij aktiviteti do të duhet të përcaktohet nga ju, në mënyrë që ai të jetë në përputhje me kërkesat që duhet të plotësoni në situatën tuaj specifike. Kjo do të varet nga institucioni apo organizata, për të cilën punoni, dhe nga kërkesat shtesë të përcaktuara nga palët e treta, si, për shembull, agjencitë qeveritare përgjegjëse për akreditimin apo supervizionin.

*Përshkrimi i aktivitetit*

#### Detajimi i komponentëve në aktivitete

Për këtë aktivitet, ju duhen specifikimet e reja për komponentët e zhvilluara tek Aktiviteti 4.3. Ato u zhvilluan në lidhje me qëllimet dhe rezultatet e përgjithshme, që kërkonin të arrini. Këto qëllime të përgjithshme duhen detajuar në objektiva që mund të realizohen me angazhimin e grupit tuaj target në aktivitete. Këto objektiva dhe aktivitetet e ndërtuara për realizimin e tyre mund të jenë blloqet e ndërtimit për kursin, modulin, workshopin apo programin tuaj.

Aktivitetet përfaqësojnë mundësi të rëndësishme mësimi, ku grupi juaj target angazhohet për t'iu përgjigjur objektivave specifike. Objektivat duhet të ndihmojnë për arritjen e objektivave të përgjithshme të përcaktuara për çdo komponent. Një aktivitet mund të zgjasë shumë jave apo vetëm ca orë. Elementet e modelit të aktivitetit ndihmojnë për të reflektuar dhe përcaktuar mënyrën si prisni të involvohet grupi juaj.

Në këtë pikë, përpiquni të ndani komponentët në aktivitete të ndryshme duke përdorur, nëse ju ndihmon, modelin e aktivitetit. Si rezultat, duhet të keni të paktën një listë aktivitetesh të organizuara sipas komponentëve. Nëse është e nevojshme, shikoni mundësinë e rishikimit të komponentëve.

## AKTIVITETI 5.2: PËRCAKTIMI I METODAVE DHE RRETHANAVE

*Shikim i përgjithshëm:*

#### **Qëllimi:**

- Organizimi bashkë i të gjithë informacionit për të përcaktuar metodologjinë e detajuar
- Organizimi i metodologjisë për trajtimin e kërkesave institucionale

#### **Fokusi i Aktivitetit:**

- Rezultatet nga Aktiviteti 4.3 dhe çdo informacion tjetër i gjeneruar mbi metodat dhe rrethanat
- Metodën dhe rrethanat brenda secilit komponent

#### **Materialet dhe Metodën:**

- Materialet dhe metodat do të varen nga kërkesat institucionale dhe organizative

#### **Informacion Shtesë:**

- Modulet Train the Trainer të UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës

*Informacion për përdoruesin*

Hapi tjetër është kthimi i informacionit mbi mjetet dhe kontekstet për komponentët, në një informacion më të detajuar mbi metodat dhe rrethanat e përshtatshme për aktivitetet e parashikuara. Në rast se vizualizimin e mjeteve dhe konteksteve (Aktiviteti 4.2) e keni bërë të detajuar, këtu mund të keni pak punë për të bërë.

Shumica e pikave të ngritura në aktivitetin më përpara (Aktiviteti 5.1) janë të zbatueshme edhe këtu, p.sh. nevoja për të marrë parasysh udhëzimet dhe specifikimet relevante për institucionin apo organizatën tuaj. Për shembull, në rast se punoni në kontekstin e një universiteti, mund të jeni të kufizuar në ndryshimin e praktikave aktuale. Do t'ju duhet të paraqisni në një mënyrë specifike planin e ri të studimit, përshkrimin e modulit apo të planit të zhvillimit të shkollës suaj. Për këtë qëllim mund të merrni specifikimet e reja që keni përpiluar tek seksioni 4 (vizualizimi i praktikës së re) dhe t'i bëni më konkrete, duke iu përgjigjur, në këtë mënyrë, kërkesave dhe rrethanave në të cilat po ushtroni veprimtarinë tuaj. Mundet që i keni shqyrtuar tashmë metodat dhe qasjet në kuadrin e Aktivitetit 5.1. Në këtë rast nuk ju duhet të shtoni ndonjë informacion shtesë. Vetëm sigurojuni që gjërat të jenë në përputhje të plotë.

Formati për dokumentimin e rezultateve përfundimtare të këtij aktiviteti do të duhet të përcaktohet nga ju, për të qenë në përputhje me kërkesat që duhet të plotësoni në situatën tuaj specifike. Kjo do të varet nga institucioni apo organizata për të cilën punoni dhe nga kërkesat shtesë të përcaktuara nga palët e treta, si, për shembull, agjencitë qeveritare përgjegjëse për akreditimin apo supervizionin.

*Përshkrimi i aktivitetit***Përcaktimi i metodave dhe i mjedisit për aktivitetet e parashikuara**

Produkti i Aktivitetit 5.1 duhet të jetë një listë e strukturuar (p.sh. komponente, njësi, aktivitete) e asaj që do të bëni në të ardhmen. Nëse ende nuk i keni menduar metodat apo mjetet që do të përdoren në këto aktivitete apo mjedisin në të cilin do të kryhen, ky është momenti për ta bërë këtë gjë.

Mendoni secilin aktivitet të listuar dhe zhvilloni ide për mënyrën e ndërtimit të tyre për të arritur në mënyrën më të mirë objektivin e vendosur. Duke vepruar kështu, në fakt po zhvilloni praktikën ku do të angazhoni grupin tuaj target. Mendoni për përfshirjen e metodave novatore (p.sh. nxënia përmes bashkëpunimit) rrethana të reja (vizita studimore) ose mënyra për kombinimin e tyre (p.sh. qasja e klasave të hapura, mikro-mësimi).

**AKTIVITETI 5.3: BËRJA BASHKË E TË GJITHË ELEMENTEVE***Pamje e përgjithshme:***Qëllimi:**

- Bërja bashkë e të gjithë informacionit për të përshkruar aktivitetin tuaj të ardhshëm të edukimit të mësuesve
- Përcaktimi i burimeve të nevojshme për realizimin e aktivitetit për edukimin e mësuesve

**Fokusi i Aktivitetit:**

- Programi i studimit ose kurrikula
- Burimet e domosdoshme

**Materialet dhe Metodot:**

- Materialet dhe metodat do të varen nga kërkesat institucionale dhe organizative

**Informacion Shtesë:**

- Modulet e UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës



### Informacion për përdoruesin

Kjo fazë ka të bëjë me bërjen bashkë të të gjithë elementeve të diskutuara për ndërtimin e aktivitetit tuaj të ardhshëm për edukimin e mësuesve, përfshirë burimet e nevojshme për këtë gjë.

Mund të doni të shikoni Modulet Train the Trainer të UNICEF-it për Edukimin Gjithëpërfshirës si një ilustrim i mënyrës si mund të organizohet dhe paraqitet informacioni relevant i ndërtuar. Ka shumë mundësi që t'ju duhet të plotësoni kërkesat e institucionit apo organizatës tuaj, kur të paraqisni informacionin në lidhje me aktivitetin tuaj të ri për edukimin e mësuesve. Në rast se aktiviteti juaj edukues, për të përfituar fonde, duhet të akreditohet apo të njihet, do t'ju duhet të ndiqni formatin dhe të jepni informacionin e kërkuar.

Pasi të keni kompletuar pamjen e përgjithshme të asaj që do të bëni në kuadrin e aktivitetit tuaj të ri apo të përmirësuar për edukimin e mësuesve, ju keni tashmë të gjithë informacionin që ju duhet për llogaritjen e kostove. Mund t'ju duhet të paguani trajnerët apo edukatorët, të merrni me qira hapësirën ku do të realizohen aktivitetet formuese, do të ketë kosto për materialet e po ashtu edhe për profesionistë të tjerë të angazhuar në aktivitete të caktuara. Në rast se trajnimi përfshin profesionistë që merren me mësimdhënie, mund t'ju duhet të mbuloni koston e mësuesve zëvendësues.

## 6. Zbatimi, vlerësimi dhe feedback-u: realizimi i praktikës së re për edukimin e mësuesve

### AKTIVITETI 6.1: ZHVILLIMI I NJË PLANI ZBATIMI

Pamje e përgjithshme:

#### Qëllimi:

- Reflektim mbi hapat e nevojshëm për zbatimin e praktikës së re
- Reflektim mbi burimet e nevojshme për zbatimin

#### Fokusi i Aktivitetit:

- Afatet kohore dhe momentet kyçe të zbatimit
- Burimet e nevojshme për zbatim
- Nevoja për ndërtim kapacitetesh (ju dhe kolegët tuaj, partnerë të tjerë)

#### Materiale dhe Metoda:

- Për t'u përcaktuar nga përdoruesi

### Informacion për përdoruesin

Tani që keni zhvilluar një aktivitet të ri për edukimin e mësuesve, ju duhet të mendoni si ta bëni realitet atë. Ka shumë të ngjarë që në organizatën, universitetin apo shkollën tuaj ekzistojnë praktika të tjera zbatimi. Sigurohuni që plani i zbatimit të ketë një kalendar realist dhe t'i keni menduar të gjitha burimet e nevojshme për zbatim. Mund të jetë e nevojshme që aktivitetin tuaj edukues ta përfshini në planin strategjik të organizatës tuaj me qëllim sigurimin e burimeve dhe mbështetjen e nevojshme institucionale.

Përmirësimi i praktikës ekzistuese apo zbatimi i një kurrikule të re nënkupton gjithmonë kosto shtesë. Mund të duhet të përditësohet faqja e internetit, duhen zhvilluar e rishikuar materiale mësimore, mund të duhet të botohen broshura të reja, të organizohen evente për të informuar grupin target në lidhje me këtë mundësi të re edukimi për mësues.

Po ashtu duhet të konsideroni burimet njerëzore të nevojshme për zbatimin. Mund t'ju duhet të investoni në ndërtim kapacitetesh për të siguruar zbatimin me sukses të aktivitetit tuaj të ri edukues. Ju apo kolegët tuaj mund të keni nevojë për aftësi të reja, partnerët tuaj në shkolla, ministritë apo organizatat jo-qeveritare mund të kenë gjithashtu nevojë të trajnohen. Vlerësimi në mënyrë kritike i aftësive vetjake si një prakticien gjithëpërfshirës është një obligim etik i edukatorëve të mësuesve. Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse (Pjesa 3) është i vlefshme edhe për edukatorët, jo vetëm për mësuesit.

## AKTIVITETI 6.2: SIGURIMI I KUSHTEVE TË NEVOJSHME

*Pamje e përgjithshme:*

### **Qëllimi:**

- Reflektim mbi kushtet e nevojshme për zbatim të suksesshëm
- Reflektim mbi partneritetet e nevojshme për zbatim të suksesshëm

### **Fokusi i Aktivitetit:**

- Parakushtet politike dhe legjislative dhe nevoja potenciale për ndryshim
- Parakushtet profesionale dhe nevoja potenciale për ndryshim
- Parakushtet financiare dhe nevoja potenciale për ndryshim

### **Materialet dhe Metodat:**

- Për t'u përcaktuar nga përdoruesi
- Analiza SWOT

### **Informacion Shtesë:**

- Fondacioni European i Trajnimit (2011). Report Teachers for the Future: Teacher Development for Inclusive Education in the Western Balkans.

### *Informacion për përdoruesin*

Asnjë aktivitet edukimi nuk është i qëndrueshëm, në rast se nuk mbështetet politikisht, profesionalisht dhe financiarisht. Ndaj është e rëndësishme të reflektohet në lidhje me burimet e disponueshme dhe si mund të zgjerohen ato, nëse është e nevojshme. Kjo mund të nënkuptojë edhe kërkimin e partnerëve të ri apo vendosjen e lidhjeve strategjike me partnerë ekzistues.

Parakushtet politike dhe legjislative mund të përfshijnë proceset aktuale të akreditimit, kërkesat e certifikimit të mësuesve dhe legjislacionin përkatës për zhvillimin profesional të mësuesve. Është e rëndësishme të sqaroni si përputhet me këto aktiviteti juaj edukues për mësuesit dhe si mund të siguroheni që arritjet e pjesëmarrësve njihen formalisht si të tilla.

Tek parakushtet profesionale mund të hyjë edhe pozicioni i shoqatave të mësuesve apo çdo grup tjetër interesi me ndikim të fortë në përcaktimin e profesionalizmit të mësuesve dhe përshkrimin e punës. Këto grupe duhet të mbështesin edukimin gjithëpërfshirës dhe një vizion për profesionalizmin e mësuesit në harmoni me edukimin gjithëpërfshirës. Mund të përfshini edhe konsiderata etike dhe kërkesa minimale për arritjen e statusit të mësuesit gjithëpërfshirës.

Do t'ju duhet ta dokumentoni informacionin përkatës, tek plani i zbatimit, ose në një dokument më vete. Pa marrjen e masave të tjera për realizimin e edukimit gjithëpërfshirës, aktiviteti juaj edukues mund të mos jetë i qëndrueshëm.

Një mënyrë për të analizuar situatën në rajonin apo vendin tuaj është bërja e Analizës SWOT. Për më shumë i formacion mbi këtë metodë, referojuni burimeve në internet.

### **AKTIVITETI 6.3: ADMINISTRU, VLERËSO DHE MERR FEEDBACK**

*Pamje e përgjithshme:*

**Qëllimi:**

- Realizimi i aktivitetit të përmirësuar të edukimit të mësuesve

**Fokusi i Aktivitetit:**

- Praktika e re e edukimit të mësuesve
- Probleme që dalin gjatë zbatimit
- Perspektiva dhe pikëpamje të tjerëve

**Materialet dhe Metodot:**

- Për t'u përcaktuar nga përdoruesi

*Informacion për përdoruesin*

Pas përfundimit të zbatimit të aktivitetit të ri për edukimin e mësuesve, duhet bërë një vlerësim i jashtëm, por ndërkohë, duhet të monitoroni progresin e aktivitetit tuaj të ri edukues edhe gjatë procesit të zbatimit. Është e rëndësishme të vendosni një dialog me pjesëmarrësit, por edhe me grupin tuaj target, në përgjithësi, për të kuptuar më mirë çfarë funksionon e çfarë jo dhe ku ka nevojë për rishikim apo përmirësim. Nëse po bëni përmirësim të aktivitetit apo po zbatoni një program të ri master apo çdo kurs trajnimi afatgjatë, mund të keni nevojë të konsideroni zhvillimin e një plani monitorimi dhe vlerësimi.

## **Pjesa 3:**

Kuadri për Praktikën Gjithëpërfshirëse

## Kuadri për Praktikën Gjithëpërfshirëse

### 1. Një fokus tek praktika

#### Modeli bazë i aktiviteteve të mësuesit

Në zemër të kuadrit për praktikën gjithëpërfshirëse është modeli i aktivitetit, i cili u prezantua tek Pjesa 2 e këtij instrumenti. Mësuesit dhe edukatorët e mësuesve janë agjentë ose subjekte dhe ky instrument i shikon praktikën edukuese me sytë e tyre. Aktiviteti në tërësi i mësuesve orientohet drejt atij që mëson. Bindjet dhe aftësitë e mësuesve ndikojnë tek perceptimi që ata kanë për nxënësin dhe influencojnë aktivitetet e tyre dhe ndërveprimin me nxënësin. Mjeti më i rëndësishëm i mësuesit është kurrikula. Kurrikula është përdorur këtu si një term ombrellë për përmbajtjen, qëllimet dhe strategjitë e përdorura për procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Ajo përmbledh në vetvete të gjithë vijueshmërinë e instruksionit dhe ndërveprimit që ndodh në një klasë nisur nga qëllimet edukuese që një mësues, një shkollë apo një sistem arsimor kërkon të realizojë. Konteksti i aktiviteteve të mësuesit është kryesisht klasa, por edhe hapësira të tjera si shkolla apo komuniteti. Mësuesit duhet të krijojnë mundësi për të mësuar në mjedisin e shkollës. Këta komponentë mund të përfaqësohen në modelin e aktivitetit më poshtë:




Figura 6: Praktika dhe edukatorët e mësuesve

Ky model mund të zbatohet si në aktivitetet për edukimin e mësuesve, edhe në aktivitetet e mësuesit, dhe ndihmon në analizimin e praktikës, si të edukatorëve të mësuesit, edhe të mësuesve në shkolla. Në rastin e aktiviteteve për formimin e mësuesve, mësuesi mund të jetë një profesor universiteti, pjesëtar i fakultetit të studimeve pedagogjike, konsulent i një organizate qeveritare apo jo-qeveritare, një përfaqësues ministrie

ose çdokush tjetër në rolin e edukatorit të mësuesve ose të mentorit për mësuesit e tjerë. Në pozicionin e nxënësit mund të jenë studentët mësues, mësuesit e rinj, ose ekipe të shkollës. Kurrikula mund të shprehet tek programet e studimeve apo tek përshkrimet e workshopeve dhe mund të përmbajë formulim të përmbajtjes, qëllimeve e arritjeve të pritura në zhvillimin e aftësive të tyre. Konteksti fizik mund të jetë një universitet, një sallë konference, një shkollë apo klasë; konteksti social një komunitet apo organizatë. Në rastin e aktiviteteve të mësuesit, mësuesi mund të jetë një mësues kopshti, një mësues i arsimit fillor ose të mesëm apo mësues i edukimit profesional në një shkollë lokale. Ata që mësojnë janë nxënës të fillores apo të mesmes në një moshë të caktuar. Organi përgjegjës qeveritar (p.sh. Ministria e Arsimit) siguron kurrikulën dhe përcakton kontekstin tipik ku zhvillohet procesi edukues (p.sh shkolla, viti, madhësia e klasës etj.). Konteksti social i një shkolle përbëhet nga kultura, marrëdhëniet dhe vlerat e shkollës.

Modeli i aktivitetit ndihmon fokusimin tek praktika, tek mënyra se si elementë të ndryshëm janë bërë bashkë për të krijuar praktikën gjithëpërfshirëse. Modeli po ashtu ndihmon për të kuptuar më mirë çfarë duhet për të qenë një praktikien gjithëpërfshirës. Edukimi gjithëpërfshirës kërkon të forcojë procesin e nxënies për të gjithë fëmijët me anë të promovimit të aftësive tek mësuesit, duke siguruar që ata të jenë në gjendje të zbatojnë kurrikulën në kontekste që nxisin nxënien për të gjithë nxënësit. Qëllimi madhor i mësuesve është të bëjnë bashkë nxënësin, kurrikulën dhe kontekstin për të siguruar një edukim cilësor dhe realizuar rezultate pozitive.

### KUADRI PËR PRAKTIKAT GJITHËPËRFSHIRËSE NË SHKOLLA

Edukimi gjithëpërfshirës nuk është gjë tjetër veçse edukim cilësor për të gjithë, rrjedhimisht praktikat gjithëpërfshirëse nuk janë të ndryshme nga praktikat e shkëlqyera. Aktivitetet për edukimin e mësuesve, që kërkojnë të përmirësojnë praktikën e mësuesit duhet të udhëhiqen nga një vizion praktikash gjithëpërfshirëse ekselente në shkolla. Kuadri për praktikat gjithëpërfshirëse është zhvilluar për këtë qëllim: për të siguruar një vizion që mund të udhëheqë zhvillime ose novacione. Ai e përdor modelin e aktivitetit si një strukturë për të mbledhur bashkë në mënyrë domethënëse prova të praktikës së mirë. Të gjithë aktivitetet e mësuesit, në fund, duhet t'i kontribuojnë qëllimeve kryesore të praktikave gjithëpërfshirëse. Qëllimi përfundimtar është të sigurohet që të gjithë nxënësit të jenë të aftë të përfitojnë nga shkolla dhe kurrikula, të jenë të aftë të marrin pjesë dhe të mësojnë e rrjedhimisht të arrijnë kalimin me sukses në shkollën e lartë, të punojnë e të realizojnë, si të rritur, një jetë të përgjegjshme dhe të përmbushur. Për të arritur këtë objektiv, mësuesit duhet ta përdorin kurrikulën si mjet për transformimin e kapacitetit të nxënësit për të mësuar, jo si diçka që duhet mësuar sipas një plani rigoroz. Kontekstet e krijuara nga mësuesit duhet të jenë miqësore me fëmijët, mjedise aftësuese që lehtësojnë nxënien dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve dhe të rinjve. Mësuesit vetë kanë nevojë të bëhen praktikienë gjithëpërfshirës kompetentë, të aftë për të transformuar, nëpërmjet kurrikulës, kapacitetin për të mësuar dhe për të krijuar mjedise sociale dhe fizike që sigurojnë akses, pjesëmarrje, nxënie dhe arritje për të gjithë nxënësit. Modeli i aktivitetit të praktikave gjithëpërfshirëse bën bashkë këto cilësi:




Figura 7: Praktika e shkollave gjithëpërfshirëse

Për të realizuar praktikën gjithëpërfshirëse (perspektiva makro), mësuesit duhet të angazhohen në katër praktika specifike (meso perspektive) të lidhura me katër komponentët (mësuesi, nxënësi, kurrikula, konteksti) e modelit të aktivitetit. Mësuesit nuk merren vetëm me nxënësit. Një pjesë e rëndësishme e praktikës së tyre ka të bëjë me kurrikulën, për shembull, kur bëjnë organizimin në aktivitete javore, kur përpilojnë fletët e punës, apo përgatisin provimet. Mësuesit shpenzojnë gjithashtu një kohë të konsiderueshme për krijimin e një mjedisi të sigurtë dhe aftësues, për shembull, kur përmirësojnë mjedisin mësimor sëbashku me specialistët, bisedojnë me prindërit dhe rimodelojnë, si ekip, zonën e aktiviteteve argëtuese apo ndërtojnë rampa për të përmirësuar aksesin për studentët në karrocë. Së fundi, mësuesit shpenzojnë kohë edhe për zhvillimin e aftësive të tyre, duke lexuar literaturë, duke shkëmbyer eksperiencë me kolegë, apo duke marrë pjesë në workshope dhe seanca supervizimi. Agjencia europiane për Nevoja të Posaçme ka zhvilluar një profil të mësuesit gjithëpërfshirës (2012) duke përdorur këta katër komponentë për përcaktimin e zonave të kompetencës për mësuesit gjithëpërfshirës:

- **Nxënësi:** Vlerësimi i diversitetit të nxënësit (nxënësit si persona që kanë të drejtën e edukimit)
- **Kurrikula:** Mbështetja e të gjithë nxënësve (nxënësit si ata që mësojnë duke patur akses tek kurrikula)
- **Konteksti:** Të punuarit me të tjerë (bashkëpunim dhe punë në ekip për të krijuar mjedise të fuqishme mësimi)
- **Mësuesi:** Zhvillimi profesional personal (mësuesit si nxënës që kanë përgjegjësinë për të mësuar gjatë gjithë jetës)

Këto katër fusha kompetencash janë të lidhura me katër vizione apo qëllime që janë pjesë e modelit për praktikën gjithëpërfshirëse:

- **Nxënësi:** Akses, pjesëmarrje dhe nxënie, arritje
- **Kurrikula:** Transformim i kapacitetit për të mësuar
- **Konteksti:** Mjedisë sociale dhe fizike aftësuese
- **Mësuesi:** Praktikienë gjithëpërfshirës kompetentë

Kuadri për praktikën gjithëpërfshirëse në shkolla u zhvillua bazuar në punën e organizatave ndërkombëtare, të studiueseve dhe eksperiencat e fituara nga projekti "Mbështetje Rajonale për Edukimin Gjithëpërfshirës". Në seksionet vijuese do të përshkruhen më me hollësi të katër praktikave. Për secilën praktikë janë dhënë eksperiencat, të dhëna dhe burime, për t'i siguruar përdoruesit një kuptim më të mirë të asaj çfarë përfaqësojnë këto praktika.

## ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE GJITHËPËRFSHIRËSE PËRMES NDËRTIMIT TË KAPACITETEVE

Edukimi gjithëpërfshirës është një proces; ai është diçka që krijohet përmes praktikash të përditshme që janë të lidhura me mësues, nxënës, kurrikula e kontekste. Edukimi gjithëpërfshirës është gjithmonë një përafrim, jo diçka që arrihet plotësisht ndonjëherë. Në të gjithë botën shumë shkolla janë në procesin e transformimit të tyre në shkolla më gjithëpërfshirëse. Ato gjenden në pika të ndryshme të zhvillimit të tyre; disa mund të kenë arritur më shumë në një apo dy fusha, por që luftojnë në të tjera. Aktivitetet e edukimit të mësuesve, në kontekstin e edukimit gjithëpërfshirës, duhet të synojnë mbështetjen e shkollave në procesin e transformimit të tyre në shkolla më gjithëpërfshirëse. Aktivitetet e edukimit të mësuesve kontribuojnë në ndërtimin e kapaciteteve të domosdoshme për krijimin e sistemeve të edukimit gjithëpërfshirës. Megjithatë nuk mjafton edukimi i mësuesve individualisht: mësuesit duhet të zhvillojnë praktikën e tyre në ekipe, diçka që nuk mund ta mësojnë në izolim. Ndaj, edukatorët e mësuesve duhet të mendojnë për kontekstin në të cilin ata ndërveprojnë me nxënësit e tyre (p.sh studentë mësues, mësues) dhe metodat e përdorura në këtë proces. Nganjëherë ndërtimi i kapaciteteve arrihet më mirë përmes pjesëmarrjes në procesin e zhvillimit të shkollës. Zhvillimi i një programi shkollë mund të ndryshojë perceptimin e mësuesve në lidhje me qëllimin e punës së tyre, duke siguruar një vizion të praktikës gjithëpërfshirëse. Kjo do të ndikojë këndvështrimin mbi punën e tyre dhe të asaj që duan të arrijnë. Ndërtimi i kapaciteteve arrihet edhe nëpërmjet zhvillimit të mjeteve apo strategjive të mësimi. Mësuesit dhe profesionistët e tjerë mësojnë teksa zhvillojnë praktikën e tyre dhe provojnë qasje të reja mësimdhënieje. Ata mund të angazhohen në zhvillimin e mjeteve të reja për bashkëpunim apo për monitorimin e procesit të nxënies dhe, duke bërë këtë gjë, fitojnë njohuri dhe shprehje, por rrisin gjithashtu edhe motivimin dhe angazhimin e tyre. Si rezultat, me zbatimin me efektshmëri të mjeteve apo strategjive të reja rritet edhe kapaciteti në tërësi i shkollave.



Këta shembuj nënvizojnë se trajnimi i mësuesve në mënyrë të izoluar ka kufizimet e veta në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve. Aktivitetet e edukimit të mësuesve në kuptimin më të gjerë duhet të sigurojnë mundësi për zhvillimin e kompetencave (aftësitë e subjektit), por edhe një kuptim më të mirë të asaj çfarë është e rëndësishme tek praktika e mësuesit (objekti, objektiva). Ato duhet të ndihmojnë në zhvillimin e mjeteve dhe strategjive dhe për zhvillimin apo transformimin e mjedisit ku operojnë. Ndërtimi i përgjithshëm i kapaciteteve adreson të gjithë komponentët e praktikës, jo vetëm zhvillimin e aftësive individuale. Bazuar në modelin e praktikave gjithëpërfshirëse, të katër fushat e aftësive (këtu "aftësi" përdoret si termi ombrellë për qëndrimet, vlerat, shprehi & njohuri, kompetenca) nënkuptojnë katër praktika që ju duhen shkollave për t'u bërë shkolla gjithëpërfshirëse. Këto praktika mund të zhvillohen duke adresuar aftësitë e subjektit, objektivat e praktikave të tyre, mjetet dhe strategjitë e përdorura apo mjedisin ku operojnë. Tabela në vijim jep një përmbledhje të vizioneve që duhet të udhëheqin ndërtimin e kapaciteteve për gjithëpërfshirje:

	<i>Prakticienë gjithëpërfshirës kompetentë (mësuesi)</i>	<i>Akses, pjesëmarrje dhe nxënie, arritje (nxënësi)</i>	<i>Transformimi i kapacitetit për të mësuar (kurrikula)</i>	<i>Mjeti fizik dhe social aftësues (konteksti)</i>
<i>Fokusi tek aftësia e subjektit</i>	Zhvillimi profesional personal	Vlerësim i diversitetit të nxënësit	Mbështetje për të gjithë nxënësit	Të punuarit me të tjerë
<i>Fokusi tek objekti dhe objektivat</i>	Komunitete të praktikës	Komunitet nxënës	Kurrikul fleksibël	Marrëdhënie respekti
<i>Fokusi tek mjetet dhe strategjitë</i>	Ndërtim repertori të përbashkët	Personalizim i edukimit	Forcim i procesit të nxënies	Krijimi i rrjeteve dhe parteriteteve
<i>Fokusi tek mjedisi/terreni</i>	Kultura e mësimit profesional	Atmosferë gjithëpërfshirjeje	Mundësi për të mësuar	Qeverisje edukative

*Tabela 4: Kuadri i ndërtimit të kapaciteteve për promovimin e praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla*

Të katër praktikat e përfshira në realizimin e praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla do të përshkruhen me më shumë hollësi në kapitujt vijues. Kuadri i prezantuar është orientim për këdo që përfshihet në procesin e ndërtimit të kapaciteteve për edukimin gjithëpërfshirës. Përdorimi i një kuadri të vetëm lehtëson komunikimin mes organizmave ofruese, por edhe mes mësuesve, shkollave dhe grupeve të tjera të interesit. Kjo mund të jetë e rëndësishme për të qartësuar përgjegjësitë për ndërtimin e kapaciteteve në çdo fushë. Këtu, rajonet apo vendet e ndryshme do kenë organizime të ndryshme. Për shembull, zhvillimi i mjeteve (tekste shkollore, materiale mësimi, teste) mund të jetë në duart e agjencive qeveritare ose përgjegjësi e shkollës. Disa sisteme edukimi kanë rregullore rigoroze në lidhje me kurrikulën dhe provimet nacionale për vlerësimin e performancës së nxënësve. Në sisteme të tilla, zhvillimi i kurrikulave elastike është i vështirë, madje i pamundur, dhe aktivitetet formuese për mësuesit, në lidhje me to, do të kenë pak efekt tek praktikat përkatëse. Është e rëndësishme të mbahet parasysh që mësuesit vërtetë luajnë një rol kritik, por nganjëherë ndërtimi i kapaciteteve duhet bërë në pjesë të tjera të sistemit arsimor, përpara se mësuesit të mund të bëhen prakticienë gjithëpërfshirës.

Të menduarit për praktikën në tërësi, pa u fokusuar vetëm tek karakteristika të izoluar të "praktikës së mirë", ndihmon në zhvillimin e një perspektive sistematike në lidhje me aftësitë e mësuesit dhe praktikën e mësuesit. Nuk është gjithmonë (vetëm) për shkak të mungesës së kompetencave që mësuesit nuk arrijnë të jenë prakticienë gjithëpërfshirës. Shpesh në mjedisin e tyre të punës krijohen barrierat për shkak të përplasjes së qëllimeve që atyre u kërkohet të arrijnë (p.sh. të mësojnë grupe fëmijësh të ndryshëm, duke zbatuar një kurrikul të ngurtë). Ky kuadër ndihmon për nënvizimin e tensioneve apo përplasjeve të tilla në praktikën e mësuesit dhe për të kuptuar si mund të trajtohen ato. Hapi i parë për gjetjen e një zgjidhjeje është të jesh i aftë t'i njohësh këto praktika konfliktuese (mbështetja e nxënësve përkundër ngeljes së tyre në fund të vitit). Në këtë rast, ky problem nuk mund të zgjidhet përmes edukimit të mësuesit, por me ndryshime në legjislacionin, që u krijojnë mundësinë mësuesve të mbështesin procesin e nxënies në nivele të ndryshme pa përjashtim. Kuadri ndihmon për zhvillimin e një perspektive më të gjerë në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve me shpresën që kjo të mund të nxisë lexuesin të mendojë qasje inovatore për promovimin e zhvillimit të edukimit gjithëpërfshirës.

## 2. Praktikrat gjithë përfshirëse në lidhje me profesionalizmin

### PROFESIONISTË GJITHËPËRFSHIRËS KOMPETENTË

#### Pamje e përgjithshme

Profesionistët në shkolla dhe mjedise të tjera edukuese, që duan të bëhen praktikienë gjithëpërfshirës, e kanë aftësinë të angazhohen në një proces zhvillimi profesional personal, por duhet më shumë për përfshirjen e tyre në praktika që synojnë zhvillimin e profesionalizmit të mësuesve. Për t'u bërë, profesionistë gjithëpërfshirës, kompetentë, personeli i një shkolle, apo i gjithë shkollave në një komunitet, ka nevojë të krijojë komunitete të praktikës, ku eksperiencat ndahen dhe përdoren për të mësuar nga njëri-tjetri, ku njerëzit ndjehen mirë dhe bëhen më të motivuar e ku mund të zhvillohet një faktorizim kolektiv për ta çuar shkollën përpara. Për arritjen e kësaj gjëje duhet zhvilluar një repertor i përbashkët për angazhimin e personelit në praktika të përbashkëta. Planet për zhvillimin e shkollës, infrastruktura e përbashkët, gjuha dhe konceptet profesionale të përbashkëta, apo mjetet e përbashkëta të komunikimit janë vetëm disa shembuj. Po ashtu është e nevojshme që pjesëmarrësit të ndërtojnë një kulturë të të mësuarit profesional. Kjo nënkupton krijimin e mjediseve apo konteksteve që lehtësojnë procesin e nxënies tek mësuesit; shkollat gjithëpërfshirëse bëhen kështu organizata ku mësohet. Zhvillimi profesional bëhet pjesë e një procesi të vazhdueshëm adaptimi dhe mjet transformimi.




Figura 8: Praktika për arritjen e profesionistëve gjithëpërfshirës kompetentë

#### Fokusi tek aftësitë: zhvillimi profesional personal

Prakticienët gjithëpërfshirës kuptojnë, pranojnë dhe mirëpresin faktin se për t'u bërë një praktikien gjithëpërfshirës është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës së tyre profesionale. Ata angazhohen në mënyrë aktive jo vetëm në mësimdhënie, por edhe në një proces nxënieje për veten e tyre. Ata përdorin një llojshmëri qasjesh për zhvillimin e tyre profesional, si konsultimet, trajnimet, marrjen e leksioneve, pjesëmarrjen në konferenca e seminare, por edhe orët e hapura, mësimin nga kolegët dhe mentorimin. Transformimi në një praktikien gjithëpërfshirës është një proces pa fund që kërkon reflektim, vlerësim kritik të veprimeve vetjake dhe gatishmëri për të kontribuar në procesin e nxënies tek të tjerët. Kjo përfshin edhe shndërrimin në një faktor nxitës të nxënies individuale dhe kolektive që bën të mundur shtrirjen e qëndrimeve, vlerave, shprehive & njohurive, kompetencave përmes zhvillimit profesional personal. Për hollësi të mëtejshme, referojuni Profilin të Mësuesit Gjithëpërfshirës (Agjencia Europiane 2012).

#### Fokusi tek objekti dhe objektivat: komuniteti i praktikës

Mësuesit duhet të dalin nga izolimi dhe të punojnë me të tjerë; ky është një hap i domosdoshëm drejt shndërrimit të tyre në profesionistë gjithëpërfshirës, vërtetë kompetentë. Ndaj dhe zhvillimi i një praktike të

përbashkët me të tjerë është një objektiv shumë i rëndësishëm këtu. Kjo realizohet më së miri duke punuar aktivisht drejt një vizioni për t'u bërë një komunitet praktike. Në një komunitet praktike, profesionistët mësojnë përmes shkëmbimit të eksperiencave të tyre dhe duke punuar në drejtim të qëllimit të përbashkët për t'u bërë profesionistë gjithëpërfshirës kompetentë. Profesionistët gjithëpërfshirës i kushtojnë vëmendje diversitetit të opinioneve, kompetencave, aspiratave apo të stileve të komunikimit dhe i përdorin ato në mënyrën më të mirë të mundshme për përmirësimin e praktikës. Në një komunitet praktike, çdo profesionist vlerësohet, respektohet dhe dëgjohet me bindjen se kushdo ka mundësinë të kontribuojë për zhvillimin e profesionalizmit të mësuesve.

#### *Fokusi tek mjetet dhe strategjitë: ndërtimi i një repertori të përbashkët*

Për t'u bërë një komunitet praktike, duhet që çdokush në një ekip, shkollë apo komunitet të bashkëpunojë me efektivitet. Për ta arritur këtë dhe për ta forcuar një komunitet praktike duhet ndërtuar një repertori i përbashkët ndërveprimi, komunikimi dhe bashkëpunimi. Një gjuhë e përbashkët, për shembull, është një instrument i fuqishëm për të punuar bashkë dhe për të rritur efektivitetin e bashkëpunimit tuaj. Si një komunitet profesionistësh që punojnë për përmirësimin e vlerave tuaja kolektive, shprehive & njohurive, të kompetencave tuaja, ju duhen mjete, si planet e zhvillimit të shkollës apo procedura, për organizimin me efektivitet të takimeve të zhvillimit profesional. Pjesë e këtij repertori të përbashkët janë edhe qasjet e përbashkëta për zhvillimin e ekipit, për shembull, duke përdorur supervizimin apo metoda të tjera të shkëmbimit profesional. Këtu mund të përfshihen edhe metoda të përbashkëta për planifikim projekti, klasa të hapura apo qasje të tjera të mësimin mes kolegësh.

#### *Fokusi tek konteksti: kultura e mësimin/nxënies profesionale*

Nëse prakticienët duhet të bëhen prakticienë gjithëpërfshirës në një ekip profesionistësh, ata kanë nevojë për një ambient që mbështet përpjekjet e tyre për t'u bërë edhe më profesionistë. Prakticienët profesionistë duhet të jenë të aftë të punojnë në një ambient që gabimet i sheh si mundësi për të mësuar e jo si mungesë profesionalizmi. Mësuesit shikohen edhe si persona që mësojnë në çdo fazë të zhvillimit të tyre profesional. Shkollat gjithëpërfshirëse janë të afta të krijojnë një kulturë të mësimin profesional dhe të angazhohen në procesin e nxënies si një organizatë. Duhet një lidhësi i fortë i aftë për ta udhëhequr këtë proces dhe për të iniciuar ndryshime të nevojshme organizative për të mundur mësimin në ekip dhe individualisht. Prakticienët duhet ta kuptojnë shkollën si një entitet apo si një sistem, i cili do të ndryshojë vetëm përmes ndryshimit në praktikën e tij – në sinkronizim me të tjerë. Shkollat që mësojnë, janë të afta të ndryshojnë dhe të evoluojnë për këtë arsye. Ato mund të ndryshojnë strukturën e tyre të menaxhimit, organizimin e tyre dhe procedurat për të krijuar ambiente që bëjnë të mundur zhvillimin profesional të mësuesve dhe të personelit tjetër.

## ZHVILLIMI I AFTËSIVE PËR T'U BËRË PROFESIONISTË GJITHËPËRFSHIRËS KOMPETENTË

### *Zhvillimi profesionist përgjatë tre fazave*

Tabela në vijim jep një pamje të përgjithshme të asaj që pritet nga prakticienët gjithëpërfshirës në të tre fazat e zhvillimit profesional:

<b>Prakticienë gjithëpërfshirës kompetentë</b>	Edukimi fillestar i mësuesit	Zhvillimi profesional i vazhdueshëm	Edukim për mentorë, liderë dhe agjentë të ndryshimit
Zhvillimi i profesionalizmit vetjak	Të jesh i aftë për të fituar identitetin e mësuesit gjithëpërfshirës	Të jesh i aftë për të reflektuar dhe zhvilluar praktikën	Të jesh i aftë për të krijuar dhe transformuar praktikën
Komuniteti i praktikës	Të jesh i aftë të marrësh pjesë në një komunitet praktike	Të jesh i aftë të zhvillosh komunitetin e praktikës	Të jesh i aftë të transformosh komunitetin e praktikës
Ndërtimi i repertorit të përbashkët	Të jesh i aftë të përdorësh repertorin e përbashkët ekzistues	Të jesh i aftë të zhvillosh repertorin e përbashkët	Të qenurit i aftë të transformosh repertorin e përbashkët
Kultura e mësimin profesional	Të jesh i aftë të kontribosh për kulturën e mësimin profesional	Të jesh i aftë të zhvillosh kulturën e mësimin profesional	Të jesh i aftë të transformosh një kulturë të mësimin profesional

Tabela 5: Nivelet e aftësisë gjatë zhvillimit profesional: profesionalizmi

*Shembuj dhe ide praktike nga mësues pjesëmarrës në projektin "Mbështetje Rajonale për Edukimin Gjithëpërfshirës" të nxjerra nga seancat brainstorming*

- Mirëqenie personale, ia del me stresin;
- Mësuesit si agjentë të procesit të tyre vetjak të të mësuarit;
- Mësuesit si praktikienë efektive, përfshirë qëndrimin pozitiv ndaj vetes, vetë-efektiviteti;
- Ndërgjegjësim rrethor (situational) më shumë se sa njohje e cunguar;
- Kombinim i punës praktike me punën teorike;
- Mësuesit si praktikienë reflektues, përfshirë ndërgjegjësimin rrethor, shprehitë meta-cognitive, vetë-vlerësimin kritik;
- Gatishmëria e mësuesit për të mësuar nga të tjerët dhe për t'u angazhuar në procesin e të mësuarit nga kolegët;
- Peer-mentoring;
- Shkëmbim eksperience mes kolegësh (p.sh. vizita studimore, orë të hapura, aktivitete të përbashkëta, peer learning);
- Orë të përziera për të qenë pjesë e mësimdhënies në ekip dhe për të mësuar nga njëri-tjetri;
- Fillimi me "mikro-ekipe" mësuesish të motivuar, më pas duke ndarë eksperiencën me të tjerët për ndryshim gradual të qëndrimit të tyre mbi bashkëpunimin;
- Përdorim i planit të zhvillimit të shkollës për të zhvilluar një vizion të përbashkët të edukimit gjithëpërfshirës në shkollë;
- Zbatimi i procedurës së vetë-vlerësimit si një bazë për zhvillimin e politikave të shkollës;
- Kapërcimi i vështirësive për vendosjen e procedurave, në bazë shkolle, për planifikim individual të edukimit;
- Krijimi i një baze të dhënash për praktikën e mirë dhe ndarja e saj me kolegë;

*Shembuj të praktikës së mirë përtej projektit*

- "Sa e mirë është shkolla jonë?" paraqet një numër indikatorësh për vetë-vlerësimin e shkollës, organizuar brenda një kuadri cilësie. Aftësia për të vlerësuar praktikën vetjake është një hap i parë i rëndësishëm drejt profesionalizmit. Informacion i mëtejshëm tek: [http://www.educationscotland.gov.uk/resources/h/genericresource\\_tcm4684382.asp](http://www.educationscotland.gov.uk/resources/h/genericresource_tcm4684382.asp);
- International Teacher Leadership Project. Shikoni informacionin tek: <http://www.teacherleadership.org.uk/the-itl-initiative.html>.

*Referenca dhe informacion shtesë*

- Schools that learn (Senge 2012);
- Becoming a Reflective Practitioner (Schön 1983);
- Teachers leading change. Doing Research for school improvement (Durrant & Holden 2006);
- Creating communities of practice (Lave and Wenger 1991).

### 3. Praktika gjithëpërfshirëse në lidhje me nxënësin

#### **AKSES, PJESËMARRJE DHE NXËNIE, ARRITJE**

*Pamje e përgjithshme*

Profesionistët në shkolla dhe ambiente të tjera edukuese, që duan të promovojnë aksesin, pjesëmarrjen, nxënien dhe arritjen për të gjithë nxënësit e tyre, duhet të jenë të aftë të vlerësojnë diversitetin e nxënësve. Por duhet bërë më shumë për t'u përfshirë në praktika që realizojnë të drejtën e çdo fëmije dhe çdo të riu për edukim. Për ta arritur këtë gjë, të gjithë fëmijët dhe të rinjtë duhet të jenë pjesë e një komuniteti ku mësohet - në klasë, në shkollë dhe në komunitet. Vlerësimi në praktikë i diversitetit të nxënësve do të thotë edhe siguri i një atmosfere gjithëpërfshirëse mes nxënësve, familjeve dhe shokëve të tyre. Nxënësit duhet të vlerësojnë njeri-tjetrin, të respektojnë njeri-tjetrin, ta ndihmojnë njeri-tjetrin e të mësojnë nga njeri-tjetri. Shkollat gjithëpërfshirëse janë shkolla ku çdokush është i mirëpritur jo vetëm nga mësuesit, por nga kushdo. Për realizimin e kësaj gjëje mësuesit dhe profesionistët e tjerë duhet të përdorin mjete, metoda dhe strategji që ndihmojnë për të kuptuar, respektuar dhe mbështetur çdo fëmijë si person dhe si individ me të drejta.

Kjo ka të bëjë me personalizimin e edukimit për të garantuar që diversiteti i nxënësve nuk çon në shkelje të të drejtës së tyre për edukim (aksesi), të drejtat e tyre në procesin e edukimit (mësim dhe pjesëmarrje) dhe siguron që, me anë të edukimit të tyre, ata fitojnë të drejtat e tyre në shoqëri (arritja). Personalizim i edukimit do të thotë që talentet, ambiciet dhe interesat e nxënësve mbahen mirë parasysh dhe përdoren si mjete për krijimin e një komuniteti ku mësohet.




Figura 9: Praktika për të realizuar akses, pjesëmarrje & nxënie, dhe arritje

*Fokusi tek aftësitë: vlerësimi i diversitetit të nxënësve*

Mësuesit gjithëpërfshirëse vlerësojnë, pranojnë dhe respektojnë njëllor të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në lidhje me të drejtën e tyre për edukim. Ata inkurajojnë në mënyrë aktive të gjithë fëmijët dhe të rinjtë për të shprehur veten dhe për t'u bërë kontribues aktivë në komunitetin e nxënies. Diferencat në gjini, gjuhë, origjinë, sfond socio-ekonomik, karakteristika fizike e mendore, aftësi, respektohen dhe, më shumë se barriera, shihen si burime për t'u përdorur. Vlerësimi i diversitetit të nxënësit nënkupton edhe vlerësim të familjeve të tyre si kontribues të rëndësishëm në procesin e nxënies dhe zhvillimit dhe kjo do të thotë vlerësim i diversitetit në ekipin e shkollës dhe në komunitet. Mësuesit gjithëpërfshirës sjellin me vete qëndrime, vlera, shprehi & njohuri, kompetenca, si dhe autoritetin për të siguruar akses, pjesëmarrje & mësim dhe arritje për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Për hollësi, ju lutemi referojuni Profilit të Mësuesit Gjithëpërfshirës (Agjencia Europiane 2012).

*Fokusi tek objekti dhe objektivat: komuniteti i nxënies*

Për t'i përdorur këto aftësi në një situatë të caktuar, mësuesi gjithëpërfshirës duhet të jetë i aftë të krijojë një vizion të aksesit, pjesëmarrjes e mësim, arritjes, për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, dhe të vendosë qëllime dhe objektiva për realizimin e tyre. Objektivat adresojnë diversitetin e studentëve në klasë me synim bashkimin e tyre në një komunitet nxënësish. Në një komunitet çdo nxënës mirëpritet, respektohet dhe i jepet mbështetja e nevojshme për të qenë i aftë të marrë pjesë, të mësojë dhe të arrijë suksesin. Diferencat shihen si pika të forta, duke krijuar hapësirë për një diversitet perspektivash e talentesh, që ndihmojnë në tërësi procesin e nxënies tek të gjithë grupi. Vëmendja e mësuesit nuk shkon tek nxënësit në mënyrë individuale, por tek të gjithë komuniteti i krijuar prej nxënësve të tij. Në një komunitet nxëniesje, të gjithë nxënësit gjejnë vendin e tyre dhe, po të ishin të njëjtë, do të kishim një komunitet të pakuptimtë – pasi të tillë, fëmijët apo të rinjtë nuk do të kishin si të ndihmonin njëri-tjetrin në procesin e nxënies.

*Fokusi tek mjetet dhe strategjitë: personalizimi i edukimit*

Një mjet i rëndësishëm për krijimin e komunitetit të nxënësve është personalizimi i edukimit. Në thelb, kjo do të thotë se nxënësit nuk perceptohen thjesht në rolin e atij që mëson, por si persona me biografi të vetjake, eksperiencat, aftësitë dhe aspiratat e tyre. Ai bazohet tek premisa se mësimi i vërtetë ndodh vetëm kur ai ka

kuptim për personin dhe rezonon me identitetin dhe interesat e tij. Personalizimi i edukimit është strategjia kryesore për të realizuar që fëmijët dhe të rinjtë të jenë të aftë të kontribuojnë në komunitetin e nxënësve ku bëjnë pjesë. Kjo përfshin përdorimin e qasjeve si mentorimi dhe trajnimi për të mbështetur procesin e nxënies, por edhe mbështetjen e autonomisë për promovimin e kapacitetit veprues të nxënësit. Po ashtu jepet mbështetje për të përmirësuar vetë-rregullimin, vullnetin dhe motivimin e nxënësve në mënyra të tilla që respektojnë identitetin e tyre. Përfshin dhënien e zgjedhjeve, por edhe supervizimin e vazhdueshëm për të parë se si nxënësit avancojnë në edukimin e tyre.

*Fokusi tek konteksti: atmosfera e gjithëpërfshirjes*

Realizimi i komunitetit të nxënësve kërkon një ambient mësimi ku çdokush ndjehet i vlerësuar dhe i pranuar. Duhet krijuar një atmosferë gjithëpërfshirjeje ku gabimet shihen si shanse për të mësuar dhe arritjet festohen si sukses i individit dhe i grupit. Shkolla duhet të bëhet një vend besimi dhe respekti ku nxënësit bashkëpunojnë aktivisht për promovimin e nxënies dhe pjesëmarrjes. Mësimi i vërtete nuk është i mundur pa marrëveshje reciproke, pa ndërveprim dhe komunikim social. Për të promovuar angazhimin e dyanshëm, mësuesit gjithëpërfshirës duhet të investojnë në ndërtimin e besimit dhe respektit mes nxënësve dhe t'i angazhojnë ata në vendim-marrjen që ndikon pjesëmarrjen dhe nxënien. Kjo ka të bëjë me krijimin e një klime pozitive dhe pranuese, duke i mbështetur nxënësit në zgjidhjen e konflikteve dhe tensioneve mes tyre. Por gjithashtu duhet edhe të sigurojë se të gjithë aspektet e mjedisit janë të tilla që ndihmojnë aksesin, nxënien dhe pjesëmarrjen, përfshirë zhdukjen e barrierave fizike dhe sociale.

**ZHVILLIMI I AFTËSIVE PËR TË VLERËSUAR DIVERSITETIN E STUDENTIT**

*Zhvillimi profesional gjatë tre fazave*

Tabela në vazhdim jep një pamje të përgjithshme të asaj që mund të pritet nga prakticienët gjithëpërfshirës në të tre fazat e zhvillimit profesional:

<b>Nxënësi</b>	Edukimi fillestar i mësuesit	Zhvillimi profesional i vazhdueshëm	Edukimi për mentorë, drejtues dhe agjentë të ndryshimit
Vlerësimi i diversitetit të studentit	Te jesh i aftë të vlerësosh diversitetin e nxënësit	Te jesh i aftë të zhvillosh praktika në bazë shkolle për vlerësimin e gjithë nxënësve	Te jesh i aftë të transformosh praktikatat për vlerësimin e gjithë nxënësve
Komuniteti i nxënësve	Te jesh i aftë të krijosh një komunitet të praktikës në klasë	Te jesh i aftë të zhvillosh një komunitet nxënësish në shkollë	Te jesh i aftë të transformosh komunitetet e nxënësve
Personalizimi i edukimit	Te jesh i aftë të personalizosh edukimin në mënyrë të mjaftueshme	Te jesh i aftë të zhvillosh praktika në bazë shkolle për personalizimin e edukimit	Te jesh i aftë të transformosh praktikatat për personalizimin e edukimit
Atmosfera e gjithëpërfshirjes	Te jesh i aftë të kontribosh për një atmosferë gjithëpërfshirjeje në klasë	Te jesh i aftë të zhvillosh një atmosferë gjithëpërfshirjeje në shkollë	Te jesh i aftë të transformosh një atmosferë të gjithëpërfshirjes në shkollë dhe komunitet

*Tabela 6: Nivelet e aftësisë gjatë zhvillimit profesional: nxënësi*

*Shembuj dhe ide praktike nga mësues pjesëmarrës në projektin “Mbështetje Rajonale për Edukimin Gjithëpërfshirës” të nxjerra nga seancat brainstorming*

- Reflektim mbi identitetin social vetjak, paragjykimin dhe stereotipet;
- Pranimi i të gjithë nxënësve si dikush që do të mësojë
- Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me paragjykimin dhe problemi i etiketimit të fëmijëve;
- Diskutimi në lidhje me pikëpamjet e mësuesve mbi diferencat e nxënësve;
- Mësuesit duhet të jenë empakikë dhe të vëmendshëm ndaj çdo fëmije;



- Rritja e ndërgjegjësimit të nxënësve, prindërve dhe zyrtarëve të sistemit arsimor në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës (aktivitete pa kosto për ndërgjegjësim);
- Filozofia për fëmijë që zhvillojnë mënyrën e tyre të menduarit për të tjerët;
- Klasa të përziera për të rritur vetëdijen dhe rritur mirëkuptimin mes nxënësve që vinë nga grupe të ndryshme etnike;
- Qasje të reja për menaxhimin e klasave të mëdha, për të siguruar që çdo fëmijë të perceptohet si unik, dhe organizim me efektivitet i punës në grup, nevojë për një mënyrë menaxhimi të klasës, që respekton diversitetin;
- Krijimi i një komuniteti që eksploron mjete për promovimin e përkatësisë, identitetit dhe autonomisë;
- Zhvillimi i koncepteve të Edukimit Gjithëpërfshirës në shkollë dhe komunitet;
- Angazhim në projekte në bazë shkolle për ndërgjegjësim ;
- Pasurimi i njohurive mbi kulturat dhe gjuhët e tjera në bashkëpunim me familjet dhe fëmijët që vinë nga këto formime kulturore;
- Angazhim në aktivitete të përbashkëta si aktivitete sportive, prodhim i një gazete, ekspozita;
- Seminare e aktivitete të përbashkëta për mësues, prindër e studentë për të sqaruar termat “edukim gjithëpërfshirës” dhe “diversitet”;
- Programe multikulturore në shkollë me fokus tek celebrimi i diferencave dhe ngjashmërive;
- Prezantimi i temës së drejtësisë sociale dhe promovimi i të drejtave të njeriut;
- Trajtimi i çështjeve që kanë të bëjnë me konfidencialitetin dhe etikën, etj, lidhur me zbulimin e informacionit mbi nevojat e posaçme apo aftësitë e kufizuara.

#### *Shembuj të praktikës së mirë përtej projektit*

- “Mësim pa limite”, një projekt i Universitetit të Kembrixhit kushtuar zhvillimit të qasjeve të mësimdhënies dhe procesit të nxënies, që nuk mbështeten tek idetë deterministe për aftësinë. Projekti mbështetet në një punë kërkimore prej disa dekadash, që ka tërhequr vëmendjen ndaj mënyrave shumë komplekse, në të cilat idetë e aftësisë së fiksuara, dhe praktikave të bazuara tek to, mund të kufizojnë nxënien. Gjeni më shumë informacion në: <http://learningwithoutlimits.educ.cam.ac.uk/>;
- Indeksi për gjithëpërfshirjen është një komplet materialesh për udhëheqjen e shkollave në procesin e zhvillimit gjithëpërfshirës. Ka të bëjë me mbështetjen e komuniteteve mbështetëse dhe nxitjen e arritjes së nivelit të lartë për të gjithë stafin dhe nxënësit. Më shumë informacion gjeni në : <http://www.csie.org.uk/resources/inclusion-index-explained.shtml>.

#### *Referenca dhe informacion shtesë*

- Learning Without Limits (Hart et al. 2004);
- Creating Learning without Limits (Swann et al. 2012);
- Index for Inclusion (Booth & Ainscow 2002);
- Educating Culturally Responsive Teachers (Villegas and Lucas, 2002).

## 4. Praktikave gjithëpërfshirëse në lidhje me kurrikulën

### **TRANSFORMIMI I KAPACITETIT NXËNËS**

#### *Pamje e përgjithshme*

Profesionistët në shkollë dhe mjedise të tjera edukimi, që kërkojnë të bëhen më gjithëpërfshirës, kanë aftësinë për të mbështetur të gjithë nxënësit, por duhet të bëhen edhe më shumë pjesë e praktikave që synojnë transformimin e kapacitetit për të mësuar tek të gjithë nxënësit. Mbështetja për të gjithë nxënësit duhet të udhëhiqet nga një vizion sipas të cilit çdo fëmijë apo i ri është i aftë të mësojë, të zhvillojë talente e aftësi për jetën si i rritur, ka të bëjë me transformimin e vetë procesit të nxënies për të qenë i përgatitur për një të ardhme ku aftësia për të mësuar dhe për t’iu përshtatur kushteve në ndryshim do të jetë mëse e rëndësishme. Për të siguruar që të gjithë fëmijët apo të rinjtë janë të aftë të mësojnë në nivelin më të lartë të mundshëm, objektivi këtu është krijimi i një kurrikule gjithëpërfshirëse dhe elastike. Kur miratohet një kurrikulë duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe eksperiencat e mëparshme të gjithë fëmijëve dhe të rinjve. Kurrikula duhet t’i përshtatet interesave të nxënësit me qëllim që të sigurojë angazhimin e tyre. Për ta arritur këtë mësuesit dhe profesionistët e tjerë duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë strategji që synojnë forcimin



e eksperiencës nxënëse. Duhet të jenë të aftë të lehtësojnë të mësuarin përmes zhvillimit të materialeve mësimore dhe përdorimit të strategjive të vlerësimit, që i përshtaten situatës së çdo nxënësi. Duhet plane mësimi që reflektojnë rrugën e nxënësve përgjatë kurrikulës. Vënia në praktikë e një kurrikule elastike dhe gjithëpërfshirëse kërkon, po ashtu, edhe aftësinë për të krijuar oportunitete të vërteta mësimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Kjo përfshin krijimin e mjediseve pozitive për të mësuar në klasë e më tej. Ajo nënkupton po ashtu përdorimin më të mirë të mundshëm të të gjitha burimeve në dispozicion, përfshirë kontributin e prindërve dhe të komunitetit.




Figura 10: Praktika për realizimin e Strategjive Gjithëpërfshirëse dhe Mjetet për të Mësuar

*Fokusi tek aftësitë: mbështetja për të gjithë nxënësit*

Mësuesit gjithëpërfshirës janë të aftë të mbështesin të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në procesin e tyre të nxënies. Të gjithë fëmijët pranohen si fëmijë me talente, shpresa e ambicie që mund të adresohen nga kurrikula me qëllim që të mbështet procesi i tyre i nxënies dhe pjesëmarrja e tyre. Praktikienët gjithëpërfshirës përqendrohen tek zhvillimi dhe transformimi i kapacitetit nxënës të fëmijëve dhe ndihmojnë që ata të zgjerojnë eksperiencat e tyre jetësore. Ata kanë aftësitë e nevojshme për të qenë të vetëdijshëm, për të vlerësuar dhe mbajtur parasysh, gjatë planifikimit të mësimdhënies, nevojat e ndryshme të nxënies dhe për t’iu përgjigjur atyre në klasë në mënyrë të përshtatshme. Mundësitë për të mësuar në klasë dhe jashtë saj përdoren me efektivitet ose krijohen atje ku duhen. Mësuesit gjithëpërfshirës sjellin me vete qëndrime, shprehi & njohuri, kompetenca dhe autoritetin për vënien në veprim të qasjeve mësimore mbështetëse për të gjithë nxënësit. Për më shumë hollësi referojuni Profilit të Mësuesit Gjithëpërfshirës (Agjencia Europiane 2012).

*Fokusi tek objekti dhe objektivat: Kurrikul gjithëpërfshirëse dhe elastike*

Mësuesit gjithëpërfshirës duhet të mësojnë ta shohin kurrikulën si diçka që ofron mundësi për të mësuar e jo si diçka që dikton atë që duhet bërë. Kurrikula është mjeti me anë të cilit transformohet kapaciteti nxënës i fëmijëve dhe i të rinjve. Për të mbështetur të gjithë nxënësit në mënyra të tilla që transformojnë kapacitetin e tyre për të mësuar, mësuesit duhet të bëjnë një detajim të kurrikulës me qëllim që t’i përshtaten nevojave, interesave dhe talenteve të çdo nxënësi. Këtu nxënësit luajnë një rol aktiv dhe marrin, sa më shumë të jetë e mundur, përgjegjësinë për procesin e tyre të nxënies. Praktikienët gjithëpërfshirës janë të aftë ta përdorin kurrikulën si një lehtësues të procesit të nxënies, duke krijuar detyra ose projekte interesante dhe sfiduese, ku nxënësit mund të zhvillojnë aftësi të ndryshme ndërsa punojnë sëbashku për një qëllim të përbashkët. Qëllimet apo pritshmëritë për arritje janë në harmoni me kurrikulën. Nxënësve u bëhen të ditura këto qëllime dhe kur i arrijnë ato. Kjo ndihmon për ta bërë të dukshëm procesin e nxënies.

*Fokusi tek mjetet dhe strategjitë: forcimi i procesit të nxënies*

Për të vënë në veprim një kurrikul elastike dhe gjithëpërfshirëse, është e nevojshme që mësuesit dhe profesionistët e tjerë në shkolla të përdorin mjete dhe strategji efektive për forcimin e nxënies. Kjo mund

të arrihet duke pasur parasysh stile të ndryshme nxënieje dhe zhvillimin e detyrave që përdorin modalitete të ndryshme shqisore për të mësuar. Mësuesit duhet të kuptojnë shumë mirë subjektin e tyre, por më e rëndësishme është që të parashikojnë sfidat njohëse dhe të përdorin strategji për kapërcimin e tyre. Ata duhet të jenë të aftë të diferencojnë mësimdhënien për t'iu përgjigjur nevojave të nxënies për çdo nxënës dhe për këtë u duhet të kuptojnë mirë procesin e nxënies apo proceset për zgjidhjen e problemeve dhe si mund t'i mbështesin ato, p.sh me anë të marrjes së feedback-ut. Dokumentimi i nxënies në ditare ose përdorimi i strategjive të tjera për ta bërë nxënien të dukshme për nxënësin, është e rëndësishme për të ndihmuar nxënësit në transformimin e qasjeve të tyre të mësimin, duke forcuar kështu procesin e nxënies. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit luan një rol të rëndësishëm për forcimin e nxënies në klasën gjithëpërfshirëse.

#### *Fokusi tek konteksti: mundësi për të mësuar*

Realizimi i një kurrikule gjithëpërfshirëse dhe elastike kërkon një mjedis mësimi që siguron mundësi mësimi për të gjithë fëmijët e të rinjtë. Mjediset e mësimin të krijuara duhet t'i përshtaten aktiviteteve mësimore ku përfshihen nxënësit. Një grup i fiksuar nxënësish mund të jetë barrierë, pasi për aktivitete të caktuara fëmijët kanë nevojë të punojnë në grupe të vogla ose vetëm, ndërsa aktivitete të tjera mund të realizohen me grupe më të mëdha. Grupimi elastik dhe përdorimi sipas një qëllimi i hapësirave dhe ambienteve të ndryshme të disponueshme në shkollë apo në komunitet mund të krijojë mundësira më të mira për të mësuar. Mundësitë për të mësuar mund të krijohen vetëm nëse hapësirat e mësimin dhe kurrikula janë të aksesueshme dhe relevante për të gjithë nxënësit. Mësuesit duhet të jenë të aftë të parashikojnë mundësitë, t'i kapin ato dhe t'i modelojnë në mënyrën më të mirë të mundshme. Krijimi i mundësive për të mësuar kërkon burime shkollore, por më mirë akoma, përdorimin më të mirë të burimeve të disponueshme brenda shkollës dhe jashtë saj. Praktikienët gjithëpërfshirës duhet të zhvillojnë në shkollat e tyre më shumë kulturën e nxënies se sa atë të performancës. Disa fëmijë mund të kenë nevojë për ndihmën e shërbimeve të tjera ose për mbështetjen e profesionistëve të tjerë për të siguruar përdorimin prej tyre, në mënyrën më të mirë, të mundësive për nxënie.

## ZHVILLIMI I AFTËSIVE PËR TË MBËSHTETUR TË GJITHË NXËNËSIT

### *Zhvillimi profesional gjatë tre fazave*

Tabela në vazhdim jep një pamje të përgjithshme të asaj që mund të pritet nga praktikienët gjithëpërfshirës në të tre fazat e zhvillimit profesional:

<b>Kurrikula</b>	Edukimi fillestar i mësuesve	Zhvillimi profesional i vazhduar	Edukimi për mentorë, drejtues dhe agentë të ndryshimit
Mbështetja për të gjithë nxënësit	Të jesh i aftë të mbështesësh të gjithë nxënësit	Të jesh i aftë të zhvillosh praktika në bazë shkolle për të mbështetur të gjithë nxënësit	Të jesh i aftë të transformosh praktikat për të mbështetur të gjithë nxënësit
Kurrikul gjithëpërfshirëse & elastike	Të jesh i aftë të zbatosh kurrikulën në fuqi	Të jesh i aftë të ndërtosh kurrikulën në bazë shkolle	Të jesh i aftë të krijosh ose transformosh kurrikulën
Forcimi i nxënies	Të jesh i aftë të përdorësh strategji për forcimin e nxënies në klasë	Të jesh i aftë të zhvillosh praktika instruktuese në shkolla	Të jesh i aftë të krijosh apo transformosh praktikat instruktuese në shkolla
Mundësi për të mësuar	Të jesh i aftë të ndërtosh situata në të cilat të gjithë nxënësit mund të mësojnë	Të jesh i aftë të zhvillosh mundësi të reja për të mësuar në shkolla	Të jesh i aftë të krijosh apo transformosh mundësitë për të mësuar në komunitet

*Tabela 7: Nivelet e aftësisë gjatë zhvillimit profesional: kurrikula*

*Shembuj dhe ide praktike nga mësues pjesëmarrës në projektin "Mbështetje Rajonale për Edukimin Gjithëpërfshirës" të nxjerra nga seancat brainstorming*

- Mësuesi nxit secilin fëmijë për arritje;
- Vendosja e pritshmërive të larta në lidhje me arritjet dhe të mësuarit e nxënësve;
- Mësuesi ka njohuri të mira mbi metodologjinë e mësimdhënies;
- Njohuri për nevojat e nxënies në rastin e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Metoda e orës së hapur: mësim i simuluar;
- Trajnim për hartimin e planit individual;
- Përdorimi i kurrikulës për promovimin e nxënies akademike, sociale dhe emocionale;
- Nevoja për sqarimin e mënyrës si zhvillohen planet edukuese individuale;
- Vështirësia praktike në zhvillimin e qëllimeve të nxënies dhe lidhje e tyre me kurrikulën, nevoja për udhëheqje praktike për metodat e nxënies, vlerësimin dhe instrumentet e komunikimit në lidhje me nxënien dhe mbështetja për nxënësin, prindin dhe mësuesit e tjerë;
- Programe që synojnë një kuptim rrethor të nxënies;
- Nevoja për metoda mësimdhënëse novatore;
- Qasje mësimdhënëse efektive në klasa heterogjene;
- Klasa të përziera për të krijuar oportunitete të reja mësimi për nxënësit nga grupe të tjera etnike;
- Aktivitete të përbashkëta me nxënës dhe prindërit e tyre;
- Bllok shënimesh lëvizës për organizimin më mirë të detyrave të shtëpisë (krijim mundësish për të mësuar);
- Implementim i aktiviteteve "jashtë klase" dhe workshopeve për shprehi të veçanta (kërcim, gjuha e shenjave);
- Ekipet lëvizëse për të mbështetur nevojat e posaçme të fëmijëve për edukim.

*Shembuj të praktikës së mirë përtej projektit*

- Organisation of Provision to Support Inclusive Education (Agjensia Europiane). Për informacion vizitoni: <https://www.european-agency.org/agency-projects/organisation-of-provision>;
- Raising Achievement for all Learners (Agjensia Europiane ). Për informacion vizitoni: <https://www.european-agency.org/agency-projects/raising-achievement>;
- Curriculum for Excellence (Skoci). Për informacion vizitoni: <http://www.educationscotland.gov.uk/learningandteaching/thecurriculum/index.asp>;
- ICT for Inclusion – Developments and Opportunities in European Countries (Agjensia Europiane). Për informacion vizitoni: <https://www.european-agency.org/publications/ereports/ict-for-inclusion-developments-and-opportunities-for-european-countries>;
- ICT for Information Accessibility in Learning. (Agjensia Europiane). Për informacion vizitoni: <https://www.european-agency.org/agency-projects/ict4ial>.

*Referenca dhe informacion shtesë*

- Visible Learning (Hattie 2009);
- Making learning visible to promote engagement, understanding and independence for all learners (Ritchhart et al. 2011);
- The skilful Teacher (Saphier et al. 2008).

## 5. Praktika gjithëpërfshirëse në lidhje me kontekstin

### **KRIJIMI I MJEDISEVE SOCIALE DHE FIZIKE AFTËSUESE**

*Pamje e përgjithshme*

Profesionistët në shkolla dhe mjedise të tjera edukimi, që kërkojnë të bëhen më gjithëpërfshirës, kanë aftësinë për të mbështetur të gjithë nxënësit, por duhet të bëhen edhe më shumë pjesë e praktikave që synojnë krijimin e mjediseve sociale dhe fizike aftësuese. Mësuesit dhe profesionistët e tjerë duhet të krijojnë marrëdhënie të besueshme dhe gjithëpërfshirëse që ndihmojnë për kapërcimin e konflikteve, izolimit dhe fragmentimit që kërcënojnë gjithëpërfshirjen. Marrëdhëniet bazohen tek besimi dhe respekti

dhe me to krijohet një klimë pozitive që ndihmon në kapërcimin e vështirësive që krijohen nga të jetuarit dhe të punuarit bashkë. Të punuarit me të tjerë është një mënyrë e fuqishme për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse duke bërë bashkë aftësitë, pikat e forta, përpjekjet e veprimtaritë e gjithsecilit. Pikërisht përmes marrëdhënieve me të tjerët fëmijët dhe të rinjtë kontaktojnë botë të tjera dhe fitojnë stabilitet në kohë krizash. Me qëllim që të arrihet krijimi i mjediseve sociale e fizike aftësuese, objektivi është vendosja e marrëdhënieve të besueshme për ta bërë klasën, shkollën, komunitetin, një mjedis më të aksesueshëm e më gjithëpërfshirës për të gjithë. Kjo përfshin praktika bashkëpunuese për përmirësimin e aksesit tek burimet e disponueshme, si tekstet apo materialet mësimore dhe përdorimi i burimeve të reja, si teknologjia, për lehtësimin e nxënies dhe pjesëmarrjes. Ekspertiza dhe mbështetja e nevojshme iu ofrohet praktikienëve gjithëpërfshirës pikërisht përmes rrjeteve dhe partneriteteve me profesionistë dhe organizata përtej shkollës së tyre. Në rast se marrëdhëniet mes grupeve të ndryshme të interesuara bazohen tek bashkëpunimi e jo tek marrja e dhënias e direktivave dhe urdhrave, qeverisja e sistemit arsimor ose mënyra si drejtohen shkollat duhet bazuar te vendim-marrja demokratike. Qeverisja e tyre i duhet deleguar autoriteteve lokale dhe vetë shkollave që ato të gjejnë mënyrën më të mirë për të avancuar. Qasja nga lart poshtë në qeverisjen e shkollave nuk është e pajtueshme me domosdoshmërinë e shkollave gjithëpërfshirëse për modelimin e mjedisit të tyre social e fizik në mënyrë të tillë që t'i përshtatet nevojave të nxënësve dhe komunitetit të tyre.




Figura 11: Praktika për realizimin e Mjedisit Social e Fizik Aftësues

#### *Fokusi tek aftësitë: të punuarit me të tjerët*

Prakticienët gjithëpërfshirës dalin nga izolimi i klasës së tyre dhe punojnë me të tjerë për të krijuar një mjedis që ndihmon procesin e nxënies dhe pjesëmarrjen. Për ta arritur këtë mësuesit kërkojnë bashkëpunim me të gjithë partnerët e tjerë relevantë, përfshirë prindërit dhe familjet. Ata janë të vetëdijshëm për vlerën e shtuar që ka puna me të tjerët e nuk e shohin atë si barrë për kohën dhe energjitë e tyre. Ata janë të hapur ndaj opinionëve të të tjerëve dhe të aftë për të ndërvepruar për gjetjen e zgjidhjeve që u përshtaten të gjithëve. Ata kanë shprehitë për zgjidhjen e problemeve me bashkëpunim dhe për menaxhimin e situatave kritike me metoda pjesëmarrëse e jo duke u imponuar. Mësuesit gjithëpërfshirës janë të aftë të ndërtojnë partneritete dhe rrjete për të ndihmuar koordinimin, bashkëpunimin dhe komunikimin. Prakticienët gjithëpërfshirës janë të vetëdijshëm për rëndësinë e qeverisjes së mirë arsimore dhe reflektimin mbi marrëdhëniet transparente mes shkollës dhe organeve qeverisëse. Autoritetet lokale dhe zyrtarë të tjerë të sistemit arsimor, në partneritet me shkollën, ndihmojnë në krijimin e kushteve që bëjnë të mundur edukimin gjithëpërfshirës. Mësuesit gjithëpërfshirës sjellin me vete qëndrime, vlera, shprehi & njohuri, kompetenca dhe agjencinë për të krijuar bashkë me të tjerë një mjedis social e fizik aftësues. Për më shumë hollësi referojuni Profilin të Mësuesit Gjithëpërfshirës (Agjencia Europiane 2012).

*Fokusi tek objektivat: marrëdhënie të respektueshme*

Mjediset fizike dhe sociale marrin formë nga ndërveprimet që ndodhin në një kontekst të caktuar. Çfarë është bërë sëbashku, si është bërë dhe me çfarë synimi, janë ato që përcaktojnë marrëdhëniet në një klasë, shkollë apo komunitet. Duke u fokusuar tek krijimi i marrëdhënieve të respektueshme, mësuesit dhe shkollat krijojnë mjedise ku çdokush mund të marrë pjesë dhe të mësojë, ku konfliktet nuk përkeqësohen me lehtësi, pasi ekziston besimi, një perceptim i përbashkët i mënyrës si ndërveprohet me njëri-tjetrin dhe një vizion i përbashkët i asaj që mund të arrihet. Shkollat gjithëpërfshirëse jo vetëm presin që mësuesit të punojnë sëbashku, por edhe promovojnë në mënyrë aktive ndërtimin e marrëdhënieve. Mjediset aftësuese ndërtohen përmes marrëdhëniesh konstruktive, të respektueshme dhe të besueshme dhe këto mjedise bëhen të qëndrueshme pikërisht në sajë të këtyre marrëdhënieve. Krijimi i marrëdhënieve mbështetëse është veçanërisht i rëndësishëm kur mësohen nxënës nga formime e prejardhje diverse. Të jetuarit e marrëdhënieve të respektueshme, të drejta dhe aftësuese me të gjithë grupet e interesuara krijojnë një klimë pozitive në shkollë dhe një mjedis që çdokujt i krijojnë mundësinë të bëjë më të mirën.

*Fokusi tek mjetet dhe strategjitë: krijimi i rrjeteve & partneriteteve*

Marrëdhëniet e besueshme krijohen duke ndërtuar partneritete dhe rrjete. Partneritetet bazohen në interesa reciproke, por edhe tek respekti reciprok në të mirë të të gjithë palëve. Të jesh pjesë e rrjeteve do të thotë të ngresh struktura marrëdhëniesh që mund të përdoren për qëllime të ndryshme. Partneritetet mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve që shkojnë përtej kapacitetit të një shkolle, për shembull zhvillimi i procedurave të reja të vlerësimit apo materialeve të reja mësimore. Partneritetet mes shkollave gjithëpërfshirëse dhe shërbimeve të specializuara mund të jenë të rëndësishme për mbështetjen e fëmijëve më probleme në nxënie. Partneritetet mund të krijohen edhe me sektorin e biznesit për të ndihmuar kalimin nga shkolla në punë. Çdo shkollë duhet të zhvillojë strategjitë dhe metodat e saj për krijimin dhe mbajtjen e partneriteteve. Për këtë u duhet të mbajnë parasysh edhe kulturën e vendit. Partneritetet dhe përfshirja në rrjete është e rëndësishme për shkollat gjithëpërfshirëse edhe për të fituar mbështetjen e komunitetit lokal. Praktikienët gjithëpërfshirës krijojnë partneritete edhe me shkolla të tjera dhe profesionistë të tjerë për të zhvilluar praktikatat e tyre gjithëpërfshirëse.

*Fokusi tek konteksti: qeverisja arsimore*

Nëse praktikienët gjithëpërfshirës duan të krijojnë një mjedis social e fizik aftësues, duhet t'i kushtojnë vëmendje jo vetëm mënyrës si punojnë dhe bashkëpunojnë, por edhe mënyrës së organizimit dhe qeverisjes së shkollës. Ka më shumë të ngjarë që praktikienëve gjithëpërfshirës t'u duhet të punojnë në një kontekst social e politik aspak ideal për zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Politikatat, rregulloret dhe qeverisja vendore mund të krijojnë barriera për zbatimin e edukimit gjithëpërfshirës. Realizimi i mjediseve sociale e fizike aftësuese kërkon një mjedis politikash që krijojnë hapësira dhe nxisin partneritetet dhe vendim-marrjen pjesëmarrëse. Autoritetet lokale duhet t'i shohin shkollat dhe komunitetin si pjesë e qeverisjes arsimore në tërësi. Kjo u jep shkollave agjencinë për krijimin e një mjedisi shkollor gjithëpërfshirës bazuar tek nevojat e komunitetit. Kjo qasje e koordinimit të veprimeve mes grupeve të interesit në vend të zbatimit të qasjes nga lart poshtë konsiderohet si "Qeverisje Arsimore". Me anë të partneriteteve dhe pjesëmarrjes në rrjete, mënyrat ekzistuese të qeverisjes mund të adresohen, diskutohen dhe, ku është e mundur, të modifikohen. Këtu mësuesit bëhen agjentë të ndryshimit social me ndikim përtej shkollës, duke ndihmuar në zhvillimin e praktikave gjithëpërfshirëse në komunitet.

**ZHVILLIMI I PRAKTIKAVE TË PUNËS ME TË TJERË**

Zhvillimi profesional gjatë tre fazave

Tabela në vazhdim jep një pamje të përgjithshme të asaj që mund të pritët nga prakticienët gjithëpërfshirës në të tre fazat e zhvillimit profesional:

Konteksti	Edukimi fillestar i mësuesit	Zhvillimi profesional i vazhduar	Edukimi për mentorë, drejtues dhe agjentë të ndryshimit
Puna me të tjerë	Të jesh i aftë të punosh me të tjerë	Të jesh i aftë të zhvillosh praktikë të përbashkët me të tjerë	Të jesh i aftë të krijosh apo transformosh një praktikë të përbashkët me të tjerë
Marrëdhënie të respektueshme	Të jesh i aftë të marrësh pjesë në marrëdhënie respekti në klasë	Të jesh i aftë të zhvillosh marrëdhënie respekti në shkollë	Të jesh i aftë të krijosh apo transformosh marrëdhënie respekti në shkollë dhe komunitet
Krijimi i rrjeteve & partneriteteve	Të jesh i aftë të marrësh pjesë në rrjete dhe partneritete	Të jesh i aftë të kontribosh në zhvillimin e rrjeteve dhe partneriteteve	Të jesh i aftë të krijosh apo transformosh rrjete dhe partneritete
Qeverisja Arsimore	Të jesh i aftë të operosh brenda qeverisjes arsimore ekzistuese	Të jesh i aftë të zhvillosh qeverisjen arsimore ekzistuese	Të jesh i aftë të transformosh qeverisjen arsimore ekzistuese

Tabela 8: Nivele të aftësisë gjatë zhvillimit profesional: konteksti

Shembuj dhe ide praktike nga mësues pjesëmarrës në projektin "Mbështetje Rajonale për Edukimin Gjithëpërfshirës" të nxjerra nga seancat brainstorming

- Mësues që besojnë tek familja, shkolla dhe komuniteti si tre partnerë me objektiva të përbashkëta;
- Ekiye ekspertësh për të mbështetur mësuesit;
- Peer-learning si një qasje e fuqishme e nxënies me anë të bashkëpunimit;
- Përmirësim i bashkëpunimit mes shkollave dhe komunitetin (p.sh. investitor lokal për ndërtimin e një ashensori në shkollë);
- Bllok shënimesh lëvizës për të përmirësuar komunikimin mes prindërve dhe shkollës, dhe bashkëpunimi përmes shpërblimeve formale dhe sistemeve të promovimit, platformave web apo portaleve si një mënyrë për të mësuar;
- Shkëmbim vizitash;
- Bashkëpunim me profesionistë të tjerë të edukimit;
- Përdorimi i rrjeteve sociale;
- Krijimi i një baze legislative për programet trajnuese për mentorë.

Shembuj të praktikës së mirë përtej projektit

- International Teacher Leadership Project. Për informacion vizitoni: <http://www.teacherleadership.org.uk/the-itl-initiative.html>

Referenca dhe informacion shtesë

- The activist teaching profession (Sachs 2003);
- Being an expert professional practitioner (Edwards 2010).



## 6. Glosar dhe referenca

### GLOSAR

#### Aftësitë

Këtu fjala Aftësitë përdoret si një term ombrellë për qëndrimet, bindjet, shprehitë & njohuritë, kompetencat dhe agjencinë. Ai i referohet cilësisë së të qenurit i aftë për të bërë diçka apo për të kryer diçka.

#### Agjenci

Agjenci quhet kapaciteti i një agjenti për të vepruar në një mjedis të caktuar, për të transformuar praktikatat duke i bërë ato më gjithëpërfshirëse.

#### Kompetencat

Fjala kompetencë përshkruan kombinimin dinamik të njohurive, shprehive, qëndrimeve, vlerave dhe karakteristikave personale, që i jep një mësuesi autoritetin për të vepruar profesionalisht dhe në mënyrën e duhur në një situatë, duke i përdorur ato me koherencë (Komisioni Europian 2011, 7). Ekzistojnë katër fusha kompetence të mësuesve gjithëpërfshirës: Vlerësimi i diverzitetit të nxënësit, Mbështetja e të gjithë nxënësve, Puna me të tjerë, Zhvillimi profesional personal (Agjencia Europiane 2012).

#### Gjithëpërfshirja

Gjithëpërfshirja në kontekstin e edukimit i referohet procesit të reagimit ndaj diversitetit me qëllim kapërcimin e barrierave ndaj nxënies dhe pjesëmarrjes, duke vënë theksin tek ata grupe nxënësish që mund të jenë në rrezik marginalizimi, përjashtimi apo arritjesh më të pakta (Agjencia Europiane 2013, 11).

#### Edukimi gjithëpërfshirës

Edukimi gjithëpërfshirës është në thelb edukim me cilësi. Termi "gjithëpërfshirës" thekson faktin që edukimi cilësor sigurohet për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë. Edukimi gjithëpërfshirës i referohet njëkohësisht sistemit (p.sh. shkollave gjithë përfshirëse, sistemeve edukuese gjithëpërfshirëse) dhe personave (p.sh. të angazhuar apo pjesëmarrës në edukim, realizimi i të drejtës për edukim). Për informacion të lexuesit kemi shtuar edhe përkufizimet e mëposhtme të Edukimit Gjithëpërfshirës/Cilësor:

Këshilli i Europës, Rekomandim CM/Rec(2012)/13 i Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare për sigurimin e edukimit cilësor:

6. Për qëllimet e këtij rekomandimi, "Edukim Cilësor" kuptohet si një edukim që:
  - a) i siguron akses në nxënie të gjithë nxënësve dhe studentëve, veçanërisht atyre të grupeve vulnerabël dhe të disavantazhuara, në mënyrë të përshtatur për nevojat e tyre;
  - b) siguron një mjedis të sigurtë dhe jo-dhunues ku respektohen të drejtat e të gjithëve;
  - c) zhvillon personalitetin, talentet dhe aftësitë mendore e fizike të çdo nxënësi dhe studenti deri në potencialin e tyre të plotë dhe i inkurajon ata të përfundojnë programet edukative në të cilat regjistrohen;
  - d) promovon demokracinë, respektin për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale në një mjedis mësimi që njeh nevojat sociale dhe për të mësuar të çdokujt;
  - e) aftëson nxënësit dhe studentët të zhvillojnë kompetenca të duhura, vetë-besimin dhe mendimin kritik për t'i ndihmuar ata që të bëhen qytetarë të përgjegjshëm dhe për të përmirësuar aftësinë e tyre për t'u punësuar;
  - f) përcjell tek nxënësit dhe studentët vlerat kulturore lokale dhe universale ndërsa i aftëson të marrin vendimet e tyre;
  - g) certifikon rezultatet e nxënies formale dhe jo-formale në një mënyrë transparente të bazuar tek vlerësimi i drejtë, që bën të mundur njohjen e njohurive dhe kompetencave të fituara për studime të mëtejshme, punësim dhe qëllime të tjera;
  - h) mbështetet tek mësues cilësor, të cilët janë të angazhuar për zhvillimin profesional të vazhduar;
  - i) nuk është i korruptuar.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara, Neni 25.2 (b):

Shtetet Palë njohin të drejtën për edukim të personave me aftësi të kufizuara. Me synimin për realizimin e kësaj të drejte pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, Shtetet Palë sigurojnë një **sistem të edukimit gjithëpërfshirës** në të gjithë nivelet dhe në mësimin gjatë gjithë jetës me qëllim:

- a) Zhvillimin e plotë të potencialit njerëzor dhe sensit të dinjitetit e vetë-vlerësimit, dhe forcimin e respektit për të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe diversitetin njerëzor;
- b) Zhvillimin nga personat me aftësi të kufizuara e personalitetit, talenteve dhe kreativitetit të tyre, si dhe aftësitë e tyre mendore e fizike, deri në potencialin e tyre të plotë;
- c) Aftësimin e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë me efektivitet në një shoqëri të lirë.
  - Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të jenë në gjendje të kenë akses në një edukim fillor e të mesëm gjithëpërfshirës, cilësor e të lirë, në barazi me të tjerët në komunitetet ku jetojnë.
  - Duhet të ketë një plotësim të arsyeshëm të kërkesave të individit dhe sigurim të mbështetjes së kërkuar për të mundësuar edukimin e tyre të efektshëm.
  - Qeveritë duhet të mundësojnë mësimin e Braille dhe të formateve të tjera të komunikimit; orientimin dhe shprehitë lëvizëse; si dhe mbështetjen nga bashkënxënësit dhe mentorimin;
  - Qeveritë duhet të sigurojnë që edukimi për fëmijët që janë të verbër, të shurdhër apo të shurdhër e të verbër, të bëhet në gjuhë dhe mjete komunikimi mëse të përshtatshme për individin dhe në mjedis që maksimizojnë zhvillimin akademik dhe social.
  - Qeveritë duhet të punësojnë mësues, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, që janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave dhe/apo Braille, dhe të trajnojnë profesionistë të edukimit në lidhje me ndërgjegjësimin mbi aftësitë e kufizuara dhe të përdorin formatet relevante të komunikimit, teknika dhe materiale edukimi në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, neni 26 (përkufizimi i përdorur nga UNESCO):

Në zemër të **edukimit gjithëpërfshirës** qëndron e drejta njerëzore për edukim, e shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut në vitin 1948, ku thuhet:

‘Secili ka të drejtën e arsimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën në fazat e arsimit fillor dhe themelor. Arsimi fillor është i detyrueshëm. Arsimi duhet të synojë zhvillimin e plotë të personalitetit të njeriut dhe forcimin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ai duhet të nxitë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjitha kombeve, grupeve raciale ose fetare, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes.’

Gjithëpërfshirja ka të bëjë me sigurimin e reagimeve të përshtatshme ndaj spektrit të gjërë të nevojave të nxënies në rrethana të edukimit formal dhe jo-formal. Më shumë se një çështje margjinale për mënyrën e integritit të disa nxënësve në sistemin arsimor, **edukimi gjithëpërfshirës është një qasje që merret me mënyrat e transformimit të sistemeve arsimore dhe të rrethanave të tjera nxënëse me qëllimin për t’iu përgjigjur diversitetit të nxënësve**. Ai synon aftësimin si të mësuesve edhe nxënësve për t’u ndjerë komodë me diversitetin dhe për ta parë atë, më shumë si një sfidë dhe pasurim të mjedisit të mësimi, se sa si një problem. Gjithëpërfshirja thekson sigurimin e mundësive për pjesëmarrje të barabartë të personave me aftësi të kufizuara (fizike, sociale dhe/ose emocionale) në edukimin e përgjithshëm sa herë kjo është e mundur, por lë të hapur mundësinë e zgjedhjes personale për asistencë të posaçme dhe e mundëson këtë për ata që kanë nevojë.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës 1989:

Neni 2: fëmijët duhet të jenë të mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit, për shkak të racës, aftësive të kufizuara, etj.

Neni 28: Arsimi fillor duhet të jetë falas dhe i detyrueshëm.

Neni 29: Arsimi duhet të zhvillojë personalitetin, talentet dhe aftësitë mendore e fizike të fëmijës deri në shkallën më të plotë.

Indeksi i gjithëpërfshirjes për zhvillimin e nxënies dhe pjesëmarrjes në shkolla (Booth & Ainscow 2002)

Gjithëpërfshirja në edukim përfshin:

- Vlerësimin e të gjithë nxënësve dhe personelin në mënyrë barabartë.
- Rritjen e pjesëmarrjes së nxënësit në, dhe reduktimin e përjashtimit të tyre nga, kulturat, kurrikula dhe komunitetet e shkollave lokale.
- Ristrukturimin e kulturave, politikave dhe praktikave në shkolla, në mënyrë që t’i përgjigjen diversitetit të nxënësve në lokalitet.
- Reduktimin e barrierave të nxënies dhe pjesëmarrjes për të gjithë nxënësit, jo vetëm për ata me probleme/kufizime apo ata që kategorizohen si persona që kanë “nevoja të posaçme edukimi”.
- Nxjerrjen e mësimave nga përpjekjet për kapërcimin e barrierave të aksesit dhe pjesëmarrjes të nxënësve të veçantë për të sjellë ndryshime në të mirë të studentëve në nivel më të gjerë.
- Shikimin e diferencave mes nxënësve më shumë si burime mbështetje se sa si probleme për t’u kapërcyer.
- Njohjen e të drejtës së nxënësit për edukim në lokalitetin e tyre.
- Përmirësimin e shkollave si për personelin edhe për nxënësit.



- *Theksimin e rolit të shkollave në ndërtimin e komunitetit dhe zhvillimin e vlerave, si dhe në rritjen e arritjeve.*
- *Forcimin e marrëdhënieve reciproke të qëndrueshme mes shkollave dhe komuniteteve.*
- *Njohjen e gjithëpërfshirjes në edukim si një aspekt të gjithëpërfshirjes në shoqëri.*

#### *Pjesëmarrja*

Pjesëmarrja është përfshirja në situatat jetësore. Njerëzit janë të përfshirë nëse angazhohen me sjellje, emocionalisht dhe në mënyrë konjitive në aktivitete që janë tipike për një rrethanë të caktuar dhe synojnë qëllime kuptimplota nga pikëpamja sociale dhe personale.

## **INSTRUMENTE LIGJORE TË KËSHILLIT TË ARTEVE QË ADRESOJNË DREJTPËRSËDREJTI EDUKIMIN GJITHËPËRFSHIRËS:**

### *Adresimi i Edukimit Gjithëpërfshirës drejtpërsëdrejti*

- Rekomandim CM/Rec (2012)13 i Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare për sigurimin e edukimit cilësor;
- Rekomandimi CM/Rec(2010)7, i Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare mbi Kartën e Këshillit të Europës mbi Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimin e Të Drejtave të Njeriut;
- Konferenca e Këshillit të Europës e Ministrave të Arsimit dhe të Edukimit Cilësor, seanca e 24-t, Helsinki, Finlandë, 26-27 Prill 2013, Deklarata Përfundimtare mbi Temën e Konferencës;
- Rekomandim CM/Rec (2014)5 për vendet anëtare mbi rëndësinë e kompetencave gjuhësore për paritet dhe cilësi në edukim dhe për suksesin arsimor;
- Rekomandim Rec(2006)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi planin e veprimit të Këshillit të Europës për promovimin e të drejtave dhe pjesëmarrjes së plotë në shoqëri: përmirësimi i cilësisë së jetës së personave më aftësi të kufizuara në Europë 2006-2015.

### *Adresimi i edukimit gjithë përfshirës në mënyrë indirekte*

- Rekomandim Rec (2001)15, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi mësimin e historisë në Europën e shekullit të njëzetën;
- Rekomandim Rec (2001)17, për përmirësimin e situatës ekonomike dhe të punësimit të Romëve/Egjiptianëve dhe Nomadëve në Europë;
- Rekomandim Rec (2003)8, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi promovimin dhe njohjen e edukimit/nxënies jo-formale të të rinjve;
- Rekomandim Rec (2002)6, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi politikat e arsimit të lartë për mësimin gjatë gjithë jetës;
- Rekomandim Rec(2004)4, i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut në arsimin universitar dhe trajnimin profesional;
- Rekomandim CM/Rec (2008)5 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi politikat për Romët dhe/ose Nomadët në Europë;
- Rekomandim CM/Rec (2009)4 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi edukimin e Romëve dhe Nomadëve në Europë.

### *Instrumente të tjera ligjore të Këshillit të Europës në mbështetje të edukimit gjithëpërfshirës:*

- Karta Europiane Sociale (E rishikuar);
- Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI);
- Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (FCNM).

**BIBLIOGRAFI**

- Argyris, C. & Schön, D.A. (1996). *Organizational Learning II. Theory, method and practice*. Reading, Mass: Addison Wesley.
- Booth, T and Ainscow, M. (2002) *Index for Inclusion: developing learning and participation in schools*. Center for Studies on Inclusive Education.
- Council of Europe (2009). *Diversity and inclusion: challenges for teacher education*. Key Competences for Diversity. Strasbourg: Council of Europe.
- Council of Europe (2010). *Policies and practices for teaching sociocultural diversity*. Diversity and inclusion: challenges for teacher education. Strasbourg: Council of Europe Publishing.
- Durrant, J. & Holden, G. (2006). *Teachers leading change. Doing Research for school improvement*. Thousand Oaks: Sage.
- Edwards, A. (2005). *Relational agency: Learning to be a resourceful practitioner*. *International Journal of Educational Research*, 43, 3, 168-182.
- Edwards, A. (2012). *Being an expert professional practitioner*. New York: Springer.
- Engeström, Y. (2001). *Expansive learning at work: Toward an activity-theoretical conceptualization*. *Journal of Education and Work*, 14(1), 133-156.
- European Agency for Development in Special Needs Education (2012). *Teacher Education for Inclusion. Profile of Inclusive Teachers*. Odense: European Agency for Development in Special Needs Education.
- European Agency for Development in Special Needs Education (2013). *Organisation of Provision to Support Inclusive Education. Literature Review*. Odense, Denmark: European Agency for Development in Special Needs Education.
- European Commission (2011). *Literature review Teachers' core competences: requirements and development*. Brussels: European Commission.
- European Commission (2013). *Supporting teacher competence development for better learning outcomes*. Brussels: European Commission.
- Fullan, M. G. (1993). *Why teachers must become change agents*. *Educational Leadership*, 50, 12-17.
- Hart, S., Dixon, A., Drummond, M. J., & McIntyre, D. (2004). *Learning Without Limits*. Milton Keynes, UK: Open University Press.
- Hattie, J. (2009). *Visible Learning: A Synthesis of Over 800 Meta-Analyses Relating to Achievement*. Abingdon: Routledge.
- Lave, J. & Wenger E. (1991). *Situated Learning: Legitimate Peripheral Participation*. Cambridge: Cambridge University Press
- Pantić, N., Closs, A., & Ivošević, V. (2011). *Teachers for the Future: Teacher Development for Inclusive Education in the Western Balkans*. Turin: European Training Foundation.
- Priestley, M., Edwards, R., Priestley, A., & Miller, K. (2012). *Teacher agency in curriculum making: Agents of change and spaces for manoeuvre*. *Curriculum Inquiry*, 42, 191-214.
- Ritchhart, R., Church, M., Morrison, K. (2011). *Making learning visible to promote engagement, understanding and independence for all learners*. San Francisco: Jossey-Bass.
- Sachs, J. (2003). *The activist teaching profession*. Buckingham: Open University Press.
- Saphier, J., Haley-Speca, M-A., Gower, R. (2008). *The skilful teacher. Building your teaching skills*. Acton: Research for Better Teaching.
- Schön, A. (1983). *The Reflective Practitioner. How Professionals think in Action*. New York: Basic Books.
- Senge, P. (1990). *The Fifth Discipline: The art and practice of the learning organization*. New York: Doubleday.
- Senge, P., Cambron McCabe, N., Lucas, T., Smith, B., Dutton, J. & Kleiner, A. (2012). *Schools that Learn: A Fifth Discipline Fieldbook for Educators, Parents, and Everyone Who Cares about Education*. New York: Random House.
- Swann M., Peacock A., Hart, S. and Drummond, M.J. (2012) *Creating Learning without Limits*. Maidenhead: Open University Press
- Villegas, M. & Lucas, T. (2002). *Educating culturally responsive teachers – a coherent approach*. Albany: State University of New York Press.

Ky dokument u prodhua me asistencën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë si pikëpamje që përfaqësojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit, për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i hartuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Zbatimi i Konventës në shtetet anëtare mbikëqyret nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Bashkimi Evropian është një partneritet unik ekonomik dhe politik mes 28 vendeve evropiane demokratike. Synimet e tij janë paqja, prosperiteti dhe liria për të 500 milionë qytetarët e tij – në një botë më të sigurtë, më të drejtë. Për t'i bërë gjërat të ndodhin, vendet e BE-s ngrenë organe për drejtimin e BE-s dhe miratojnë legjislacionin e saj. Më të rëndësishmet nga këto janë Parlamenti Evropian (që përfaqëson popullin e Evropës), Këshilli i Bashkimit Evropian (që përfaqëson qeveritë nacionale) dhe Komisioni Evropian (që përfaqëson interesin e përbashkët të BE-s).

[www.ec.europa.eu](http://www.ec.europa.eu)

### Mbështetja Rajonale për Edukimin Gjithëpërfshirës

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



COUNCIL OF EUROPE



Implemented  
by the Council of Europe